



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

| | | | |
|-------------------------------------|--------------|-----------------|-----------------|
| Pratja e Premtes Me Datë 21-05-2026 | | | |
| Rr. Localiteti Cm. Ujq. | Numri i Ujq. | Numri i Premtes | Vlera e Premtes |
| 01- | 060/01- | | 538 |



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/15, Qershor 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, dhe të Nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL), Nr 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në Nenin 6 pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, nr 01-013/594, e datës 02.05.2014, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VI të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datë **20.05.2026, (e Premte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në shtëpinë e kulturës, "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit Komunal.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të komisionit për përgatitjen e draftdokumentit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit përfundimtar për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti, për vendosjen e trafove elektrike.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës kompanisë kosovare për distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti, për vendosjen e trafove elektrike.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për plotësimin e vendimit nr.01-110/05-381 të datës 31.03.2026, për miratimin e marrëveshjes së binjakëzimit mes Komunës së Vitisë dhe Komunës së Saint Julien en Genevois – Francë
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të viti 2025 në vitin 2026.
9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për vizitë studimore në Shqipëri
10. Informatë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për Manifestimin Tradicional Kulturo-Sportiv "Flakadani i Karadakut 2026".
11. Pyetje dhe përgjigjeje

Viti, më 20.05.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi

Pika 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Vitisë

Mbledhjen e ftoi kryetari, z.Bekim Azizi, kryesues i seancës së Kuvendit Komunal. Mbledhja është mbajtur më 30.04.2026 (e enjte), në shtëpinë e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani", duke filluar punën në orën 10:00. Në mbledhje morën pjesë kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi, nënkryetari i komunës, z.Hasan Aliu, drejtorët komunalë, mediat elektronike, si dhe këshilltarët e Kuvendit: z.Basri Aliu, z.Ramadan Deliu, zn.Zejnepe Osmani, z.Illir Zuka, z.Ekrem Ymeri, z.Sokol Shaqiri, z.Faruk Shabani, znj.Yllka Qamili, zn.Djellza Fejzullahu, z.Bekim Azizi, z.Hajdin Ademi, z.Visar Demiri, z.Nuhi Ramadani, z.Selim Sejdiu, znj.Elsa Jahija, znj.Ardita Hajdari, zn.Mirjeta Hamiti, z.Jakup Demiri, zn.Lindita Demelezi, zn.Majlinda Shabani, z.Ekrem Abazi, z.Lulzim Haxhiu, zn.Liridona Bislimi dhe z.Remzi Salihu, z.Elham Emërlahu, ndërsa munguan z.Bekim Rama dhe z.Labinot Bislimi.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e pestë të rregullt. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në këtë seancë. Kjo është seanca e pestë e Kuvendit Komunal të këtij mandati. Materialin e keni marrë me kohë për këtë seancë dhe, pak para se të fillojmë këtë pjesë, po ju njoftoj se kemi pranuar konfirmimin e ligjshmërisë për një vendim, ndërsa për të tjerat ende jo. E kam një kërkesë nga Demos, që i përcjell kuvendet komunale. Ma kanë dërguar një email për të kërkuar miratimin tuaj që t'i përcjellin aktivitetet e Kuvendit Komunal. A jeni për këtë? Të gjithë u pajtuan që t'i përcjellin aktivitetet e Kuvendit. Para se të vazhdojmë me rendin e ditës, e kemi edhe një pikë shtesë, të cilën e kemi diskutuar në KPF, për dhënien në shfrytëzim të pronës KEDS-it. Vazhdimisht këto kërkesa nuk i kemi penguar. Ky është propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a. (KEDS) në Viti, për vendosjen e trafave elektrike. Kjo është pikë shtesë e rendit të ditës.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Liridona e ka ngritur këtë çështje disa herë. Unë kam pasur një takim me përfaqësuesit e KEDS-it dhe, si kushtëzim, ndoshta e kam trajtuar çështjen e trafos në Drobesh. Në rast se ne, si Kuvend Komunal dhe si ekzekutiv, jemi në gjendje t'i kryejmë procedurat edhe në mënyrë të përshpejtuar për KEDS-in, krejt kjo është me qëllim që t'u ofrojmë shërbime qytetarëve të komunës së Vitisë. Prandaj e kam theksuar edhe çështjen e trafos në Drobesh, që edhe ajo çështje të marrë përshpejtim dhe sa më shpejt të ngrihet një trafo aty në Drobesh, në mënyrë që të gjendet zgjidhje edhe për qytetarët e Drobeshit. Këtë e kanë marrë shumë seriozisht edhe drejtori i KEDS-it.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: Edhe në Ramjan ka qenë një. Besoj që edhe për këtë ke bisedu për pikat e caktume të rendit të ditës. A ka dikush me diskutu?

z.Basri Aliu: Ne si grup parlamentar jemi pro edhe kësaj pike shtesë të rendit të ditës. Po ashtu, edhe unë po e shfrytëzoj rastin për fshatin Skifteraj, sepse atje vetëm është planifikuar rjetëzimi të kjo rruga kryesore ku është shkolla. Të bëhet një presion më i madh të kompania që të kryhet edhe ajo.

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: A jeni që në rendin e ditës të hyjë edhe kjo pikë shtesë? Kush është për? A jeni që të miratohet rendi i ditës komplet me pikat që e keni marrë materialin? Nga të gjithë u miratua rendi i ditës.

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së katër të Kuvendit Komunal.
2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2026.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale të pronës komunale.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin (Rialokimin) e mjeteve buxhetore në programin buxhetor në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale.
7. Pyetje dhe përgjigje.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së katër të Kuvendit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit, Bekim Azizi: A jeni që të miratohet procesverbali? Pra, nga të gjithë të pranishmit me vota pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2026

z.Berat Zuka, zyrtar financiar: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar–mars 2026. Ne, me kohë si Zyrë e Buxhetit kemi përgatitur raportin financiar për këtë tremujor, dhe po mundohem t'i paraqes në pika të shkurtra, sepse materialin e keni marrë. Pjesën e parë, në faqen dy, e keni buxhetin e aprovuar, i cili është buxheti vjetor, kurse në pjesën e dytë e keni buxhetin e alokuar. Nga buxheti i alokuar është shuma në vlerë prej 7,991,162.97. Totali i alokimeve në paga janë alokuar 6,811,819 nga granti qeveritar, nga të hyrat vetanake janë alokuar 123,252.32, dhe nga donacionet që janë bartur nga viti i kaluar 164,080. Materialin e keni marrë me kohë. Për pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, i nderuar nënkryetar. Sa u përket pasqyrave financiare janar–mars 2026, fillimisht po dua me theksu se prej materialit që e kemi pranuar, ku e kemi bërë edhe një diskutim në KPF, na ka bërë me e kuptu se këto pasqyra nuk janë vetëm një analizë e thjeshtë teknike, por janë një pasqyrë e drejtpërdrejtë e mënyrës se si po menaxhohen paratë publike të qytetarëve tanë. Këtë mundet me e arrit secili, tu i zbërthij shumë thjesht, duke i krahasuar pasqyrat financiare të tremujorit të parë të vitit 2026 me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Aty shihet qartë se kemi një rritje të përgjithshme të shpenzimeve, me një dallim prej rreth 450 mijë euro më shumë. E ajo që është edhe më shqetësuese është fakti se, në të njëjtën kohë, kemi rënie të të hyrave vetanake. Kjo do të thotë se kemi më pak të hyra dhe më shumë shpenzime. Të nderuar, kur e bëjmë analizën dhe hyjmë në detaje, bëhet edhe më e qartë se ku qëndron problemi. Në bazë të këtij materiali që e kemi analizuar, i bie që rritja e shpenzimeve nga Komuna e Vitisë nuk vjen nga ndonjë zhvillim i madh apo projekte që prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve, por kryesisht nga shpenzimet operative dhe administrative. Po jap vetëm disa shembuj më konkretisht: Shpenzimet për dreka zyrtare kanë qenë rreth 8,400 euro në vitin 2025, ndërsa në vitin 2026 kanë arritur në 10,709 euro. Pra, kemi rritje prej rreth 27%, për periudhën e njëjtë, vetëm dallojnë vitet; Shpenzimet për informim publik dhe media kanë qenë rreth 3,800 euro në vitin 2025, ndërsa në vitin 2026 janë rritur në 4,500 euro. Pra, rritje prej rreth 18%; Për mirëmbajtje të objekteve, në vitin 2025 janë shpenzuar rreth 70 mijë euro, ndërsa në vitin 2026 mbi 103 mijë euro. Është kodi i njëjtë buxhetor, periudha e njëjtë, vetëm dallojnë mjetet. Kjo është rritje prej mbi 30 mijë euro, apo rreth 47% dallueshmëri; Për mirëmbajtje të rrugëve, në Komunën e Vitisë janë shpenzuar rreth 80 mijë euro për periudhën janar–mars të vitit 2025, ndërsa kemi rritje në mbi 106 mijë euro në vitin 2026. Po flasim për periudhën janar–mars, kur nuk kemi pasur reshje, nuk janë shtu rrugët në Komunën e Vitisë, por vetëm janë shtu mjetet, që janë diku rreth 26 mijë euro më shumë; Riparimi i automjeteve ka kushtuar rreth 15 mijë euro, e tash mbi 19 mijë

euro; Të gjitha këto tregojnë një gjë shumë të qartë: rritja e buxhetit po shkon drejt shpenzimeve operative dhe administrative. Ndërkohë, investimet kapitale, që në vitin 2025 ishin planifikuar rreth 2.66 milionë euro, ndërsa për vitin 2026 nuk po realizohen në nivelin e njëjtë me planifikimin, domethënë i kemi rreth 2.04 milionë euro. Pra, po i bie që ju po planifikoni më shumë, por po realizoni më pak. Kemi edhe kode të tjera buxhetore të shumta, por nuk po dua me vazhdu më tutje. Besoj që do t'i marr këto përgjigje e mandej e hapim diskutimin. Edhe pyetja kryesore, në diskutimet që i kam bërë haptas me qytetarë, është se si ka ardhur deri te kjo dallueshmëri kaq e madhe në përqindje të këto kode buxhetore për periudhën e njëjtë. Edhe unë personalisht konsideroj që është e domosdoshme të rishikohen prioritetet. Me një fjalë, me pas më pak shpenzime për administratën, e sidomos për Zyrën e Kryetarit, dhe me pas më shumë investime reale, sepse, nëse vazhdojmë me këtë trend, duke filluar vetëm me tremujorin e parë, po ku e kemi komplet vitin që kemi me ardhë me zhvillime kapitale. Nëse shkojmë kështu, kemi me përfundu me një buxhet që vetëm ka rritje në shifra, mirëpo rezultat konkret nuk kemi me mujt me pas.

z.Basri Aliu: Në emër të grupit parlamentar do të jap një kontribut sado pak, pasi që edhe në KPF kemi diskutuar këtë pikë dhe janë sqaruar shumë sende aty. E dimë se këto pasqyra paraqesin vetëm një shpenzim, asgjë tjetër. Ky shpenzim realisht nuk krahasohet me periudhën e këtij viti me vitin e kaluar. Arsyeja pse nuk krahasohet është se, duke e ditur që në vitin e kaluar thesari i ka tërhequr shumë mjete komunës për shkak të kontratës kolektive, komuna nuk ka qenë në gjendje t'i paguajë obligimet që i ka pasur gjatë vitit 2025. Andaj, duke e ditur se këtë vit duhet t'i kryejë obligimet paraprake, këto shpenzime janë faktikisht shpenzime të vitit të kaluar, nuk janë të kësaj periudhe. Një pjesë janë të kësaj periudhe, por shumica janë mjete të vitit të kaluar. Duhet me pasë parasysh se të gjitha komunat e Kosovës kanë probleme të kësaj natyre.

znj.Majlinda Shabani: Përhëndetje të nderuar të pranishëm. Kryetarin e komunës nuk e kemi prezent dhe gati nuk po e kemi në asnjë seancë, e pramë ish dalë në një televizion tu fol për tema qendrore. E ka harru që qytetarët e kanë votu për qeverisje lokale e jo qendrore. Respekt shumë për nënkryetarin që e kemi këtu, që është prezent në çdo seancë. Pasqyrat financiare janar-mars 2026 për Komunën e Vitisë realisht edhe ky raport tregon një realitet të asaj që ne si opozitë e kemi thënë vazhdimisht: mungesë transparence, keqplanifikim dhe keqmenaxhim të parasë publike. Kjo qeverisje nuk është transparente. Përkundrazi, ka shumë dyshime për mënyrën se si po shpenzohen taksat e qytetarëve. Për ta thënë ndryshe, kjo qeverisje është edhe përplot abuzime në kurriz të qytetarëve. Dhe pikërisht këtu qëndron problemi ynë më i madh te paratë e qytetarëve, se si po harxhohen dhe ku po shkojnë. Shkalla e realizimit, duke u bazuar në planifikimin tremujor, është 57.01%, ndërsa shkalla e realizimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor, është vetëm 14.25%. Te lejet e ndërtimit janë planifikuar 25 mijë euro, ndërsa të hyrat janë vetëm 30 euro, domethënë 0.12%. A do të thotë që kemi ndërtime pa leje? A doni me pranë ju vetë se kjo është bërë edhe çështje mediatike? Nëse e krahasojmë këtë me tremujorin e vitit paraprak, e ki vlerën 1,680 euro që ka pasur të hyra, ndërsa për këtë periudhë vetëm 30 euro janë të hyrat. Para se të kaloj te investimet kapitale apo prezantimi analitik i investimeve, po vazhdoj të bëj pyetje dhe kërkesë për sqarime të disa kode buxhetore. Kodi 13440 – Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale. Për këtë tremujor i kemi 186,592 euro dhe, nëse e krahasojmë me vitin paraprak, ka rritje diku për 100 mijë euro. Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale janë temë që unë i kam diskutuar edhe më herët. Nuk keni dhënë sqarime as edhe një herë se çka janë tu i shërby këto shërbime këshilldhënëse dhe profesionale Komunës së Vitisë. Për çdo vit ka pasur rritje, ndërsa për këtë tremujor ka rritje diku për 100 mijë euro. Përpos kësaj, i kemi edhe shërbime të ndryshme shëndetësore. E dimë kontratat që janë me Caritas-in dhe Kosova Med-in dhe shërbimet tjera konsulente. Domethënë i keni gati 1 milion euro, me e krahasu me komplet vitin, që Komuna e Vitisë i jep për këto shërbime, e këto nuk e dimë realisht se çka janë tu i shërby komunës tonë ose çfarë investimi janë tu u bërë. Kodi 13450 – Shërbime shtypje dhe printim: 17,539 euro. Krahasuar me vitin paraprak, për periudhën e njëjtë, ka rritje për 14,933.03 euro. Pse kaq shumë rritje dhe me tregu pak më shumë se çka do të thotë ky shërbim, si funksionon dhe qysh është kontrata e kësaj, a është kontratë fikse? Kodi 13610 – Furnizime për zyrë: 9,792.01 euro. Krahasuar me vitin paraprak ka rritje të shpenzimit për 5,669.05 euro më shumë. Domethënë ka më shumë se dyfishim të kësaj vlere. Edhe këtu kërkoj sqarime. Kodi 13250 – Telefonia fikse: 3,456.35 euro. Pse kaq shumë shpenzim vetëm për këtë tremujor? Kodi 13310 – Internet. Është një kod i ri, që

është shpenzim 1,123 euro. Edhe këtu kërkoj sqarim. Përpos kësaj që po kërkoj sqarim, unë po dua me njoftu komunën për një projekt i cili mbështetet nga BE-ja dhe nga GIZ-i, që i financon gjitha komunat që janë mbi 500 komuna dhe që ofron Wi-Fi falas. Ju si komunë mundeni me apliku dhe me marrë fonde, mos me shfrytëzu para publike për diçka që mundeni me marrë me financim të BE-së. Kodi 14032 – Mirëmbajtja e rrugëve lokale: 145,453.38 euro. Krahasuar me vitin 2025 apo paraprak ka rritje të shpenzimit për 39,219.77 euro. Edhe këtu kërkoj sqarime se ku është bërë ky shërbim, cilat rrugë dhe a nuk është kontrata fikse sa i përket këtij shërbimi? Pyetja e njëjtë edhe për Kodin 14060 – Mirëmbajtja rutinore. Nga 8,853 euro sa ka qenë në vitin 2025, në këtë vit është 36,038 euro. Pse kjo rritje kaq e lartë? Çka hyn te këto mirëmbajtje? Edhe kodi 13310 është kompensimi i përfaqësimit brenda vendit. Unë këtu dua ta jap një sqarim tjetër, që më herët, para 3 viteve, ky kod buxhetor ka qenë me përshkrim “dreka zyrtare”, prej vitit 2024 na ka ardhur si “kompensim i përfaqësimit brenda vendit”. Edhe për këtë tremujor ky kod, përfaqësimi thënë më shkurt lluksi, është 14,109 euro. Krahasuar me vitin paraprak ka rritje për 3,399 euro. Po ndalem te investimet kapitale, sepse aty shihet më së miri gjendja reale. Edhe më herët kemi ngritur shqetësime të vazhdueshme për vlerat që janë deklaruar. Nuk dihet sa janë reale ato investime, nuk dihet a janë të njëjtat me periudhën që ne jemi tu raportu. Tash në pasqyrat financiare ne i shohim shifrat, por kur i krahason me raportet e tjera, i sheh që ato nuk përputhen dhe del një rëmtë e madhe – projekte që nuk përputhen, shifra që nuk dalin njësoj. Çka do të thotë kjo? Do të thotë që qytetari i Vitisë nuk është duke e ditë të vërtetën për investimet që po bëhen. Nuk është i informuar si duhet. Por më e keqja, as vetë komuna nuk është tu e ditë se si po ia del me kamuflu dhe me funksionu kështu. Edhe më keq, paratë po shkojnë në projekte që shpesh nuk i hyjnë në punë qytetarëve dhe nuk janë relevante me nevojat dhe kërkesat e tyre. Ndërkohë, nevojat bazike mbesin anash. E kemi diskutu që uji i pijshëm nuk ka qenë asnjëherë prioritet për të gjitha këto vite qeverisjeje në komunë. Thuhet se është ekzekutuar 92.95%. Mirëpo, prej 30 projekteve të listuara në këtë prezantim si investime kapitale, nënkryetar, 12 projekte që janë të listuara janë vendime gjyqësore, gjithsej 880,664.47 euro që kanë shkuar pagesa për vendime gjyqësore, ndërsa komplet investimet, qysh e përmendi zyrtari, janë diku 2 milionë euro. I bie gati se 1 milion janë pagesa për vendime gjyqësore. Edhe këtu dua një sqarim. E kuptoj që duhet me qenë të emëruara ashtu, por a bën me ditë cilat investime kanë qenë të planifikuara që vendimet gjyqësore i kanë marrë ato mjete financiare, sepse këto nuk janë pak mjete të marra.

z. Visar Demiri: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Nuk kam ndonjë pyetje specifike, sepse nga përvoja pak a shumë e kuptoj se nga kanë shkuar shpenzimet. E kuptoj që kryesisht janë shpenzime gjyqësore, dhe këto barten edhe prej vitit të kaluar. Kisha kërkuar që ekzekutivi të ketë parasysh reduktimin e shpenzimeve të cilat mund të ndikohen dhe mund të reduktohen, e që nuk ndikojnë në cilësinë e shërbimeve dhe vetë shërbimet për qytetarët e Komunës së Vitisë. Ne e kuptojmë që po jetojmë në një ekonomi pak të trazuar dhe do të ketë inflacion këtë vit, dhe kjo është e evidente momentalisht. Prandaj është mirë që të kemi parasysh reduktimin e shpenzimeve të cilat mund të reduktohen gjatë këtij viti.

znj. Elsa Jahija: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në pasqyrat tremujore të buxhetit vërehet një nivel i konsiderueshëm i pagesave për vendime gjyqësore. Siç dihet, këto obligime, veçanërisht ato që lidhen me pagesat për mësimdhënësit sipas kontratës kolektive, kanë përbërë një barrë të ndjeshme financiare për Komunën e Vitisë dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në strukturën buxhetore në të kaluarën. Në këtë drejtim, do të doja të jem e informuar nëse ekziston një planifikim i qartë dhe i detajuar lidhur me shumën e mbetur për t'u paguar nga këto obligime. Po ashtu, do të ishte me rëndësi të dimë sa është i vlerësuar rreziku që gjatë këtij viti të përballemi sërish me vështirësi financiare dhe me ndikim në strukturën buxhetore, në një shkallë të ngjashme apo më të theksuar krahasuar me vitin e kaluar.

z. Ekrem Abazi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë po e shoh që jemi duke diskutuar për pasqyrat financiare të buxhetit për periudhën janar–mars 2026, jo për vitin 2025. Të hyrat vetanake gjatë kësaj periudhe janë inkasuar gjithsej 184 mijë e 510 euro. Krahasuar me të hyrat për periudhën janar–mars 2025, janë më të ulëta për 26 mijë e 770 euro. Arsyeja që është dhënë lidhet me mosshpërndarjen me kohë të faturave të tatimit në pronë. Shpenzimet buxhetore: buxheti i alokuar për periudhën janar–mars 2026 nga të gjitha fondet është 7 milion e 99 mijë e 162 euro, ndërsa shpenzimet janë 6 milion e 598 mijë e 950 euro. Shkalla e ekzekutimit të

buxhetit ka qenë 92.95%. Këtë shkallë e rrit më së shumti paga dhe mëditjet. Duke u fokusuar vetëm në disa shpenzime: Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale: 186 mijë e 592 euro. Këtu nuk është vetëm pyetje, por kërkoj edhe sqarim, sepse ne po pyesim por sqarime nuk po na jepen fare; Shërbime të ndryshme shëndetësore: 185 mijë e 540 euro; Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste: 98 mijë e 115 euro; Mirëmbajtja e rrugëve lokale: 148 mijë e 453 euro; Pajisje tjera: 16 mijë e 185 euro. Të hyrat buxhetore të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar–mars 2026; Tatimi në pronë – të planifikuara 157 mijë e 290 euro, të realizuara 65 mijë e 913 euro, ose 41.91%. Prapë po e theksoj që për këtë duhet arsytim; Te urbanizmi kemi 0.12% dhe kjo po më bën me dyshu që diçka nuk është në rregull, por ju e dini më mire. Te shërbimet publike kam vërejtur një inkasim më të madh se sa është planifikuar. Hapësira publike: të planifikuara 1,852 euro, të inkasuara 6,644 euro; Reklama publike: të planifikuara 700 euro, të inkasuara 2,600 euro. Këtu shihet një rritje e mirë. Sa i përket prezantimit analitik të investimeve kapitale për periudhën janar–mars 2026; Ndërtimi i kanalizimeve në Komunën e Vitisë: 58 mijë e 152 euro; Ndërtimi i kanalizimeve në Viti: 41 mijë e 847 euro; Një tjetër ndërtim kanalizimi: 100 mijë euro. Gjithsej për kanalizime: rreth 200 mijë euro. Nuk është specifikuar qartë ku janë realizuar këto punë. Aty ku janë shumat e vogla është bërë specifikim, por aty ku janë shumat e mëdha nuk është sqaruar fare. Renovimi i ambulanteve në Komunën e Vitisë: 24 mijë e 685 euro; Riparimi nëpër shkolla: 104 mijë euro; Ndërtimi i ujësjellësve: 32 mijë euro; Asfaltimi i rrugëve rurale: 260 mijë euro – nuk është sqaruar ku janë asfaltuar këto rrugë rurale. Nga 2 milion e 650 mijë euro investime kapitale, 906 mijë euro janë për pagesa për vendime gjyqësore, ndërsa 1 milion e 144 mijë janë për investime kapitale. Këtë duhet me ditë qytetarët që këtu ka edhe vendime gjyqësore, jo vetëm investime kapitale. Kërkoj që në këto pika që i theksova të jepet sqarim i detajuar se ku kanë shkuar këto mjete. E pashë te rrethojat për shkolla 6 mijë euro dhe më pëlqeu që është specifikuar, por te shumat e mëdha nuk po jepet sqarim. Kësaj here dua sqarim konkret: çka është bërë dhe ku janë realizuar këto investime.

z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa: U cek diferenca e shpenzimeve. Ju e dini që nga viti i kaluar kemi shumë prej 4 milion e 576 mijë euro obligime. Kemi arritur që në këtë tremujor obligimet deri në 1 milion e 800 mijë euro t'i zbresim komplet. Në këtë raport janë të prezantuara si shpenzime dhe aty e paraqet diferencën më të madhe të disa shumave, sepse ku ka pasur mundësi ne jemi munduar që t'u japim prioritet faturave të vjetra për t'i paguar. U përmendën edhe shpenzimet kapitale 900 mijë e 933 mijë euro. Të nderuar delegatë, plani i rjedhjes së parasë më 16 janar, Departamenti i Thesarit e ka lejuar. Kur kemi filluar te projektet kapitale, 1 milion e 95 mijë euro vetëm kanë qenë të ngrira nga Thesari. U përmend pyetja se prej cilave projekte janë marrë. Unë po i përmendi vetëm dy: nga participimi i projekteve me donatorë janë marrë 200 mijë euro, nga granti qeveritar janë marrë 22 mijë euro, te renovimi i shkollave janë marrë, te rregullimi i tualeteve, dhe të gjitha mjetet që kanë qenë të grantit qeveritar, afër 300 mijë euro, dhe pjesa tjetër nga projekte të tjera. Nënkrjetar, në mbledhjen e ardhshme unë i nxjerr të gjitha këto projekte, prej sa mjeteve janë ngritur, janë hequr prej kodit buxhetor që kanë qenë të koduara dhe janë qitë me një kod të veçantë me zero katër. Kanë krijuar një kod Thesari si për ne edhe për komunat e tjera. Në mbledhjen e radhës ju garantoj se të gjitha projektet, prej ku janë marrë, me emër e mbiemër dhe shumë, kemi me i prezantuar. Në përgjegjësinë që u përmend kodi 13450, këto po përsëriten që dy herë. Unë që marr pjesë në prezantimin e raporteve financiare, ne i kemi kontratat kontraktuale me Caritas-in dhe me KosovaMed-in. Shumica e këtyre shpenzimeve që shihen në raportin financiar janar–mars janë obligime nga viti i kaluar, sepse në raportin financiar të dhjetorit janë prezantuar 2 milion e 800 mijë euro nga viti i kaluar, të cilat janë marrë nga buxheti i komunës dhe janë paguar shpenzime kontraktuale që kanë rjedhur kryesisht nga kontrata kolektive. Shumë mirë u përmend nga një delegat që struktura buxhetore na është shkatërruar në tërësi, sidomos neve zyrtarëve financiarë që mundohemi me mbajtë në kontroll buxhetin, në momentin që kemi fillu me i zotë mjetet përmes sekondave neve na janë tërhequr dhe shihet një buxhet që është i shpenzuar 1 milion e 143 mijë euro te kapitale. Jemi mundu shpejt e shpejt mos me na zënë si vitin e kaluar, mjetet ku janë të lira më nuk na pyesin. Thesari ka urdhër të prerë dhe jemi mundu që ku kemi pasur mundësi dhe raporte, t'i zotëjmë mjetet, t'i shpenzojmë dhe t'i kryejmë obligimet, që Thesari të mos na i bllokojë në të ardhmen dhe shpenzimet përmbareme nga kontrata kolektive, sipas avokatit të komunës, kemi mjaft. Ne po mundohemi me e bërë të pamundurën për me i kry obligimet, me mos na

u grumbullu mjetet në Thesar nëpër kategori apo fonde programe, por ata prap e bëjnë të veten, sikur vitin e kaluar. Nga shtatori me një buxhet minimal kemi operu deri në fund të vitit. Këtë vit pritët që 1 milion e 95 mijë euro janë nga kapitalet dhe nga shërbimet publike 100 mijë euro, nga javët e kaluara janë marrë nga Departamenti i Shërbimeve Publike, janë ekzekutu, janë stonu prap sot në mëngjes kur kemi hy, kanë fillu me i ekzekutu pa dëshirën tonë, pa planin tonë. Drejtor, mu më kanë urdhëru edhe planin e rrjedhjes së parasë t'ia rregulloj Thesarit, me i marrë paret nga muaji maj-qershor për me i qitë në muajin prill për ekzekutim. Nuk është ndonjë problem se ata për një minut e rregullojnë vetë, por duhet me bë përpjekje çka mundemi me i ikë obligimeve me shpenzu buxhetin, dhe në fund ata, sikur para dy viteve, me na kompensu obligimet, si në vitin 2024 që kanë shtu buxhet 2 milion e 450 mijë euro në fund të vitit.

z.Ekrem Abazi: Prej kah i ke marrë paret me ju dhanë shumë njerëz? I keni marrë në punë me kontratë mbi vepër – prej cilit kod i keni marrë këto pare?

z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa: Kontrata mbi vepër i kemi vetëm 2 punëtorë. Kurse me Caritas-in dhe Kosova Med-in, ata nuk janë me kontratë mbi vepër, por janë me thirrje publike për kryerjen e shërbimeve.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Kërkojen shumë përgjigje dhe në shumicën e rasteve edhe unë jam i barabartë me Majlindën, edhe unë jam ekzekutiv sikur edhe ti. Të vijnë pasqyrat financiare 7-8 herë si këshilltare e Kuvendit Komunal, por janë shumë të paqarta. Unë e di që ti i kupton, por po don me i ngrit si çështje. Majlinda e the mungesën e transparencës, unë konsideroj që Komuna më transparente është vësitirë me u gjet, për shkak se ti nuk do të kishe mundur me bisedu vetëm për anët negative, por edhe për anët pozitive që i kanë vetë pasqyrat financiare, që nënkupton që është një lloj transparence. Këto pasqyra financiare do të dalin edhe në uebfaqen e komunës. Keqplanifikim dhe keqmenaxhim – unë konsideroj se as nuk ka keqplanifikim dhe keqmenaxhim. Krejt ju e dini se kontrata kolektive na ka prishur planifikimin dhe strukturën, dhe ndoshta të çon me u duk si keqmenaxhim, sepse ti ke planifikuar diçka tjetër, por mjetet janë marrë dhe nuk ke mundur me i realizu. Qysh ta quash, nuk është kjo problematikë vetëm e Komunës së Vitisë. E di që dikush thotë po don me i ikë përgjegjësisë, por po ju them me përgjegjësi të plotë, edhe pas takimit që kam pasur me kryetarin, dhe dje në takimin e bordit të Asociacionit të Komunave, shumica e komunave janë në buzë të bankrotimit, dhe burimi i kësaj është kontrata kolektive. Unë pajtohem që jo të gjitha vendimet vijnë vetëm nga kontrata kolektive, por 95% e rasteve të vendimeve gjyqësore burojnë prej saj. Sepse ti ke hyrë në marrëdhënie kontraktuale, dhe kur vjen koha nuk i ke mjetet, dhe ato pastaj obligohen me vendime gjyqësore. Pse nuk është bërë zgjidhje për këtë çështje është temë tjetër, por fakti është që nuk ka përfashtim – të gjitha komunat e Republikës së Kosovës janë në këtë situatë. Te lejet e ndërtimit, unë kam qenë vetë drejtor. Te çështjet ku mundesh me pas një planifikim sado pak, si te tatimi në pronë, e din sa e planifikon për vitin e ardhshëm. Por aty ku varet nga kërkesat e qytetarëve, nuk mundesh me qenë saktë, sepse nuk e din cilët qytetarë janë në gjendje me investu vitin tjetër, prandaj ka dallime. Shërbimet këshilldhënëse vijnë nga marrëveshja me AZhR dhe kontrata me Kosova Med-in. Te shtypja dhe printimi, është kontratë e nivelit qendror, dhe ata e kontrollojnë sa është printuar, ta sjellin faturën dhe ti je obligativ me e ekzekutu. Edhe te telefonia mobile kemi shpenzuar, por ende nuk janë ekzekutuar pagesat, sepse kemi obligime. Unë të kam thënë edhe në seancën e kaluar që rreth 4.5 milion euro i kemi regjistru si obligime për vitin 2026, prandaj shumica e këtyre janë ato. Mirëmbajtja e rrugëve lokale nuk ka kontratë fikse për sasinë e shpenzimit, sepse nuk e dimë sa borë do të bjerë apo sa do të prishen rrugët. Është kornizë dhe në bazë të punës bëhet faturimi dhe ekzekutimi. Te shpenzimet për përfaqësim brenda vendit, këto besoj që Berati i saktëson në seancën e ardhshme. Te investimet kapitale, ndoshta ti nuk mundesh me ditë, por Komuna e Vitisë nuk është shumë e madhe që mos me ditë ku po punohet. Investimet nuk janë gjithmonë konform nevojave bazë, por janë konform kërkesave dhe programit të kandidatit që ka fitu për kryetar komune. Visar, pajtohem që duhet reduktim i shpenzimeve, sepse ndoshta nuk jemi në krizë ekonomike, por në krizë komunale jemi. Elsa, për vendimet gjyqësore nuk kam informatë të saktë sa janë obligimet, por besoj që janë diku kah përfundimi, edhe pse ka edhe shumë në pritje. Ekremi e shtoi se mjetet vetanake janë të ulëta për shkak të tatimit në pronë, por pritët përmirësim në gjashtëmujorin e dytë, megjithatë nuk pritët ndonjë rritje e madhe, sepse kapaciteti i Komunës së Vitisë është rreth 1.2–1.3 milion euro maksimum. Shkalla e shpenzimit

është e madhe dhe do të jetë edhe më e madhe. Për çdo ditë ballafaqohemi ku me i marrë mjetet dhe ku me i lënë obligimet. Ndonjëherë është vijë e kuqe, dhe mjetet janë tërhequr. Specifikimin e investimeve kapitale e marr si obligim t'i sjell të gjitha që u kërkuan. Te investimet kapitale, shumica janë projekte të realizuara vitin e kaluar dhe janë ekzekutuar këtë vit, sidomos rrugët rurale dhe kanalizimet.

z.Ekrem Abazi: Te shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale u mor vesh që, te Kosova Med-i po shkojnë gjysma. Berat, a po sheh që nuk është siç the ti, por keni marrë punëtorë lidhje-palidhje kur i keni marrë gjatë zgjedhjeve, dhe tash kah fundi i marsit keni fillu disa me i hekë, dhe shkojnë do pare për këtë. Thash unë, këto që keni mundësi me i ndal, ndalni. Ato që i ndal gjykata është shtet në veti, ajo është tjetër punë, por këto që i keni bërë ju për interesa personale, ulni dhe hiqni gati krejt, sepse nuk keni nevojë. Nëse keni nevojë për ata punëtorë, shpallni konkurs për ata punëtorë, nuk ke nevojë me më sjellë shënime hiq, se e kuptova.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Edhe këtë pjesën e telefonisë fikse është mirë me e nxjerr sakt, edhe pse nuk është vetëm shpenzim i telefonisë fikse, sepse më së paku përdoret telefonia fikse. Por aty hyjnë edhe gjëra tjera që është mirë me qenë edhe si informatë.

znj.Majlinda Shabani: Po i drejtohem zyrtarit, sepse unë e kuptoj që duhet me u rregullu struktura buxhetore dhe ai e ka aspektin e tij profesional. Tash, nëse flasim në gjuhën e një profesionisti dhe e kuptojmë natyrën e punës që bën, jemi në rregull me këtë pjesë. Por nëse flasim në aspektin e qytetarit të Komunës së Vitisë, i cili kërkon me ditë se ku po shkojnë paratë e qytetarëve, është një paqartësi shumë e madhe. Nënkrjetar, të dëgjova me vëmendje. Nga fjalimi im nuk e largoj asnjë pikë e presje të asaj që kam thënë për transparencën që duhet me pas në shpenzimin e parasë publike dhe sidomos te transparenca buxhetore, sepse duhet me pas parasysh që kjo matet edhe te indeksi i transparencës buxhetore, se sa po del Komuna e Vitisë. Prej komplet diskutimeve që i bëmë, unë te vendimet gjyqësore e bëra pyetjen dhe po mendoj që, përpos që është pagesë që nuk varet prej juve, të paktën mundeni me dhanë sqarim se cili investim ka qenë i planifikuar që është marrë prej pagesave të vendimeve gjyqësore. Deri sa në prezantimin analitik të investimeve kapitale, prej 30 emërtimeve, 12 prej tyre i ke që janë vendime gjyqësore, andaj këtu duhet me pa secilin emërtim që figuron te prezantimi analitik i investimeve. Kur të marrim sqarim për këto 12 emërtime që keni bërë se cilat shkojnë, atëherë mundemi me qenë më në rregull. U diskutuan shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale dhe u morëm vesh që janë kontrata që keni lidhur me Kosova Med dhe AZHR. Këtu e kam problemin unë te AZHR, sepse ka qenë diskutim që e kam ngrit edhe vitet paraprake. Janë njerëz që janë të punësuar në kuadër të kësaj marrëveshjeje që ju e keni bërë. Unë nuk e kuptoj çka bëjnë ata njerëz që marrin paga çdo muaj nga Komuna e Vitisë, dhe aty është një shumë e majme. Duhet me pas edhe këtu sqarim se çka bëjnë ata persona dhe ku hyjnë në punë këto shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, qoftë prej personave që janë të kontraktuar përmes AZHR-së për Komunën e Vitisë, dhe me ditë më saktë ku shkojnë, çka i shërbejnë komunës dhe investimeve që bëhen për këtë. Thashë keqplanifikim dhe keqmenaxhim, sepse pikërisht e përmenda edhe në fillim që te investimet kapitale nuk është raporti real i investimeve që janë bërë në tremujorin që është raportuar këtu. I përmenda edhe ti që janë para që janë bërë pagesa prej investimeve që kanë qenë më herët.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Megjithatë, për disa informata tjera nuk kërkohen te kjo pikë, por kërkohet me ardhë me pikë të veçantë ose me shkresë, sepse vijnë përmes drejtorive se çka punojnë. Pikat për të cilat jemi sot janë të shpenzimeve dhe të hyrave se çka është bërë për këtë tremujor.

z.Illir Zuka: Në KPF kam ngritur një problem, nuk e di a është marrë nënkryetari me të. Te tatimi në pronë, njëri prej asambleistëve tha që nuk kanë ardhur faturat. Faturat kanë ardhur, por diçka nuk është në rregull dhe duhet me i shiku, sepse mua personalisht çdo vit më ka ardhur mbi 50 euro, ndërsa këtë vit më ka ardhur vetëm 10 euro.

z.Ekrem Abazi: Ty të ka ardh faktura, e shumices së qytetarëve nuk ju ka ardh.

z.Basri Aliu: U diskutua shumë në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës. Herën tjetër do ta kisha lutë drejtorin apo zyrtarin që me i hyrë shifrave me rend, t'i lexojë një nga një, që mos të kemi nevojë ne me i lexu edhe një herë të gjitha, dhe me u kry puna më efikase dhe më shpejt. U diskutua rreth shpenzimeve se si kanë ndodhur. Unë thashë që këto kanë mundur me ndodh edhe vitin e kaluar, domethënë grumbullohen faturat dhe paraqiten në këtë tremujor. Një shpenzim shumë i madh, njësoj edhe ti që e përmenda kryesues, te telefonia mobile, dhe

aty është problemi i njëjtë: janë grumbullu faturat e vitit të kaluar, të cilat nuk janë kryer dhe në këtë tremujor janë kryer dhe paraqiten si shpenzim i madh. Gjithashtu te telefonia mobile hyn edhe interneti, nuk është vetëm puna e telefonave, por edhe interneti që e përdorin disa zyra nëpër ndërtesat komunale. Ju kisha lutë të gjithëve që të përcaktohem i te pika e rendit të ditës dhe te efikasiteti i saj, sepse ne kërkojmë sa punëtorë ka një kompani. Numri i punëtorëve duhet të kërkohet te kompania që e ka kontratën, dhe këtu nuk ke nevojë me e ngrit, sepse nuk ka të drejtë askush me e ditë numrin e një kompanie tjetër. Prandaj të jemi të sinqertë dhe të mos bëjmë pyetje që nuk na përkasin as neve si Kuvend, as ekzekutivit.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Çdo informatë që bëhet me pagesa nga buxheti komunal, përgjegjës për buxhetin komunal është Kuvendi Komunal, ndërsa për ekzekutimin është ekzekutivi. Domethënë, për çdo shpenzim që bëhet, anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë me kërkë informata. Të gjitha informatat është mirë me u sjellë dhe me u ditë.

z.Illir Zuka: Nuk pata asgjë me asnjë asamblist, veç kur e ngriti atë mu kutjua se bëra një kërkesë në KPF drejtoreshës dhe nënkryetarit. Me këqyr si problem.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ishte një diskutim mjaft frytdhënës nga të gjithë diskutuesit paraprak dhe u cekën të arriturat, të metat dhe të gjitha të tjerat. Kam një pyetje të thjeshtë: janë mbi 4 milionë obligime, ndërsa në raportet financiare të çdo fundviti, që i bie edhe për vitin 2025, është thënë që realizimi është bërë 98% i planit të buxhetit. Prandaj pyes: si kanë mbetur këto obligime? Kur do të shlyhen këto obligime dhe nga do të shlyhen? A do të ndikojnë për vitin 2026 dhe nga do t'i merrni paratë për shlyerjen e tyre? E di që do të ceket kontrata kolektive, por pyetja ime është si do të shlyhen konkretisht këto obligime.

z.Ekrem Abazi: Basria shkoi se kesh tu i thanë që pikën e parë e kemi pasqyrat financiare janar-mars 2026. Ai mu nuk mundet me m'kallxu çka thom unë; pyeti çka du unë. Unë jam tu folë për këto pasqyra, e ti je me m'tregu që këto shpenzime janë të vitit 2025.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Ekrem, po filloj prej teje. Shumë saktë e ke thënë se propozues i buxhetit është ekzekutivi, aprovues i buxhetit është kuvendi dhe ai që e aprovon ka të drejtë me kërkë llogari gjithëherë. Remzia ka shtrur një çështje që është me të vërtetë shumë problematike për neve si ekzekutiv, që ka me shkaktuar problem edhe për kuvendarët, por që ka me reflektuar edhe te qytetarët. Remziut nuk është tu i dhimt borxhi real prej 4 milionë eurosh, por është tu i dhimt që ndoshta kanë me na ekzekutu, nuk kemi mundësi, vonohemi edhe kanë me na qu në përmbarues, e tani shtohen edhe nga 600-700 mijë euro. Kjo më dhemb ma së shumti, se krejt këtë rrëmujë të realizimit të kontratës kolektive, unë si nënkryetar komune kam pa një përfitim marramendës të përmbaruesve dhe avokatëve. Nuk mu ka dhimt ajo që i kanë marrë profesorët dhe arsimtarët, për shkak se ka qenë kontratë e nënshkruar, por më është dhimt që nuk e kemi ba në koordinim apo bashkëpunim me qeverinë me gjet çelësin qysh me pagu borxhin real të atyne që kanë qenë nënshkruar të kontratës, por kemi pagu edhe nga 40-50% ma shumë. Pikërisht këto obligime të grumbulluara prej 4.5 milionë eurosh, ishalla merrim me i realizu pa vendime gjyqësore, që me pagu vetëm bazën e borxhit e jo edhe kamatat, përmbaruesit, avokatët e tjera. Qysh do t'i paguajmë? Unë e shoh vitin 2026 shumë problematik, bile edhe fillimin e vitit 2027. Ndoshta po mendoj sipas raportimeve të djeshme që kanë raportu deri tash të gjitha komunat. Siç raportoj kryetari, 350 milionë euro për krejt komunat është fjala, ndërsa në mesin e tyre Komuna e Vitisë është diku 9 milionë euro. E tani, siç tha kryesuesi, 13 milionë euro ia kanë marrë Ferizajt. A do të ulen me gjet një çelës që të rimbursohen këto? Kjo e ka edhe aspektin praktik edhe ligjor, për shkak se ne nuk kemi qenë nënshkruar të kontratës. E dyta, edhe tentativën tonë me kriju borxh në ekzekutim nuk na kanë lanë. Nuk e di, por a kemi me qenë në situatë të randë në 2026 dhe në periudhën e parë të vitit 2027? Po ta garantoj që po.

z.Remzi Salihu: Faleminderit, nënkryetar, për përgjigjen, por megjithatë unë po shoh se gjithmonë këqyret faji me iu lanë dikujt tjetër. Unë dua me dalë edhe në politikë, se pikërisht këtu mendoj që kemi qenë ma të zëshëm në kuvend rreth kontratës kolektive. Ojatë asaj kohe kam qenë edhe në procesin mësimor që të bëhet një kontratë mes punëtorëve të arsimit dhe Komunës së Vitisë, me u tejkalu kjo çështje që na ka brengos atëherë, e që kryetari vazhdimisht e ka injor. Me thanë që kjo kontratë është bërë pa na pyet neve dhe ne nuk diskutojmë fare për këtë, a ka pas mundësi që të mirren vesh edhe kuvendi ta marrë një vendim që ai obligim të bëhet me pagesë, qoftë me këste, qoftë mujore, nuk e di në çfarë mënyre, por vetëm që të rregullohet e të mos vijmë në

këtë situatë që jemi tani. Sepse mbi gjysa e këtyre mjeteve kanë shku pa nevojë hiq në vendime gjyqësore, ku përmbaues, avokatë etj., domethënë ma shumë kanë marrë pare ata sesa kanë marrë punëtorët e arsimit apo edhe disa të tjerë që faktikisht, sipas kontratës, ka qenë obligim me i pagu. Prandaj unë mendoj dhe qëndroj prapë në ato bindjet e mia se kjo ka qenë e mundur të rregullohet para 4 viteve. E ka neglizhu kryetari i komunës, prandaj kemi ardhë deri në këtë situatë. Natyrisht nuk po e shfaqësoj askënd, se shumë kush ka faj këtu, por në këtë rast, sa i përket raportit të Komunës, unë mendoj se fajn kryesor e ka kryetari i Komunës së Vitisë.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Remzi, ajo është bindja jote, por unë po ta jap një sqarim. Për fat të mirë paskemi edhe zyrtarin e lartë financiar, të cilit edhe në takim unë së bashku me kryetarin i kemi thanë se duhet me pyet në Prishtinë me ba një kod në ekzekutim të kontratës kolektive. Po ta them me bindje të plotë, se është këtu njeri, të cilët kur kanë pyet, nuk na kanë leju. Prandaj nuk ekziston ajo bindje të cilën po e thu se e ka anashkalu. Unë e di si çështje kur e ke ngrit ti një herë, e di që kemi mbajt mbledhjen e kuvendit në shkollën e mesme teknike, e ka ngrit edhe kryesuesi, por krejt këto kanë shku në adresë që je obligativ me i pyet për hapjen e kodeve. Dhe mundësitë, tani kur t'ish hap kodit, kishin ekzistuar edhe mundësitë e arritjes së marrëveshjes në ekzekutiv, por kemi hasë në pengesa; kanë thanë që nuk mundemi.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Është përnjëmend e dhimbshë, sa i kam përcjell statistikat e vitit të kaluar te kontrata kolektive, që diku rreth 45% kanë shku në procedura te përmbauesit e avokatët; domethënë pak mbi 50% kanë shku te mësimdhënësit. Kjo është ma e randa, që gati gjysa e mjeteve kanë shku tjetërkund.

z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa: Kryesues, ke qenë edhe ti në takim në Gjilan, kur s'un i kam arsyetu te pagat 350 mijë euro. Ke qenë aty dhe shumë mirë kam qenë i kjartë se 350 mijë euro kam kërku që në Kornizën Afatmesme Buxhetore mjete shtesë për pagesën e kontratës kolektive. Kjo ka qenë diku në vitin 2023/24. Dhe 250 mijë euro mbetje gjatë vitit për punëtorët që nuk janë në punë. E din atëherë që Departamenti i Buxhetit na i nxori neve dhe gjithkomunave, ka thanë që nuk keni të drejtë asnjë cent me planifiku për problemin e kontratës kolektive. Atëherë ka qenë e vogël, ka 600/700 mijë euro vjetorja, dhe nuk na kanë leju. Edhe pas pyetjeve të gjitha komunave tjera, në forumet që i kemi mbajtë, takimet me Departamentin e Buxhetit, nuk ka ekzistuar një gatishmëri e Ministrisë së Financave për me na leju neve, bile së paku me bë një pjesë të planifikimit të disa mjeteve për këtë destinacion.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Faleminderit për debatin. Kjo pikë është vetëm informacion, nuk del në votim, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale (NPL) në Komunën e Vitisë

z.Arton Musliu, drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Para jush paraqes vendimin për nisjen e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike lokale, e cila do të ketë një mori përgjegjësish që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve publike efikase, efektive dhe transparente në raport me qytetarët e Komunës së Vitisë. Qëllimin e themelimit të ndërmarrjes publike e keni edhe në vendimin para jush. Unë kam përfshi katër qëllime kryesore, të cilat më vonë mundën edhe me u ndërthur me qëllime tjera. Pra, menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave dhe aseteve publike përmes ofrimit të shërbimeve cilësore dhe efikase në komunë; Kursimi i taksave për qytetarët që shkojnë për pagesa të shërbimeve që i ofrojnë operatorët ekonomikë privatë; rritja e përgjegjësisë dhe transparencës gjatë ofrimit të shërbimeve publike; zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve që u ofrohen qytetarëve të Komunës së Vitisë. Në kuadër të përgjegjësive që kemi parapa bashkë me ekzekutivin, e që do të parashihen në kuadër të ndërmarrjes publike, janë këto: menaxhimi i stacionit të autobusëve; menaxhimi i tregjeve; menaxhimi i parkingjeve publike; mirëmbajtja e hapësirave publike, shesheve dhe parqeve; mirëmbajtja e objekteve publike; mirëmbajtja dhe pastrimi i shtretërve të lumenjve; mirëmbajtja e varrezave dhe shërbimet e varrimit; menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave; dhe përgjegjësi tjera që ndërlihen me shërbime publike, pra përgjegjësi që do të dalin si nevojë për qytetarët e Komunës së Vitisë ndërkohë gjatë realizimit të themelimit të kësaj ndërmarrjeje publike. Baza ligjore për themelimin e kësaj ndërmarrjeje publike ekziston në Ligjin për ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, respektivisht neni 6, si dhe në Rregulloren për kriteret e formimit të ndërmarrjeve publike, neni 4 paragrafi 1. Sipas nenit 6 të Ligjit

për ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, komunat kanë të drejtë të krijojnë ndërmarrje publike lokale në pajtim me kriteret e përcaktuara me akte nënligjore të qeverisë. Kriteret duhet të përfshijnë kërkesa të arsyeshme për qëndrueshmërinë financiare dhe operacionale të ndërmarrjes. Siç e thashë edhe në fillim, ndër arsyet kryesore të themelimit të ndërmarrjes publike lokale janë çmimet e larta që komuna paguan për shërbimet që i ofrojnë operatorët ekonomikë privatë. Qëllimi është që mjetet që i paguajnë qytetarët e Komunës së Vitisë të mos shkojnë si fitim për operatorët ekonomikë privatë, por si shërbim ndaj qytetarëve të komunës. Siç e dimë të gjithë, relacioni mes komunës dhe operatorëve ekonomikë privatë që ofrojnë shërbime në lëmin e shërbimeve publike nuk është as i thjeshtë dhe as i lehtë. Si rezultat i kësaj, kemi vështirësi në realizimin e shërbimeve që ne i kemi obligim ligjor me i kry, duke fillu prej pamundësisë së realizimit të pagesave në kohë të arsyeshme e deri te injorimi i operatorëve ekonomikë privatë për me i kry punët për të cilat janë të obliguar përmes kontratës që e kanë me komunën. Arsyeja e dytë është cilësia e dobët që ofrojnë operatorët ekonomikë privatë gjatë shërbimeve që ata i ofrojnë. Pra, kontrolla që ne e bëjmë është deri diku e mirë, mirëpo ne nuk kemi shumë mekanizma me i detyru ata me i përfundu punët ashtu siç janë me kontratë për shërbime, për shkak se nëse hyjmë në ciklin e ballafaqimit me operatorët privatë, ne rrezikojmë me i humb shërbimet që komuna i ofron. Për këtë arsye, qasja e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, por edhe e komunës, është që të gjendet një rrugë e mesme në mënyrë që edhe të rrisim mbikëqyrjen dhe transparencën, por edhe të mos mbesim pa shërbime që ata i ofrojnë. Arsyeja e tretë për themelimin e kësaj ndërmarrjeje publike është neglizhenca në ofrimin e shërbimeve publike. Kemi operatorë ekonomikë privatë apo operatorë publiko-privatë të cilët hezitojnë me i kry punët ashtu siç janë të obliguar në bazë të kontratës apo marrëveshjes. Një prej rasteve është rasti me Ekohigjienën. Ekohigjiena, siç e dini ju, është operator publiko-privat ku Komuna e Vitisë është aksionare aty, mirëpo trajtimi i mbeturinave nuk është në nivelin më të mirë të mundshëm. Unë si drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, bashkë me ekzekutivin dhe kryetarin, i kemi marrë disa hapa për me e ngrit vetëdijen rreth trajtimit të mbeturinave, mirëpo ende jemi larg qëllimit. Nga 7885 familje që ka Komuna e Vitisë, vetëm 4811 janë të regjistruara në Ekohigjienë, që i bie 61%, ndërsa 3074 nuk janë të regjistruara. Ato shtëpi që nuk janë të regjistruara në Ekohigjienë i hedhin mbeturinat në vende të paautorizuara dhe kjo paraqet problem për neve. Pra, njëra prej qëllimeve që ne kemi iniciu për themelimin e kësaj ndërmarrjeje publike është që shërbimet publike me qenë transparente, efikase dhe qytetari me pasë sakt adresën se ku dhe si mundet me i realizu shërbimet që ata kanë nevojë. Përndryshe, trendi për themelimin e ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës është në rritje. Aktualisht 14 komuna kanë themelimit të ndërmarrjeve publike lokale, gjithashtu ka edhe disa komuna që janë në pritje të vendimit nga qeveria, duke qenë se kanë bërë kërkesë që nga viti 2022 për themelimin e ndërmarrjeve publike, mirëpo qeveria ende nuk ka marrë vendim për themelimin e tyre. Statusi ligjor i ndërmarrjes publike do të jetë shoqëri aksionare e ndarë prej komunës. Në momentin që themelohet ndërmarrja publike, komuna nuk ka të drejtë të përzihet në menaxhimin e saj, për shkak se kjo kompani do ta ketë bordin e drejtorëve, bordin e aksionarëve dhe bordin e menaxhmentit. Sa i përket qëndrueshmërisë financiare, ne kemi raste konkrete të qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjeve publike që aktualisht funksionojnë. Për shembull, ndërmarrja publike "Tregu" në Gjilan ka të hyra vjetore 447 mijë euro, ndërsa shpenzime 413 mijë euro. Apo ta zëmë "Eko Natyra" në Skenderaj ka shpenzime 202 mijë euro vjetore, ndërsa të hyra ka 203 mijë euro. Dua të them që qëndrueshmëria financiare e ndërmarrjes publike është e garantuar, për shkak se këtë e kallxon edhe grafika, por edhe kalkulimet që ne i kemi bërë si komunë na japin siguri që qëndrueshmëria financiare e kësaj ndërmarrjeje publike ka me qenë e lehtë dhe e përballueshme. Edhe në aspektin e formimit dhe funksionimit të ndërmarrjeve publike lokale jashtë Republikës së Kosovës, trendi është në rritje. Është një trend i deprivatizimit të shërbimeve publike gjithandej botës dhe, nëse marrim krahasimisht disa shtete, të gjitha këto shtete kanë nisë një cikël të ri të themelimit të ndërmarrjeve të reja publike, për shkak se qëllimi është që shërbimet publike që i ofrojnë operatorët ekonomikë privatë aktualisht nuk janë të kënaqshme dhe komunat po shkojnë drejt asaj që shërbimet publike prapë të deprivatizohen dhe t'i ofrojnë vetë. Unë besoj që kjo nismë është e mirë, qëllimi dhe vullneti janë për me bë diçka të mirë për Komunën e Vitisë dhe ky është vetëm një vendim për fillimin e procedurave për themelimin e ndërmarrjes publike. Pasi të votohet ky vendim në Kuvendin Komunal, atëherë duhet të shkojë në Ministrinë

e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe më vonë duhet me i fillu procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike, të cilat janë procedura jo të lehta. Dhe krejt në fund, në mënyrë që ne me i fillu këto procedura, duhet me kalu vendimi në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Kjo është vetëm një nismë. Në kuadër të kësaj nisme ka mbetur procedura që, në momentin që lejohet prej ministrisë, kanë me fillu procedurat që na takojnë neve si komunë dhe prapë me ardhë në kuvend, me e bërë themelimin në kuvend. Kjo është një nismë që para 6 viteve, me Hekremi, e kemi nisë kur kemi pasë kërkesë me dhanë në shfrytëzim stacionin e autobusëve të Gjilanit. Ne atëherë kemi kërku që të bëhet një ndërmarrje dhe kemi pasë pengu me votë që mos me i kalu stacioni i autobusëve, por me u bërë një ndërmarrje e tillë komunale dhe me i shti disa shërbime tjera.

z.Basri Aliu: Lidhur me këtë pikë, ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim themelimin e ndërmarrjes publike lokale, e cila është e përcaktuar edhe me ligj, që ka mundësi dhe rregullore mbi themelimin e këtyre ndërmarrjeve. Duke pasë parasysh se punët të cilat do të kryhen, dmth, do të kryhen në territorin e komunës së Vitisë dhe do të menaxhohen prej njerëzve të komunës së Vitisë, sepse shpesh ka ndodhë që punët të cilat i kemi dhanë, kanë ardhë kompani nga jashtë dhe ato distanca e kanë bërë të veten për mos-efikasitet, prandaj jemi të pajtimit që të shkojë si propozim në shqyrtim. Mandej vijnë edhe filtrat tjerë, të cilët do të vijnë te ne këtu, sepse ne jemi sigurisht edhe aksionarët më të mëdhenj. Kuvendi është themeluar i kësaj kompanie, sepse si aksionar ne do t'i kemi 2 anëtarë, ndërsa ekzekutivi 1 anëtar. Prapë vjen në filtrat tanë dhe mos ta pengojmë procesin dhe idenë të cilën e kemi marrë përpara.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Në mënyrën se si rregullohet, prap krejt ka me vendos kuvendi.

z.Visar Demiri: Dhe ne si grup i PDK-së jemi pro kësaj nisme, me shpresë që do të ofroj shërbime më cilësore, efikase për qytetarë të Komunës së Vitisë. Drejtori i dha sqarimet dhe bazën ligjore.

znj.Majlinda Shabani: Po më vjen mirë që kjo puna e themelimit të ndërmarrjes publike ka qenë në plan-programin tonë qeverisës, kështu që është marrë si ide. Ne e kemi pasë në plan-programin tonë. A është dashtë me u nisë ma herët si iniciativë? Është dashtë me u nisë, po tash më mirë vonë se kurrë. Unë po e shoh se sa seriozisht e ka marrë drejtori këtë çështje, po në situatën që jemi dhe që gjendemi si komunë, unë i kam ato dyshimet e mia se sa ka me qenë i realizueshëm ky themelim i kësaj ndërmarrjeje. E kemi shumë të qartë nevojën se sa është e nevojshme me u bërë themelimi i kësaj ndërmarrjeje, tue i përfshi edhe shërbimet që kanë me qenë në rritjen e cilësisë, e çka është më e rëndësishme, qëndrueshmërinë që duhet me qenë në komunën e Vitisë. Ka qenë shumë e nevojshme. Asesi nuk du me besu, dhe natyrisht që kemi me përcjellë në vazhdimësi se si ka me shku, nuk du me besu që kjo ka me qenë veç si ide për klientelizëm politik apo shpërdorim të parasë publike. Thashë, nevoja është shumë e madhe, mirëpo forma dhe ideja qysh është prurë në kuvend komunal len hapësirë për dyshime. Nuk e di drejtori a është i informuar me situatën që kemi në Komunën e Vitisë dhe se a ka me pasë hapësirë në planifikimet paraprake që kemi pasë dhe në programet qeverisëse të juaja. Tash sa vite janë bërë në qeverisje, nuk është që kemi pa diskutim për një themelim të ndërmarrjes publike. Atëherë, a ka me qenë i realizueshëm?

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: E vetmja formë që mundet me ardhë në kuvend komunal është: e bëjmë propozim-vendimin, e protokolojmë, ma sjellin mua, e bëj rend të ditës dhe e bi. Kjo formë ka ardhë. Në formë tjetër nuk mundet me ardhë në kuvend kurrë asnjë pikë. Forma është në rregull. E dimë që procedura është e gjatë, por çka na lehtëson është që krejt këto shërbime që i blejmë ne përmes tenderave prej kompanive tjera, këto shërbime me i ofru komuna është e mirë. Ka me na u vonu kjo ndërmarrje deri sa të bëhet, por për të ardhmen është e mirë.

z.Elham Emerillahu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Rastësisht e kam pasë si çështje diskutimi, pata mendu për këtë seancë, por ja që erdhi edhe si pikë e rendit të ditës. Mendoj që është njëra prej çështjeve më të rëndësishme në kohën e fundit e cila ka ardhë për diskutim këtu. Nuk e di pse më herët nuk është iniciu themelimi i një kompanie apo ndërmarrjeje komunale. Ky koalicion qeverisës ka qenë edhe 4 vitet e kaluara bashkë, kanë pasë mundësi me inic, tue e marrë parasysh shpenzimet dhe mjetet financiare të cilat komuna i paguan për mirëmbajtje dhe shërbime publike. Prandaj, është një rrugë e gjatë për themelimin e kësaj ndërmarrjeje. Uroj që ky proces që ka fillu të shkojë deri në fund dhe të merret shumë seriozisht, sepse rëndësia

e saj është shumë e madhe. Procedurat janë të gjata. Unë jam interesu këto ditë dhe, me konsultat me drejtorin, dmth është një rrugë e gjatë, por që jemi vonë, jemi vonë. Ndoshta është dashtë me rishiku mundësinë, për shkak të mirëfunksionimit të saj, është dashtë me kqyrë mundësinë edhe për publiko-private, dmth me kqyrë me harmonizu, sepse nuk është bash lehtë. Unë e di që disa komuna së fundmi kanë themelu. Kjo nuk varet krejt prej kuvendit komunal, as prej ekzekutivit. Mesa e kam kuptu, është edhe një këshill ndërministror që duhet me miratu, pastaj me kalu në qeveri. Në qeveri mundet me qenë dikush tjetër, jo i koalicionit qeverisës komunal etj., etj. Por, në aspektin procedural dhe të rregullores për themelimin e kësaj ndërmarrjeje, komuna dhe drejtoria duhet të jenë shumë të përgatitura. Labinot Bislimi ka dërgu një mesazh, kryesues, për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Unë mendoj që anëtari i kuvendit duhet me qenë shumë serioz, sepse kemi përgjegjësi para qytetarit, kemi përgjegjësi ligjore. Çdo kërkesë e anëtarit të kuvendit, edhe kur nuk mundet me qenë këtu, edhe kur mundet me çu një kërkesë për një çështje, për këtë është sekretaria e kuvendit. Elham, qeveria është e Republikës së Kosovës, kushdo që është.

zn.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Sinqerisht, nga ajo që u tha, deshta me e përgëzu drejtorin te një pjesë të cilën e përmendi për menaxhimin e mbeturinave, se si komunë sa keq qëndrojmë, për shkak se çdo herë, viteve paraprake, gjatë muajit prill, kryetari Sokol Haliti ka dalë me deklarata të ndryshme duke e proklamuar komunën e Vitisë edhe me tituj që komuna e Vitisë nuk ka nevojë për pastrim. Mandej këtu kemi mirri deri aty sa me thanë që kaq mirë qëndrojmë. Sa i përket kësaj pike, po na kërkohet me marrë një vendim të madh për komunën e Vitisë, me votu për me u formu një Ndërmarrje Publike Lokale, për të cilën po thuhet se me themelimin e saj disa nga qëllimet kryesore, i keni përmend 9 pika: menaxhimi i hapësirave dhe aseteve publike, ulja e kostos për qytetarët, rritja e transparencës, zgjerimi i shërbimeve. E kompetencat keni thanë se drejtohen te stacioni i autobusëve, parkingjet publike, hapësirat publike (parqe, sheshe), objektet publike, pastrimi dhe mirëmbajtja, menaxhimi i mbeturinave dhe varrezat. Kjo ka qenë një ndër informatat që më së shumti kemi diskutu në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe të gjithë kemi qenë të dakordum se fillimisht problemi kryesor qëndron se ky dokument është shumë i përgjithshëm. Për një temë kaq serioze dhe me qëllime kaq të zgjerume, materiali na është ofru vetëm në dy fleta, në të cilat ajo pak përmbledhje e shkurt që e keni ba, jeni mundu me u duk se krejt është në rregull. Keni vendos fjalë bajagi të mira, premtime për përmirësim, për kursim, për shërbime ma të mira. Po kur i lexon këto dy faqe, mandej përfundimi na çon krejt diku tjetër. I nderuar, ky dokument që e kemi përpara është i cekët. Nuk ka analizë financiare. Nuk ka studim fizibiliteti. Nuk ka plan konkret se qysh ka me funksionu kjo ndërmarrje. Pra, me pak fjalë, neve në kuvend komunal po na kërkohet me votu një ide, jo një projekt. Edhe sinqerisht, unë po du me ju pytë drejt: a ka kush këtu që e din sa ka me i kushtu kjo komunës? Sa punëtorë kanë me u punësu? Sa ka me përfitu qytetari konkretisht? Se në bazë të informacioneve që na i keni ofru, unë nuk e di. Edhe as në dokument nuk shkruhet. Edhe diçka tjetër: për këto shërbime që i keni përmend që kanë me u ofru këtu, kush na garanton neve që këto shërbime që po doni me i marrë, nuk janë tue funksionu tash e kanë me funksionu shumë ma ndryshe e shumë ma mirë? A keni ba analizë, apo veç po doni me ndryshu diçka për me kriju një strukturë të re? I nderuari drejtor, nuk keni qenë prezent në mbledhjen e KPF-së dhe aty e kam përmend si këshilltare komunale dhe kam qenë shumë e qartë: na nuk jemi kundër përmirësimit të shërbimeve, na nuk jemi kundër ndërmarrjeve publike, po jemi kundër kësaj mënyre të punës pa plan, pa analiza, pa transparencë. Këto janë pikat themelore. Duke u bazu në atë çka diskutova ma lart, ky propozim nuk duhet me kalu kështu siç është. Edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam kërku me e sjell me informacione ma të zgjerume, me sjell shifra, plan konkret dhe me pasë material me fakte konkrete, e jo propozim dyfletësh. Se pas këtij votimi, qytetarët atje jashtë presin prej neve përgjegjësi dhe sqarim me ju ofru se çka ka me ndodhë ma tutje, për shkak se është temë që ka ndikim të madh tek ta. E me kalu ky diskutim në forma të tilla, sinqerisht, as na këtu që jemi prezent pozitivë e opozitivë me përfundu me idenë që mos me ditë as çka jemi tue votu, është vërtet shumë jo e hijshme.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Liridona, kemi diskutu edhe në komitet që për sot nuk ka mujtë me ardhë ma shumë se kjo, sepse është veç nismë. Kur ta themelojmë, duhet me pasë statut e gjithëcka. Tash është vetëm një nismë për me na leju ministria me punu.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Liridona, kemi diskutu edhe në komitet që për sot nuk ka mujtë me ardhë ma shumë se kjo, sepse është veç nismë. Kur ta themelojmë, duhet me pasë statut e krejt dokumentacionin përkatës. Tash është vetëm një nismë për me na leju ministria me vazhdu procedurat. Liridona, është mirë me qenë dhe me u sjellë në konformitet me pozitën që ke. Është mirë mos me sjellë dezinformata në kuvend. Kur thua që Sokol Haliti ka thënë “nuk ka nevojë me pastru se Vitia është e pastër”, kjo është e pavërtetë, shumë e pavërtetë. Nëse një njeri i kushton çështjes së ambientit në nivel të Republikës së Kosovës, me siguri do të ishte kampion dhe iniciativat i ka pasë dhe i ka. Në çdo ditë të shënuar që është në kalendar botëror dhe shtetëror, Sokol Haliti është prezent dhe shumë i përkushtum në këtë çështje. Sa i ka arritë qëllimit është çështje tjetër, po me thanë “ka thënë kështu” nuk është mirë, sepse duhet me qenë e përgjegjshme dhe e sjellshme në kuadër të pozicionit që ke. Edhe e përmende ju, këshilltarët e Vetëvendosjes, çështjen e transparencës. Unë nuk e di ku e keni gjetë atë mocion. Ju nuk jeni tu e kuptu vetë çka është transparenca, me të vërtetë nuk po e kuptoni. Majlinda dhe Liridona, nuk po e kuptoni. Krejt jeni sjellë te pasqyrat financiare, “nuk ka transparencë”, “nuk ke ofru argumente” – dhe këto janë të pavërteta. Ky është një propozim-vendim që e kam thanë edhe në KPF, që e kemi zbërthi mirë edhe kryesuesi ka ndihmu në këtë drejtim. Është një iniciativë për themelim. Ka me shku në qeveri, aty ka komisione që kanë me thanë me përgatit këtë dokument, këtë dhe këtë, për me i plotësu kushtet për themelim. Pastaj vjen në kuvend, ku aprovohet edhe statuti i themelimit. A do të bëhet apo nuk do të bëhet nuk varet krejt prej neve. Gatishmëria jonë është për me u bë, dëshira e shumë këshilltarëve është për me u bë. Unë e di që ty disa emra këtu të kanë ba të padurueshme, por qytetarët kanë thënë ashtu. Në momentin që nuk është kryetari i komunës prezent këtu, jo rastësisht Ligji për vetëqeverisjen lokale e ka përcaktu nënkryetarin, dhe nënkryetari e mbulon atë fushë. Unë nuk e di, Majlinda, a ke mbetë ndonjëherë që ke shtrë pyetje dhe nuk ke marrë përgjigje.

z.Ekrem Abazi: Për mua personalisht është një iniciativë e mirë kjo që ka fillu. E përmendët që vjen në qeveri, por nuk ka lidhje, asnjë qeveri nuk e pengon komunën për punë të mira që i kryen, përkundrazi i përkrah. Unë e përkrah shumë mirë. Para 5–6 viteve kemi pengu dy herë stacionin e autobusëve me ju dhanë Gjilanit. Ka ardhë iniciativa e dytë, mes kryetarit të komunës së Gjilanit dhe komunës së Vitisë, dhe kemi arritë qëllimin me e pengu. Ndoshta atëherë u dok keq, por sot duket mirë, sepse sot stacionin e autobusëve e ka komuna e Gjilanit. Edhe këtë mandat që shkoi është pengu, d.m.th tri herë është pengu që mos me marrë stacionin e autobusëve Komuna e Gjilanit.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Në Gjilan, stacioni i autobusëve është ndërmarrje komunale. D.m.th, stacioni i autobusëve në Viti është kërku me iu kalu ndërmarrjes komunale të Gjilanit për menaxhim, dhe kjo ka qenë kundërshtimi që kemi pasë. Kemi kërku që të jetë një ndërmarrje e komunës së Vitisë. Dhe sot ky është qëllimi, që kjo me hy në këtë menaxhim që jemi tu e kërku.

z.Ekrem Abazi: Dhe tjetra, e pashë mirëmbajtjen e varrezave dhe shërbimet e varrimit. Çka nënkupton kjo? Sepse ne në një mandat kemi marrë një vendim që edhe hapjen e varreve me e bë komuna. Ka qenë PDK në pushtet, por nuk është zbatuar kurrë. Dhe tash, çka keni parapa ju me shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjen e varrezave?

z.Arton Musliu, drejtor: Mua më vjen mirë që shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal janë të pajtimit për me vazhdu me procedurat për themelimin e ndërmarrjes publike lokale. Qëndrimet pro dhe kundër, jo kundër themelimit apo qëllimeve, janë shumë normale. Lidhur me Majlindën, ideja për themelimin e ndërmarrjes publike ka qenë e jona. E përmendi Majlinda, unë për vete nuk e kam ditë që ka qenë në plan-programin e Lëvizjes Vetëvendosje, për besë nuk e kam ditë. Te qëndrueshmëria financiare, unë veç e përmenda: kemi raste konkrete të funksionimit të qëndrueshëm financiar të ndërmarrjeve publike lokale në Kosovë, dhe kjo nuk mundet me qenë përjashtim. Lista e asetëve dhe hapësirave publike që do të menaxhohen nga ndërmarrja publike lokale e keni përpara, dhe të gjitha këto gjenerojnë të hyra. Veç me i marrë e me i kalkulu të hyrat që gjenerohen nga mbledhja e mbeturinave në Komunën e Vitisë, del një shifër e

konsiderueshme e akumulimit të hyrave për qëndrueshmërinë financiare të komunës. Kjo është shumë lehtë e verifikueshme. Te qëllimi, po vendosen disa pikëpyetje rreth qëllimit. Unë po të siguroj që ne si ekzekutiv qëllimin e kemi të mirë. Qëllimi është me ju ofru qytetarëve të Vitisë shërbime më të mira se ata që kanë aktualisht. Sa kemi me mujtë, varet prej shumë faktorëve, por konceptualisht jemi në rrugën e duhur që kjo ndërmarrje publike, në momentin që funksionalizohet, me qenë në shërbim të qytetarëve. Liridona, the që e pranova që me çështjen e mbeturinave jemi koq. Kqyre, edhe komunat që udhëhiqen prej Vetëvendosjes nuk janë më mirë. Merri e analizo, i ke raportet zyrtare të Ministrisë së Mjedisit. Mënyra më e mirë për me i vlerësu gjërat është duke i krahasu, nuk mundemi me u krahasu me vetveten. Qytetarët e Vitisë janë qytetarë që prodhojnë mbeturina për kokë banori ndër më së shumti në krejt Kosovën. Kjo është një faktor i rëndësishëm pse ka më shumë mbeturina në Viti, Gjilan, Mitrovicë e Lipjan sesa në komuna tjera, sepse qytetarët e këtyre komunave gjenerojnë mbi 1 kilogram mbeturina për kokë banori, ndërsa shumica kanë 0.7, ne e kemi mbi 1 kg. Arsyeja e dytë është funksionimi jo i mirë i Ekohigjienës apo i kompanive për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave. Tash ne kemi gjetë një situatë ku Ekohigjiena nuk ka qenë shumë e kujdesshme në raport me këtë problem, dhe bashkë me ekzekutivin, kryetarin dhe disa këshilltarë komunal kemi shty këtë çështje në nivel tjetër. Kemi rritë bashkëpunimin me Ekohigjienën dhe mund t'ju them që pas këtyre aksioneve numri i familjeve të regjistruara për trajtim dhe grumbullim të mbeturinave është rritë, diku mbi 300 regjistrime të reja vetëm gjatë këtij muaji. The që dokumenti është i shkurtër. Liridona, vendimet janë prej dokumenteve të shkurtra. Gjeje një vendim që i ka 100 faqe, nuk ka. E para. E dyta, po të sfidoj: gjeje një vendim më të gjatë dhe më konciz se ky vendim prej krejt komunave që i kanë themelu ndërmarrjet publike. Asnjë vendim i ndërmarrjeve publike të themelume që janë iniciu prej kuvendeve komunale nuk është më i gjatë se ky, sepse siç tha edhe kryesuesi i kuvendit, ky është vetëm vendim për nisjen e procedurave. Më vonë bëhet plani i biznesit, qëndrueshmëria financiare dhe të tjera, të cilat unë vetë nuk muj me i bë, por duhet me u bë një grup punues bashkë me zyrtarë të komunës dhe ekspertë të fushës. Edhe te shërbimet e varrimit, po, ndërmarrja publike lokale parasheh edhe mbulimin e shërbimeve të varrimit.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Unë edhe më herët thashë, këto çështje kanë me ardhë të gjitha, sepse themelues është Kuvendi. Të gjitha këto kanë me ardhë, kanë me u formu grupet punuese, kanë me u trajtu dhe kanë me u punu me diskutime publike. Të gjitha kanë me qenë.

zn.Liridona Bislimi: Drejtor, faleminderit shumë për elaborimin e diskutimit. Unë nuk është që kam bërë analizë për komuna tjera, sa i përket materialeve që kanë ardhë. Unë kam bërë analizë me materialet tona që i kemi pasë paraprakisht, për kalimin e një rruge prej privat në publik. Kemi pasë material shumë voluminoz, po e zë si shembull, sepse kohëve të fundit jemi tu pasë shumë materiale të tilla dhe u bazova në atë që pata me diskutu, dhe e përfundova. Nuk dashta me bë replikë, por nënkryetar, po më vjen shumë keq se mënyra e diskutimit si po e bën, kur e dëgjojnë qytetarët, duket sikur me të vërtetë është ashtu. Ma së pari, forma cinike dhe ofenduese, thuse ne nuk jemi tu e ditë se çka është tu ndodhë në komunën e Vitisë. Tash jam tu hy në vitin e 9 të nivelit të qeverisjes lokale, dhe puna ime si këshilltare komunale është me u marrë me angazhimet e nivelit ekzekutiv, duke fillu sidomos prej të parit të Vitisë. Në Klan Kosova e ke videon me titull "Vitia nuk ka nevojë për pastrim", nisë kështu video, "dalim për aksion, por banorët e komunës së Vitisë nuk kanë shumë mbeturina për t'u pastru", qeshtu nisët video. Çka tash unë ndryshe prej kësaj që ke këtu? Bile çka është më interesant që ka ndodhë para 7 viteve, gazetari paska thanë se janë të ndaluara ndërtimet në zonën afër lumit Morava.

z.Elham Emërllahu: Ne shumica e asamblistëve e përkrahim si ide dhe urojmë që të shkojë deri në fund. U tha që ka qenë ide e jona, por unë nuk e di, sepse të paktën kandidatin tonë për kryetar komune nuk e kam dëgjuar ndonjëherë në fushata. Këta të Vetëvendosjes thanë "na e paske marrë idenë", ti the që ka qenë ide e jona. Tash nëse është ide momentale që e ke pru, po. Unë për këtë e kam dëgju veç Labinot Bislimin në fushatë. Ta marrim seriozisht këtë punë. Unë e kam diskutu edhe në seancën kur kanë ardhë shpenzimet e vitit 2025. Dmth janë mijëra, për mos me thënë qindra mijëra euro të shpenzuara nga komuna për mirëmbajtje të hapësirave dhe shërbimeve publike. Dmth rëndësia është e madhe edhe mundësia për me kriju është e gjatë, e vështirë, e rëndë, duhen shumë procedura, shumë rregullore, shumë ligje me i përputh mes vete. Uroj që ne ta

përfundojmë të gjithë së bashku. Me dhanë ide nuk është keq, veç duhet me u dëgju. Unë e di që keni numrin në Kuvend Komunal, mundeni me i bë krejt, po ju ka dhënë mundësia drejtorit të shërbimeve publike. Muaji prill gjithmonë është muaji i pastrimit dhe ishalla nuk mbesim, sepse drejtori i shërbimeve publike dhe drejtori i urbanizimit na kanë "bombardu" me fotografi në këtë kohë. Por mos të harrojmë se edhe viteve të kaluara komuna e Vitisë muajin prill gjithmonë e ka pasë muaj të pastrimit, e ishalla nuk mbesim vetëm te pastrimi.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Janë disa data që mundet edhe me u qitë fotografi, por menaxhimi i mbeturinave është i përditshëm dhe gjithmonë është i kushtueshëm. Gjithçka që bëhet, që ndërtohet, që vihet në funksion, më shtrejt kushton mirëmbajtja sesa ndërtimi.

z.Basri Aliu: Ne vetëm dolëm prej rendit të ditës me njëfarë forme, se u diskutua edhe për menaxhim të mbeturinave. Për idenë kush e ka dhënë për me formu këtë kompani: ideja e di që ka qenë diku edhe në 2011, po është problemi që nuk ka pasë aspekt ligjor. Andaj, dhe iniciativa që merret tash, ju kemi afru kontratës që kemi me "Ekohigjenën" në 2027, dhe tash ka mundësi me u kriju një kompani, që me qenë të gatshëm që në 2027 me marrë kompania për menaxhimin e mbeturinave. U përmend se Komuna e Vitisë ka mbeturina shumë. E vërtetë është që ka mbeturina, po në krahasim me komunat tjera, Komuna e Vitisë është me standard më të lartë – mundeni me i pa edhe e Komunën e Ferizajt etj. Po nuk do të thotë që ne nuk duhet me punu në këtë drejtim, që sa më shumë të eliminojmë këto dukuri, por tu u nisë prej vetvetes, prej secilit këshilltar komunal, sepse secili kemi ndikimin diku për me kriju ambient sa më të pastërt. "Ekohigjena" i kryen punët e veta që i ka, ndërsa aty ku nuk janë deponitë e përcaktueme për me i hudhë mbeturinat, "Ekohigjena" nuk i kryen, dhe kështu që na mbeten neve për me i kry.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Duhet me ditë që Ekohigjiena është për mbeturinat e amvisërisë, mos t'i përziejmë nganjëherë kompetencat. Ekohigjiena nuk është komunale dhe i ka specifikat prej qeverisë që janë të përcaktuara. Mirëpo, ku nuk kanë kompetenca ata, ne duhet me ndërmarrë masa si komunë dhe me i menaxhu. Ju falënderoj për debatin dhe diskutimin. Kisha kërku që ta votoni këtë pikë, pra me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim miratohet kjo pikë.

Si pikë e katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e parcelës kadastrale të pronës komunale

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: E keni propozim vendimin para jush. Unë nuk do të lexoj përveç propozim-vendimit. E keni dokumentacionin komplet: propozimin për ndarjen e parcelës nga gjeometri i licencuar, e keni edhe certifikatën dhe komplet dosjen. E keni edhe mendimin e Drejtorisë së Urbanizimit, si dhe kërkesën e personit në fjalë, Nikoll Jakovi. Besoj që lënda është e kompletuar. Materialin e keni marrë me kohë. Çështja është për ndarjen e një prone që është pronë komunale, për me u kategorizu si rrugë. Prandaj është në vlerësimin e juaj që sot ta shqyrtoni dhe me shpresë ta miratoni.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Më saktësisht, pjesa që është te ndërtesa e IPKO-s, ajo me xhama, ajo pjesa në mes të dy ndërtesave. Ka bërë pronari kërkesë që me u prish IPKO-ja, me u lëshu prona komunale dhe me u bë rrugë ajo pjesë që e lidh atë parcelë. Dokumentacionin e kanë pru drejtorit përkatës. Hapet debati për këtë pikë.

z.Basri Aliu: Ne si grup i LDK-së, pasi që është interes i popullatës me u hapë hapësira dhe me pasë dalje, po edhe mos me i pengu investitorët që janë aty, e përkrahim këtë iniciativë dhe jemi pro.

z.Remzi Salihu: Unë deshta me pyet rreth ndërtesës: çfarë statusi ka kjo ndërtesë, kush është pronar i saj, edhe çfarë statusi ka, a është pronë private dhe a është ndërtesa e legalizuar?

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Unë besoj se si pronë është pronë private, kur flasim për ndërtesën e IPKO-s, atë me xhama. Ndërsa a ka leje ndërtimi apo nuk ka, këtë nuk e di, nuk i kam dokumentacionet. Vetëm e di që në atë kohë gjykata ia ka njohë të drejtën e pronësisë. Ndërsa a është legalizu apo jo, këtë nuk e di.

z.Remzi Salihu: Kjo me siguri do të hyjë me ndonjë marrëveshje për prishjen ose mosprishjen e saj. Nëse nuk është e legalizuar, atëherë pse me marrë ndonjë përgjegjësi komuna me e kompensu? E pash që nuk ka kompensim, por nganjëherë gjërat bëhen, masanej, pasi të kryhet puna, kërkohet kompensimi.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim: a jeni që të kalojë kjo pikë e rendit të ditës? Me 14 pro, 0 kundër, 5 abstenim, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për transferin (Rialokimin) e mjeteve buxhetore në programin buxhetor në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

z.Berat Zuka, zyrtar financiar: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Kemi një propozim-vendim për transferin e dy fondeve burimore, nga fondi burimor grant qeveritar dhe nga fondi burimor të hyrat vetanake. Mjetet e dy projekteve do të barten, ose do të rialokohen, në projektin e ndërtimit të tribunave të stadiumit në Pozharan, kodë i projektit 54884. Shuma prej 10 mijë euro nga granti qeveritar dhe 10 mijë euro nga të hyrat vetanake, si dhe dy projekte të tjera të njëjta nga fondi burimor të hyrat vetanake, do të barten në këtë projekt. Kjo nënkupton që gjithsej 40 mijë euro barten për ndërtimin e tribunave të stadiumit në fshatin Pozharan. Këto projekte janë në listën e buxhetit të Republikës së Kosovës, të miratuara me buxhetin e vitit të kaluar për vitin 2026. Kërkohej që projekti i ndërtimit të tribunave të stadiumit të fshatit Pozharan të kompletohet me mjetet e nevojshme për fillimin e procedurave të prokurimit.

z.Basri Aliu: Në këtë kemi diskutu edhe në KPF dhe, duke pasë parasysh se çrregullimi i sistemit buxhetor ka ndodh për disa efekte tjera, Thesari po i tërheq mjetet dhe po mbesin kodet buxhetore pa mjete. Pasi që është interes i ndërtimit të stadiumit të Pozharanit, dhe duke qenë se ka qenë obligim ndoshta edhe i Ministrisë së Kulturës, por duke pasë parasysh që ata nuk po intervenojnë në këtë drejtim, atëherë ne e përkrahim këtë iniciativë që ky projekt të përfundojë.

z.Elham Emerllahu: Po më vjen mirë që edhe në seancën e kaluar kemi pasë një diskutim bashkë me drejtorin për kulturë, rini dhe sport, si shqetësim për kushtet në të cilat zhvillohen ndeshjet dhe për tribunat në stadiumin e Pozharanit. Edhe mua më vjen mirë që ky ndryshim po vjen sot, që ai projekt me u realizu.

z.Illir Zuka: Një pikë jashtëzakonisht e mirë për Pozharanin, për komunën e Vitisë, për Vllazninë e Pozharanit që është duke i mbrojtë ngjyrat e gjithë qytetarëve të komunës së Vitisë, që është e nevojshme. Uroj që kjo punë të nisë me procedura të përshpejtuara dhe të bëhet një tribunë, sepse në gjendjen që është stadiumi është keq. Në kemi bërë punë të mirë në zhveshtore dhe në fushë, por sot mundemi me thanë që është njëri ndër stadiumet e vetme në Kosovë që nuk e ka tribunën. Kështu që falënderoj Komunën e Vitisë që e ka parë të arsyeshme me e pru këtë projekt dhe uroj që të kryhet sa më shpejt.

znj.Majlinda Shabani: Edhe ne si grup i Vetëvendosjes, çdo iniciativë që shkon në interes të qytetarëve, sidomos në investime kapitale për të cilat ka nevojë, i mbështesim këto iniciativa dhe shpresojmë që këto mjete që kanë me u ridestinu me shku për ato projekte dhe me u realizu.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim: a jeni që të kalojë kjo pikë e rendit të ditës? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për kthimin e mjeteve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Para jush kemi një propozim-vendim të natyrës së njëjtë, por për punë të ndryshme, jo si ai i pari, për shkak se këtu kemi një propozim-vendim për ndryshimin e kategorive ekonomike të investimeve. Kemi një obligim ndaj DEMOS-it në shumën prej 105 mijë euro. Prandaj, obligimet të cilat i kemi duhet t'i kryejmë, edhe pse kemi pasë me i krye në vitin 2025. Megjithatë, nga përmbauesit na janë marrë njëherë, dhe tash është dashtë me i marrë nëpër kode tjera në formë që me i kompletu, në mënyrë që në raport me DEMOS-in mos me leju çështjen e ekzekutimit nga ana e përmbauesve privat. Obligimi jonë ndaj DEMOS-it është diku 105 mijë euro.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Obligimi ndaj DEMOS-it është për shkak të grantit që ka përfituar komuna nga DEMOS-i dhe për shkak që punët kanë qenë në përfundim dhe kanë qenë afatet e caktuara. Mjetet në kodin buxhetor janë marrë nga vendimet e gjykatave, dhe tash ato mjete që kanë shku për vendime të

gjykatave kanë mbetë borxh, sepse DEMOS-i nuk është pagu. Kam pasë takime, kërkesa dhe e-maila të shpeshta që në të ardhmen mos me i humbë grantet nga DEMOS-i, për shkak se komuna ka qenë bashkëpunuese dhe është përfituese e DEMOS-it në shumë vite me radhë.

z.Basri Aliu: E përkrahim këtë iniciativë, sepse donatorët duhet t'i ruajmë e jo t'i largojmë. Prandaj e kemi obligim edhe si Kuvend edhe si qeveri që obligimet ndaj donatorëve të kryhen. Andaj, për këtë nuk kemi shumë çka me diskutu, sepse obligimin e kemi ne, ndërsa ata i kanë kryer obligimet e veta. Edhe pa dashjen tonë, mjetet e tyre janë shfrytëzuar për qëllime të tjera nga Thesari, dhe ne duhet ta kryejmë obligimin ndaj donatorëve dhe të jemi serioz në këtë drejtim. Kështu që ne si grup parlamentar i LDK-së jemi pro kësaj pike.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet edhe kjo pikë? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet edhe kjo pikë.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim vendim për dhenje në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës së kompanis kosovare për distribuim me energji elektrike SHAAK në Viti për vendosjen e trafove elektrike

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Kjo pikë është diskutuar në fillim kur e kemi futur në rend të ditës. Zakonisht është praktikë, sidomos kur është për trafo për KEDS-in, dmth në të gjitha mandatet i kemi kaluar si procedura, sepse vetëm i kemi lehtësuar procedurat për qytetarët. Pra, pasi që nuk ka debat, a jeni që të kalojë kjo pikë? Me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Pyetje dhe përgjigje

z.Illir Zuka: Kam një falënderim për drejtorin e shërbimeve publike, sepse pas 6 muajsh ndriçimi publik në Pozharan është lëshuar, pasi kemi pasë probleme në rrugën kryesore. Po ajo që kemi hasë aty është që shumë drita janë të dëmtuara; besoj që edhe aty do të intervenohet dhe do të rregullohen. Po ashtu kam pasë një kërkesë: një deponi e mbeturinave ka qenë në Pozharan, në rrugën "Sabit Zuka". Më është premtu që do të merret me atë punë bashkë me Ekohigjienën dhe do të largohet prej aty, por ende nuk është largu, prandaj është mirë me u intervenu. Një pyetje për drejtorin e shëndetësisë: drejtor, ndriçimet brenda ambulants në QKMF në Pozharan kanë probleme dhe ka problem edhe me qentë endacakë. Kërkoj me ndërmarr diçka, sepse gjendja është shumë e keqe.

zn.Liridona Bislimi: Sa i përket pyetjeve dhe kërkesave nga qytetarët, i nderuar nënkryetar, unë kam vetëm një çështje që dua ta diskutoj dhe shpresoj që ky fjalim mos me përfundu vetëm si diskutim formal, pasi tema të cilën po e ngre është vërtet një shqetësim serioz institucional. Duke u bazuar në faktin që të njëjtin shqetësim e kam ngritë diku para një viti, është fjala për punëtorët e Gjendjes Civile në Komunën e Vitisë. Siç e përmenda, e kam ngritë të njëjtin shqetësim edhe vitin e kaluar sa i përket uljes së koeficientit të pagesës së tyre, dhe më vjen keq që fatkeqësisht po më duhet me e përsëritë prapë. Sepse nga 16 dhjetor 2024 e deri më sot kanë kaluar mbi 16 muaj pa asnjë vendim për këtë çështje. Dmth, kur ata e kanë dorëzuar këtë kërkesë te kryetari i komunës, i nderuar nënkryetar, sinqerisht këta punëtorë janë degradu në mënyrë të padrejtë nga profesioni 3 në profesionalin 2, e cila për qytetarët e komunës së Vitisë duhet me u sqaru që nënkupton ulje page, ulje dinjiteti dhe nënvlerësim të drejtpërdrejtë të punës së tyre. Dhe kjo nuk ka mujtë me ndodhë rastësisht, për shkak se këtu dihet që është mungesë e neglizhencës, mosveprimit dhe mungesë e vullnetit për me e zbatu ligjin. Sepse ligji e thotë qartë, katalogu i pagave është i qartë, detyrimet janë të qarta. Duhet me kuptu, nënkryetar, e kam pasë përmend edhe herën e kaluar gjatë diskutimit, dhe prap po e përsëris: po flasim për një numër mbi 50 punëtorë, mbi 50 familje, të cilave kjo pagë që janë duke e marrë tash nuk u shërben as për me i kry kërkesat për nevojat elementare. Dhe Gjendja Civile nuk është një zyrë e zakonshme, është hyrja e administratës, aty ku qytetari përballet çdo ditë me shërbime themelore. Dhe sot, pikërisht këto shërbime themelore, këta shërbyes civilë po trajtohen sikur me qenë punëtorët e dorës së fundit. Me keqardhje po e përsëris këtë shqetësim, për të cilin ka kaluar më shumë se një vit dhe ende nuk është marrë asnjë veprim nga ana juaj. Dhe unë sot po flas në emër të

tyre dhe prapë po ju kërkoj: korrigjimin urgjent të koeficientëve sipas ligjit dhe trajtim të barabartë për punëtorët e Gjendjes Civile.

znj.Elsa Jahija: Duke u bazuar në shqetësimet dhe kërkesat e drejtpërdrejta të banorëve dhe Këshillit të Fshatit Dobërdol, të cilët kanë kontribuar në mënyrë të jashtëzakonshme me punë vullnetare dhe mjete vetanake në realizimin e projektit që përfshin vendosjen e shkronjave të UÇK-së dhe krijimin e një kompleksi me përmbajtje rekreative-sportive, i cili pritet të përurohet më 14 qershor, si dhe duke pasur parasysh se kjo zonë është e paraparë si zonë turistike në Planin Zhvillimor Komunal, do të ishte me rëndësi për banorët e fshatit dhe për të gjithë qytetarët të dihet nëse Komuna ka planifikuar apo parasheh të ofrojë mbështetje konkrete institucionale në këtë fazë të përfundimit të projektit, veçanërisht në aspektin infrastrukturor, në mënyrë që ky projekt i ndërtuar me përkushtim të madh qytetar të finalizohet me standarde të duhura, të zhvillohet në përputhje me potencialin që ka dhe të shndërrohet në një pikë referimi për zhvillimin lokal. Në përmbyllje, duke pasur parasysh vlerën simbolike që bartin këto shkronja për historinë dhe identitetin tonë, si dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të banorëve në realizimin e projektit, vlerësoj që ky investim duhet të marrë mbështetjen e merituar institucionale. Përkrahja e komunës në këtë fazë do të ishte jo vetëm një vlerësim i drejtë për këtë iniciativë qytetare, por edhe një hap konkret drejt fuqizimit të një projekti që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin lokal, promovimin e zonës si destinacion turistik dhe në të mirën e përgjithshme të komunës.

znj.Majlinda Shabani: Së pari dua të ndërlidhem me çështjen e hartave zonale. Besoj që ka qenë një temë që ka bërë një bujë të madhe për mënyrën se si është zhvillu i tërë procesi. Dhe unë e di që tash e një vit ne veç se kemi mbajtur një punëtori ku kemi qenë edhe ne si pjesë e opozitës. Dua të pyes: çka është tu ndodh me ato harta zonale, a janë finalizu apo nuk janë finalizu? Sepse është një vit që ka shku dhe procesi është tu marrë kohë, dhe gati ka arritur afati i ligjshmërisë së tyre. Prandaj dua një sqarim se çka është tu ndodh me hartat zonale. Pyetja tjetër ka të bëjë me transportin publik. E kam si pyetje dhe si shqetësim për drejtorin, por besoj që, nënkryetar, mundesh me u përgjigj edhe ti. Po du me e ngrit si çështje, sepse transporti publik besoj është njëra prej shqetësimeve që çdo qytetar i komunës së Vitisë e ka, sidomos ato fshatra dhe lagje që janë më në periferi. Dua me pyet a është mendu ndonjëherë prej komunës rreth transportit publik dhe përfshirjes së fshatrave në transport. Gjithashtu edhe me drejtoreshën e arsimit kisha pyet: transporti i nxënësve në shkolla qysh është i rregulluar dhe a ka mundësi me u përfshi apo me u bë diçka në këtë drejtim. Ne e patëm pikën e parë ku u diskutua për pasqyra financiare dhe u pa që janë tu u shpenzu mijëra e miliona euro në kode buxhetore, dhe kjo është një nevojë bazike që duhet me e pas secila lagje dhe secili qytetar. E di që ndoshta vijn kohë për me u implementu, por është diçka që duhet me u nisë dhe me u mendu më seriozisht në këtë drejtim. Pyetja tjetër për shërbimet publike: në seancën paraprake i kam adresu disa shqetësime që i kam pasë edhe me prishjen e asfalteve në disa vende në regjionin përreth Vitisë, dhe ende nuk është intervenu në ato vende ku ka prishje. Rruga që shkon direkt prej Vitisë për në Pozharan ka gropa shumë të mëdha që duhet me u intervenu. Gjithashtu kam bërë kërkesë edhe rreth disa deponive ilegale, ku njëra është aktuale në fshatin Lubishtë, afër rrugës "Qëndresa". Ajo rrugë frekuentohet prej nxënësve, aty është xhamia dhe shkolla, dhe është kriju një deponi shumë e madhe. Mendoj që duhet me u intervenu urgjentisht. Drejtori më ka thënë që kanë me shku me e pa gjendjen.

z.Nuhi Ramadani: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Sot ngre një shqetësim serioz të banorëve të fshatit Verban, me hapjen e rrugës që lidhë Begracën me fshatin Verban, Goshic. Është kriju një korridor i rrezikshëm për automjetet që kalojnë aty pari. Kjo rrugë po përdoret gjithnjë e më shumë nga fshatrat Verban, Begrac, Goshic, Smirë dhe anasjelltas, si pasojë është rritë ndjeshëm rreziku për këmbësorët, sidomos nxënësit e shkollës. Banorët ndihen të rrezikuar dhe kërkojnë ndërmarrjen e masave për rritjen e sigurisë rrugore, si vendosja e shenjave orientuese, kufizimi i shpejtësisë, rregullimi i trotuareve dhe ndriçimi i rrugës. Është detyrë e përbashkët e jona që t'i sigurojmë lëvizje të sigurt qytetarëve, veçanërisht fëmijëve.

z.Lulzim Haxhiu: Përsëritet për të gjithë të pranishmit. Kam një pyetje për nënkryetarin lidhur me faturën e pagesave të kartelave. Në mbledhjen e kaluar është thënë që për sot do të sillen edhe fatura prej 500 eurove që i jepet Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve.

z.Hajdin Ademi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Kam një kërkesë prej një lagjeje të fshatit Skifteraj, lagja Shabiu, e cila ka bërë kërkesë për shtrimin e rrugës me asfalt. Është kërkesë e kahmotshme dhe deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim. A ka mundësi dhe a do të ketë shtrim të asfaltit në këtë rrugë?

z.Ekrem Abazi: Unë nuk kam pyetje, por kërkesa. Kërkesa e parë është në lidhje me banimin social. Një ditë e pash që qeveria, për ata që kanë hapësirë me ndërtu banesë për banim social, të gjitha shpenzimet i paguan komuna, po i nevojitet vetëm me caktu vendin se ku. Prandaj kisha kërku që të caktohet një hapësirë, në mënyrë që me fillu procedurat për banim social. Kërkesa e dytë është asfaltimi i rrugicave. Neve na duket punë e thjeshtë, ka rrugica me metra jo shumë të gjata, por prej atyre rrugicave gjithmonë asfalti po del i dëmtuar dhe po zhytet. Nuk besoj që shkojnë shumë mjete financiare, po kryhet një punë e madhe, sepse qytetarët edhe kalojnë vetë dhe me vetura, dhe kur po dalin në asfaltin kryesor, krejt po zhytet asfalti.

z.Remzi Salihu: Unë pata dy pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike, por pasi që drejtori nuk është këtu, kërkoj që të më sjellë me shkrim në seancën e ardhshme. E para: çka është ndërmarrë për sanimin e gjendjes së kanalizimit në fshatin Remnik, pikërisht në lagjen Sejdiaj, kur dihet që për këtë problem kam qenë duke e ngritë këtu në Kuvend prej tre vitesh. Plus, edhe familjarët e kanë ngritë këtë çështje në organet përgjegjëse në komunë. E dyta: çfarë plani ka për sanimin e deponive në gjithë territorin e Komunës së Vitisë? Dhe diçka dua me e theksu: për këtë çështje ne si grup i VV-së e kemi kundërshtu që pika për pyetje dhe përgjigje të mos jetë në fund të seancës, sepse tash edhe unë kam punë dhe vetëm për këtë kam prit me i bë këto pyetje, plus kam pasë edhe vizitë te mjeku.

z.Elham Emërllahu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Dua ta ngre si shqetësim, ose si temë, që unë personalisht kam një përvojë bukur të gjatë në arsim. E nderuar drejtoreshë, do të doja që Drejtoria e Arsimit si njëra prej dikastereve kryesore në ekzekutiv të ishte më aktive në kuptimin e përgjegjësisë dhe detyrave institucionale, në përputhje me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm. Përgjegjësia për organizimin e arsimit është e DKA-së. Meqë jam nga fusha dhe jam përballë, si të gjithë kolegët e tjerë në arsim, me sfidat dhe problemet që e preokupojnë arsimin në komunën e Vitisë dhe në nivel vendi, por ne po flasim për komunën tonë, është shqetësim i përgjithshëm që ka qenë dhe është aktual. Është hera e parë që po e diskutoj dhe kisha pasë dëshirë me debatë sinqerisht me drejtoreshën, nënkryetarin dhe të gjithë akterët, se a ka ndonjë ide apo propozim DKA-ja dhe ekzekutivi për me u marrë pak më shumë me arsimin dhe me hartu një strategji bashkë me të gjithë neve këtu që jemi profesionistë, asambleistë, profesorë dhe mësimdhënës. Komuna e Vitisë ka kuadro të jashtëzakonshëm që mund të japin kontribut të madh në hartimin e politikave të mira për arsim. Tjetra, jemi dëshmitarë të gjithë të rënies së madhe të numrit të nxënësve. Kam marrë statistika prej vitit 2015 dhe janë statistika të tmerrshme të rënies së numrit të nxënësve. Kjo është shqetësim për të gjithë, nuk është vetëm për komunën tonë, por çuditërisht komuna jonë është ndër komunat me rënie më të madhe të nxënësve në nivel vendi; më duket vetëm Kamenica është para nesh. Me këtë pasojë duhet të gjithë të përballemi. Po e shoh edhe raportin e investimeve që na e solle nënkryetar, dhe e di edhe vetë që në shkollën ku unë jam punëtor janë bërë investime në shkolla, palestra dhe fusha sportive, por shqetësimi në vazhdimësi që na ka përcjellë si mësimdhënës është mirëmbajtja: higjiena, sanitaret, mjetet e punës dhe kabinetet. Ka rreth 10 vite që në shkollat e komunës së Vitisë sikur nuk është bërë një strategji e mirëfilltë për digjitalizim të shkollave, tabela digjitale dhe kabine funksionale, sepse kemi disa kabine jo shumë funksionale. Jam këtu me mundësitë dhe kapacitetet e mia, bashkë me ju, me drejtoreshën dhe të gjithë akterët, që të paktën prej vitit shkollor 2026–2027 ta marrim pak më seriozisht këtë punë. Ka shumë vërejtje në mirëmbajtje, pastërti dhe higjienë. Unë shumë pak po e shoh drejtoreshën në vizita në shkolla. E pash para 2–3 ditësh bashkë me drejtoreshën e QKMF-së në imunizim, dhe kjo është shumë mirë, por ju kisha lutë që, meqë i kemi rregullu shkollat dhe ambientet rreth tyre janë relativisht të mira jashtë, brenda kemi probleme. Në fshatin Gërmov kam ankesa të jashtëzakonshme nga këshilli i prindërve dhe kolegët, sepse ka vetëm një punëtor mirëmbajtës. Ky vit ka qenë vit i rëndë për arsimin në Vitë, sidomos për shkak të numrit të madh të orëve të humbura, mbi 7 mijë orë si rezultat i anulimit të konkurseve për zëvendësim të mësimdhënësve ose plotësim të mungesave në shkolla. Në Gërmov, tash e sa kohë, tre klasa nuk kanë mbajtur mësim në lëndën e gjeografisë, që është shqetësuese. Të gjitha këto që po i them, drejtoreshë dhe ekzekutiv, ju kisha lutë të ulemi dhe me u marrë seriozisht me këtë çështje, sepse nuk

kemi më atë numër nxënësish që kemi pasë në vitin 2010 e tutje; numri është përgjysmuar dhe ka hapësirë për me bë punë më të mira, sidomos në mirëmbajtje. Një tjetër çështje: mësimdhënësit kanë problem me fotokopje dhe pajisje elementare. Ne jemi të ngarkuar shumë me administratë, materiale dhe plane. Në disa shkolla nuk ka letër, nuk ka printera, nuk ka ngjyrë. Nuk do të kushtonte shumë për komunën e Vitisë me i siguru këto gjëra bazike, dhe me i pajisë shkollat me tabela digjitale dhe me i funksionalizu kabinetet, sidomos ato të teknologjisë. Prandaj ju kisha lutë miqësisht dhe kolegjisht të ulemi së bashku, sepse ju keni mandat deri në vitin 2030 si drejtoreshë e arsimit dhe ne duhet me u marrë seriozisht me këtë sektor. Edhe një problem tjetër: është kërku raportit shëndetësor ose certifikata për herë të parë për mësimdhënësit. Shumë mirë që është bërë kontrolli mjekësor, por më ka bërë përshtypje që një operator privat e ka kry më lirë këtë shërbim sesa QKMF-ja, edhe pse flasim për rreth 800 mësimdhënës në komunën e Vitisë. Për mua ka qenë e habitshme që një operator privat del më lirë se institucioni publik.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Privati e cakton çmimin vetë, ndërsa QKMF-ja e ka të përcaktuar me rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba. Për këtë arsye, ata nuk mund të bëjnë lëvizje të çmimeve. Konkurrenca e bën të vetën.

z.Halil Musliu, drejtor: Shqetësimi që patët është i drejtë dhe legjitim. Të njëjtin shqetësim e kanë përcjellë edhe punëtorët e QKMF-së, dhe unë e kam proceduar te drejtoria. Dje ekipi ka dalë në terren për evitimin e defektit, por defekti ka qenë i natyrës pak më të rëndë dhe do të trajtohet sot ose në ditët në vijim, derisa të sanohet. Sa i përket certifikatës shëndetësore, ajo është kërkesë e ministrisë dhe nuk është kompetencë e organeve komunale. Tash problemi është se ne nuk e dimë saktë cilat veprime shëndetësore duhet me u ndërmarrë, a kërkohe analiza apo çfarë saktësisht. Privati e ka më lehtë, sepse mund të lëshojë një letër blanko pa shumë kosto; e dimë si funksionojnë një pjesë e operatorëve privatë, por realisht nuk ka mundësi që privati me qenë më i lirë se institucioni publik. **z. Elham Emerllahu:** Nëse është blanko, DKA-ja nuk duhet me ia pranë mësimdhënësit.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Megjithatë, institucionet, si private ashtu edhe shtetërore, janë të licencuara dhe, pa qenë të licencuara, nuk mund të lëshojnë dokumente.

z.Elham Emërllahu: Edhe ne, si kryesues, nëse na kërkohet si asambleistë me bë një certifikatë të tillë, duhet me shku në privat.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Çdo institucion që është i licencuar nga institucionet e Republikës së Kosovës është valid, kudo që përdoret.

z.Valmir Sahiti, drejtor: Dhe një sqarim shtesë rreth Elhamit dhe çështjeve të stadiumit që i ka ngritë në seancën e kaluar: ajo që kam ngritë nuk ka qenë vetëm deklarim, por kanë qenë dy pika të rëndësishme të sportit, siç janë dy projekte: stadiumi i qytetit dhe tribunat te "Vllaznia" e Pozharanit, të cilat tashmë janë drejt zgjidhjes. Para dy ditëve, së bashku me kryetarin e komunës dhe mekanizmat tjerë relevantë, si dhe me përfaqësues të Federatës së Futbollit të Kosovës, e kemi vizitu stadiumin e qytetit. Kemi bërë të gjitha matjet dhe, brenda pak ditëve apo javëve, do të vazhdojnë procedurat tjera dhe fillimi i punimeve, me qëllim që të rikthehet njëherë e përgjithmonë stadiumi i qytetit në gjendje të gatshme për përdorim nga shkollat e futbollit dhe klubet e qytetit të Vitisë. Një lajm i mirë është që nga vjeshta edhe Klubi Futbollistik Vitia do të rikthehet në gara. I falënderoj të gjithë këshilltarët komunalë që e kanë aprovuar bartjen e mjeteve për alokimin e tyre në projektin e stadiumit të Pozharanit, dhe tashmë të dy këto projekte po futen drejt fazave përfundimtare.

zn.Zyrafete Rama, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Rreth pyetjes së këshilltares Majlinda për hartat zonale: para dy javësh kemi marrë pëlqimin si drejtori prej VSM-së, ku jemi tash në fazën e dytë dhe jemi duke punuar në atë drejtim. Besoj që shumë shpejt kemi me marrë prapë lajmin tjetër, që do të fillojmë me shqyrtimet publike dhe do të vazhdojmë tutje. Për momentin jemi në fazën e dytë dhe më 8 maj jemi në Ministrinë e Mjedisit bashkë me zyrtarët, dhe besoj aty do të marrim informata se kur do të dalim në shqyrtime publike.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Janë drejtuar disa pyetje rreth Drejtorisë së Arsimit dhe bashkëndej me to. I nderuar z. Elham, jo vetëm në Komunën e Vitisë, por në të gjithë Republikën e Kosovës është rënia e numrit të nxënësve, e cila është mjaft shqetësuese si për ne ashtu edhe për komunat

tjera. Strategjia aktuale e arsimit 2022–2026 veç ka skaduar dhe tani është në vlerësim. Aktualisht kemi bërë planifikimin dhe jemi në fazën e grumbullimit të të dhënave, për të harmonizuar planifikimin tonë me strategjinë e re. Në Gërmov është e vërtetë që kemi vetëm një punëtor teknik, mirëpo siç e dini edhe Statuti i Komunës është në përfundim dhe për këtë arsye kryetari ka marrë vendim që të gjitha konkurset të anulohen deri në përfundimin e statutit. Për këtë arsye nuk është vetëm për punëtorin teknik, por pothuajse të gjitha konkurset janë anuluar. Sa i përket mësimdhënësve, ne i kemi harmonizuar thuajse të gjitha, dhe tani nuk kemi mungesa të mësimdhënësve. Është diskutuar çështja e mësimdhënësit të gjeografisë. Është e vërtetë që në Komunën e Vitisë kemi mungesë të disa kuadrove, kemi pasur mungesë në fizikë, kimi dhe gjeografi. Jemi detyruar që për një kohë që nxënësit të mos mbesin pa orë, të angazhojmë edhe student të vitit të 3 të fizikës me kontratë njëvjeçare, deri sa të përfundohet procedura dhe pastaj është ripërsëritur konkursi për zëvendësim. Ndërsa për gjeografi nuk kemi pasur kandidatë dhe as studentë që shkojnë në atë lëmi, gjë që është shqetësuese jo vetëm për tani por edhe për të ardhmen. Për fotokopjet dua të cek seriozisht: edhe pse prioritet i ipet Drejtorisë së Arsimit nga komuna, realisht për shkak të mungesës së buxhetit dhe marrjes së mjeteve nga përmbaruesit, shumë projekte kanë mbetur në gjysmë. Edhe pse është mendu digjitalizimi i shkollave, sa i përket fotokopjeve ne kemi kontratë me AQP, mirëpo AQP nuk i ka përfshi objektet shkollore, dhe kështu kemi mundur vetëm me i furnizu me tonerë, asgjë më shumë. E nderuara Majlinda e ngriti shqetësimin për transportin e nxënësve. Sa i përket përgjegjësisë të Drejtorisë së Arsimit, ne zakonisht në korrik e shpallim konkursin dhe procesi shkon përmes procedurave të rregullta. Kemi linjat Letnicë, Stubëll dhe Podgorc, ndërsa Viti është mbi 2.5 km. Aty kemi obligim komunal, sidomos për shkollat fillore, me ua siguruar transportin. Vetëm këto dy linja i mbulojmë aktualisht, si dhe kemi një kombi për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ku shpenzimet i mbulon komuna.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i Komunës: Drejtor, mirë që ju bashkangjitët, po t'i lexoj pyetjet që kanë qenë rreth drejtorisë suaj. Ilir Zuka, ndriçimi publik është rregulluar, por janë edhe disa drita të thyera që janë në mungesë, si dhe çështja e deponisë në rrugën "Sabit Zuka" dhe ndriçimi publik tek ambulanta, brenda oborrit të ambulantës. Liridona, një prej shkaktarëve të marrjes së vendimit, ku unë kam qenë nënshkruar, nuk ka qenë kryetari, por një shkresë që e kam marrë nga ana e ministrisë, në të cilën kërkohej që, në përputhje me katalogun, të bëhej kategorizimi i vendeve të punës. Këtë e ka kërkuar njësisia e personelit dhe, derisa të bëhet kjo çështje, unë kam marrë vendim që të mos dalë asnjë konkurs. Kjo lidhet pikërisht edhe me rregullimin e punëtorëve të gjendjes civile në Komunën e Vitisë. Kemi pasur gatishmëri, por aspekti procedural na ka penguar. Tash, së shpejti, do ta bëjmë miratimin e statutit; komisioni e ka në përfundim, dhe rregullorja lidhur me sistematizimin e vendeve të punës do të bëhet, bashkë me kategorizimin, dhe do të rregullohen të gjithë punëtorët që janë në komunë. Elsa, iniciativat që i kanë marrë, duke filluar prej Radivojevit e Skifterajt, kemi bërë përpjekje me qenë prezentë së paku në infrastrukturë, edhe pse nuk i kemi pasur të parapara, sepse janë projekte që kanë lindur më vonë. Unë besoj se, sikur projektet tjera që i kemi përkrahur, kemi me i përkrahur edhe këto, por nuk kemi pasur projekt të miratuar nga ana e kuvendit. Megjithatë, do ta shikojmë mundësinë e përkrahjes së tyre. Majlinda, te transporti publik, shumica e kompanive që operojnë tash janë kompani private dhe ne nuk kemi transport që menaxhohet nga komuna. Ata i përcaktojnë vijat në bazë të asaj që ua lejon ministria dhe në bazë të kërkesës që e dërgon inspektori i komunikacionit në Komunën e Vitisë. Prandaj, aty ku e shohin leverdinë shkojnë, e aty ku nuk e shohin nuk shkojnë. Unë e di që ka udhëtarë pak, për shkak se është normale ajo çështje. Një tjetër çështje, drejtor, është fillimi i mirëmbajtjes së rrugëve verore, për disa gropa në rrugën e Pozharanit, por edhe në të gjitha rrugët tjera ku ka nevojë me u ndërhy. Gjithashtu, lidhur me pyetjen e Rezmikut, është kërkuar të dihet nëse ka ndonjë plan për eliminimin e deponive ilegale. Nuhi, me inspektorin e komunikacionit do ta shikojmë këtë çështje. Ne kemi edhe një tender ku jemi duke i vendosur shenjat e komunikacionit, dhe do ta kemi parasysh edhe rrugën atje në Verbanc, që e kërkohej. Lul, të paskam mbetur borgj, por në seancën tjetër, ishalla, nuk harroj me t'i sjellë kartelat dhe faturat se sa kemi paguar deri tani. Hajdin, për lagjen Shabiu dhe asfaltimin e rrugës, unë besoj se të gjitha ato që kanë qenë të programuara, por edhe të premtuara, siç ju thashë edhe te pasqyrat financiare, është vështirë me i realizu, qysh po i shoh trendet e obligimeve që i kemi dhe që po na lindin pothuajse çdo ditë. Për atë arsye nuk guxoj me thanë që ka me u shtrë këtë vit. Ekremi për çështjen e

banimit social, është mirë me caktu një vend. Për mua, deri tash, forma e banimit social që kemi pasur nuk ka bërë zgjidhje; jo që nuk ka bërë zgjidhje, por na ka shkaktuar edhe telashe tjera. Megjithatë, unë nuk jam kundër që, nëse është e nevojshme, të caktohet një lokacion dhe të ndërtohet edhe një objekt tjetër. Dhe një tjetër pyetje, drejtor: çka është ndërmarrë për zgjidhjen e problemit të kanalizimit në Remnik? Unë jam marrë shumë me këtë çështje. Me të thanë të drejtën, Remzi, më kanë rrejtë, e më vjen shumë rëndë me thanë a më ka mashtruar kompania, sepse kam insistuar që, kur ka qenë sezona dhe fusha ka qenë e liruar, të punohet aty. Me siguri i kam 20-30 thirrje me kompaninë që e ka pasur obligim me kry punën. Besoj që kompania që është për mirëmbajtje nuk mundet me e bërë zgjidhjen përfundimtare. Ti e din që kanë qenë shumë herë aty dhe, sipas të gjitha gjasave, një pjesë duhet me u bë ndërrim. Këtë e kemi futur edhe në projekt, por për shkak se erdhi vjeshta, nuk u realizua. Tash të shohim; unë besoj që kjo çështje, edhe nëse e kemi në projekt, nuk mundet me u kry derisa kulturat që janë mbjellë aty të mos hiqen. Elham, me të plotësu rreth certifikatave, se kam qenë në rrjedhë: është një realitet që ju e keni një sindikatë shumë aktive. Kanë qenë dhe kemi pasur mospajtime. Njëherë i kam pritun unë, e më vonë ka ardhur edhe kryetari. Kanë kërkuar një herë lirim të plotë të pagesës dhe unë ju kam thënë që është e pamundur, për shkak se caktimi i tarifës për certifikatat mjekësore është në harmoni me udhëzimin e Ministrisë së Shëndetësisë, i cili është aprovuar edhe në kuvend komunal. Sikur të ishte krejt nga ana e kuvendit komunal, ndoshta kishte mujtë me u bë një zbritje me një vendim të kuvendit komunal. Por, kur e merr prej udhëzimit administrativ dhe inkorporohet nga niveli qendror, nuk guxon me ndërhy fare. Ata kanë kërkuar që pagesën me ua bërë komuna, por unë kam thënë që kjo nuk bën, për shkak se pastaj bëhet laramani, sepse edhe punëtorët e gjendjes civile dhe shërbyesit publikë i kanë nxjerrë vetë certifikatat mjekësore. E di që kanë hasur në mirëkuptim me një kompani të licencuar, që ka të drejtë me lëshu certifikata dhe që ato janë valide, dhe ajo kompani ka bërë një zbritje për shkak të numrit të madh të punëtorëve.

z.Elham Emërllahu: Drejtoreshë, faleminderit. Nuk e pata veç për Gërmovën, por aty jam punëtor i asaj shkolle dhe e di më në detaje, prandaj edhe fola me përgjegjësi. Harrova me përmend sigurinë në shkollë, sidomos në fshatrat që frekuentojnë rrugët nacionale, të cilat nganjëherë janë me rrezikshmëri të lartë për nxënësit. Duhet me pasë ndoshta pak më shumë mbikëqyrje, si prej drejtorive të shkollave, ashtu edhe prej DKA-së dhe organeve të tjera. Siguria e nxënësve në shkollë dhe e mësimit është shumë e rëndësishme. Ne kemi pasë në Komunën e Vitisë, vitin e kaluar nëse nuk gabo, raste kur edhe mësimit janë sulmuar prej prindërve. Kur e përmenda strategjinë, që paska skaduar dhe në vitin 2026 bëhet e reja, shpresoj që krejt këto që unë po i them, por edhe ekspertë të tjerë që mundemi me i angazhu, pse jo, me i ofru në atë strategji. Janë disa detaje që duken të vogla, por kanë shumë rëndësi. Nuk kemi më nevojë në Komunën e Vitisë, mesa unë e kam parë, me ndërtu shkollë të reja, por me investu më shumë në shkollat ekzistuese, sepse jashtë janë rregullu mirë, por brenda është tepër më me rëndësi. Është edhe një detaj i vogël, por tepër shqetësues, që ka rezultu se në Komunën e Vitisë mbi 90% e shkollave nuk kanë ujë të pijshëm. Domethënë, ne nuk kemi qenë në gjendje me siguri ujë të pijshëm, që në fakt kërkon vetëm disa pajisje.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Përderisa i kanë nxjerrë certifikatat mjekësore 800 mësimit, sa kanë dalë prej tyre që nuk janë në gjendje me dhanë mësim? A ka të tillë? Se kjo çështje është e rëndësishme.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: Shumicën e shkollave i kemi të siguruar me kamera, mirëpo për shkak të mungesës së buxhetit, në disa shkollë ka ngecje dhe një pjesë e kamerave nuk funksionojnë. Sa i përket ujit, në ato vende ku kemi ujësjellës, uji pihet dhe është i siguruar. Por në ato fshatra ku furnizohen me puse, drejtorët mund të marrin në bamatoret bujqësore klor-kapsula për pastrimin e ujit.

z.Elham Emërllahu: Drejtoreshë, unë jam i vetëdijshëm që nuk janë krejt përgjegjësitë tuaja dhe të komunës. E di edhe si po funksionon niveli qendror, Ministria e Arsimit. Ndoshta ajo duhet me qenë një sinkron i funksionimit për këto detaje që po i përmend prej Ministrisë së Arsimit e tutje, por po e shohim që atje nuk po funksionon si duhet dhe po shkaktohen probleme edhe në komunë.

Megjithatë, ne si komunë, si komunë më e vogël dhe me numrin në rënie të nxënësve, kemi mundësi që në të ardhmen, në kuadër të asaj strategjie, me i parapa këto mangësi dhe me i evitu.

zn.Arta Ajeti, drejtoreshë: z.Elham, me të thanë të drejtën, që një vit Ministria e Arsimit nuk na ka ftu në asnjë takim. Kemi dërgu shumë kërkesa atje, por nuk kemi marrë përgjigje. Sa i përket çështjes së vizitave në shkolla, nuk jam fort e Facebook-ut, mirëpo gjithmonë jam në terren.

z.Arton Musliu, drejtor: Drejtorja që unë drejtoj, për shkak të natyrës së punës, është vazhdimisht në terren. Punëtorët e pastrimit, mirëmbajtjes, operatorët ekonomikë që janë të ndërlidhur me mirëmbajtjen e rrugëve, hapësirave publike etj., janë çdo ditë në terren dhe bëjnë një punë të mirë. Shfrytëzoj rastin me i falënderu për punën e tyre, në shkëmbim të një page jo shumë të favorshme për ta. Sa i përket ndriçimit publik, ne tash e kemi kontratën për mirëmbajtje dhe punëtorët janë në terren. Numri i rasteve është i madh dhe duhet kohë derisa t'ju vijë radha të gjithëve. Për deponitë ilegale, prej se ka fillu punën ky ekzekutiv si drejtori e komunës, i kemi largu disa deponi në Radivoje, Pozheran, Viti, Sodovinë e Jerlive, Beguncë. Është e vërtetë që nuk kemi arritë me i largu të gjitha, sepse ka shumë, dhe kostoja nuk është e vogël. Kemi edhe një skajp në komunë që shpesh ka probleme teknike, por punët nuk i kemi ndalë. Gjithashtu, punëtorët e drejtorisë sonë vazhdimisht janë në terren për intervenime rreth kanalizimit dhe ujësjellësit. Kemi intervenu në Skifteraj, Radivoje etj., kryesisht në largimin e mbeturinave prej përrockave, prej të cilave ka pasur dhe ka rrezik dëmtimi të pronave të mbjella. Në Beguncë kemi intervenu tri herë, e në fshatra të tjera po ashtu, mirëpo kërkesat janë të mëdha dhe ato që i paraqitni janë të arsyeshme. Në Dobëlldeh ne i kemi premtu Demirit dhe banorëve të atij lokaliteti se kemi me e plotësu me zhavorr pjesën ku janë të vendosura shkronjat për UÇK, dhe kjo është veç çështje kohe. Sa i përket kanalizimit në Remnik, unë deri tani nuk kam pas asnjë kërkesë, qoftë zyrtare apo jozyrtare për me intervenu. Përndryshe, ne si drejtori e shërbimeve publike dhe si komunë jemi në dispozicion për me i kry këto punë që i kemi obligim me i realizu.

z.Remzi salihu: Pak një skjarim me ma dhënë the që nuk e ke pas si kerkes por megjithatë si drejtor je pergjejes për të gjitha këto prandaj kërkesa është që 3 vite së paku 4 herë e kam ngritë unë por ndoshta në realitet dhe 8 herë, kerksene ke atje edhe nga banoret e asaj lagje dhe kerksat e mia në kuvend dhe duhet ta shikoni se kur mund ta sajoni këtë gjendje.

z.Arton Musliu, drejtor: i nderuara, ana e paraqitjes së kërkesës është në rregull, nuk ka rëndësi si paraqitet. Unë, për shkak të korrektësisë, desha me tregu që nuk kam qenë në dijeni. Ti e din që kjo çështje nuk është kompetencë e komunës, por e Hidromoravës, që është kompani publike nën menaxhimin e Ministrisë së Ekonomisë, dmth adresimin duhet me bë aty. Mirëpo ne si komunë nuk është që nuk duam me marrë përgjegjësi, por duhet me i adresu krejt çështjet që janë nevoja të qytetarëve.

z.Hasan Aliu nënkryetar i komunës: Drejtor e kanë bërë, ne kemi pasë një kompani për mirëmbajtje të kanalizimeve, kanë dalë në vend të ngjarjes, nuk kanë mujtë me kry punën, ka dalë edhe Hidromorava, nuk ka mujtë me kry punë, dhe tash e tutje aty duhet me prek atë çështje me sanu me kanal të ri, sepse nuk kanë mujtë me e qelë.

z.Arton Musliu, drejtor: I nderuar, unë po e marrë për obligim këtë çështje me e adresu, e takoj edhe Hidromoravën edhe kompaninë që është e kontraktume prej komunës për me u marrë me çështjen e kanalizimeve, andaj nëse është e mundshme kemi me e zgjidhë, unë po e marrë obligim publik për ta.

z.Remzi salihu: Me Hidromoravën ndoshta ka mundësi vetëm me debat, se unë nuk e di që kanalizimi në fshatin Remnik është nën sistemin e Hidromoravës.

z.Illir Zuka: Drejtor, para disa javëve ta kam bërë me inxhinierin, e din saktë vendin ku është. Nuk e di se ku ke intervenu, diku tjetër në Pozheran. Dua ta di vendin se ku është hjek ajo deponi dhe uroj që rrugën "Sabit Zuka" ta pastroni.

znj.Majlinda Shabani: Po ndërlidhem me përgjigjen që i dhanë rreth pyetjeve të mia. Sipas asaj që kuptova për hartat zonale, jemi në fillim, është akoma faza e dytë, dhe nuk po arrij me kuptu cila është arsyeja që është vonu kaq shumë. Po më duket shumë e paarsyeshme fakti që është zgjatë kaq shumë. Nuk është puna veç te ministria, nuk dua me hy në debate, sepse e dini që pikërisht në planin zhvillimor komunal dhe me hartat zonale, ajo çka është bë prej anës së komunës, mundem me thanë që është eksperimentu me njerëz të cilëve u kemi dhanë me punu atë plan, dhe është dashtë me u kthy e me fillu prej zeros. Kështu që po e shoh që është në fillim dhe nuk besoj që është e mirë për komunën, megjithatë po shpresoj që ka me përfundu sa më shpejt dhe siç duhet. Te transporti publik, e mora përgjigjen prej nënkryetarit, e kuptoj mënyrën se si funksionon transporti

privat, ku i konvenon me shku. Por unë e di që veç pak vullnet me pas prej anës së komunës, ky mundet me u rregullu përmes formave të subvencionimit. Është mirë me fillu me mendu këtë çështje, ka komuna që e kanë bërë, si p.sh. Obiliqi. Unë e kuptoj që rrethanat janë të ndryshme prej komune në komunë, por mundemi me rregullu. Te deponitë ilegale mora përgjigjen prej anës së drejtorit. E kemi pa edhe përmes mënyrës së punës që është duke e bërë drejtorja, që ka fillu një kampanjë si fushatë për mjedis të pastër dhe ambient. Por ajo që po e shoh unë, drejtor, nuk mjafton vetëm kjo. E di që duhet ndërgjegjësimit qytetar për çështjen e mbeturinave, por te deponitë ilegale zakonisht çka bëhet prej anës së ekzekutivit është me shku e me pastru atë vend. Ndoshta nuk kalojnë 2-3 muaj dhe ai vend prap shndërrohet në deponi ilegale, dhe ky është problemi kryesor. Duhet me kriju mekanizma të qëndrueshëm që nuk përsëriten. Unë nuk e di a është shqiptu ndonjë gjobë për deponitë ilegale, sepse nëse nuk shqiptojmë gjoba, nëse nuk vendosen mënyra të vëzhgimit me kamera, përndryshe kjo ka me qenë problem që veç ka me shku tu u zgjatë. Me pastro sot, pas 2-3 muajve prap, nëse nuk ka gjoba nuk ka me pas ndërgjegjësimit qytetar. Besoj që kjo është njëra ndër mënyrat që duhet me fillu. Nuk e mora përgjigjen rreth një deponie ilegale që ju kam kontakti për fshatin Lubisht, nuk e di a keni pas raste me shku, sepse është rrugë që nxënësit e frekuentojnë çdo ditë dhe është rruga "Qëndresa" që shkon te xhamia. Dua me ditë çka po implementohet në këtë rast për shtëpitë që nuk janë në sistem të mbeturinave, çka ndërmerr komuna.

zn.Liridona Bislimi: i nderuar nënkryetar, unë me qëllim pata vetëm një pikë diskutimi, për shkak se mendova që ka nevojë kjo çështje me u diskutu më shumë, për shkak se është problematikë shumë e thellë. Jemi tu folë për 16 muaj që kanë mbetë njerëzit me atë pagë të mjerë. Përmende që keni pasë shkresë prej ministrisë, dmth paska pasë njëfarë procedure. Unë po them që ligji është i qartë. Deshta me ditë a je interesu për këto 16 muaj me kqyr mos ka ndonjë komunë tjetër të njëjtin problem e ndoshta e ka zgjidh sa kohë i ka marrë, se tash të njëjtën temë që po e ngriti brenda 1 viti kalendarik po marr përgjigjen e njëjtë.

z.Hasan Aliu nënkryetar i Komunës: Jam interesu jo për këto 16 muaj, por nja 20 takime kemi pas me ta, që ka qenë edhe shefi i tyre. Kam qenë te gjendja civile, kam mbajtur takim me ta, kam thirr edhe komisionin që është tu hartu rregulloren, dhe jemi dakordu që tash bëhet miratimi i statutit, rregullohet, bëhet klasifikimi i vendeve të punës dhe rregullohet kjo çështje.

zn.Liridona Bislimi: unë mesa kam ndëgju fillimisht ka qenë diskutimi për 3 muaj me u kry kjo punë, tash ka kalu në 16 muajsh dhe po të duket ty që nuk është punë e madhe. Ndoshta është në rregull për shkak se paga e jonë hec dhe kalon, është krejt në rregull. Ndoshta mendon që bëhet rikthimi i mjeteve përmes proceseve të gjykatës, ajo është krejt tjetër temë që e përmendi kolegu Ilir. Ne po flasim për çështjen konkrete, njerëzit janë të lodhur.

z.Hasan Aliu nënkryetar i Komunës: Shkresë ju ka çu Burimeve Njerëzore që ka thënë bëje kategorizimin e vendeve të punës dhe unë kur e kam parë aty i kam ndalë dhe konkurset i kam qitë kusht, kam thënë urdhno bëji krejt këto detyra. Tash për kohë sakt nuk e di, se nuk ka datë, por janë në procedura.

z.Arton Musliu, drejtori: Ilir, ti në katun tënd nuk po e din ku janë heq mbeturinat, e qysh me ditë unë. Deponia ku është heq është te ura afër burimit të ujësjellësit, që 9 vite hiqet ajo deponi për çdo vit. Këtë vit është heq me 9 mars, problemi është që tash po mbushen prap. Për dallim prej disa fshatrave tjerë, unë i kam disa të dhëna zyrtare këtu: sa familje nëpër secilin fshat janë të regjistruara në Ekohigjien për me hudh mbeturinat në vend të autorizum. Pozherani është mirë, janë 755 shtëpi rezidente, 612 prej tyre janë të regjistruara, që i bie 81% (pa shtëpitë e mërgatës). Janë të dhëna zyrtare që i kam marrë prej Ekohigjienës dhe i kam krahasu me Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Majlinda, unë pajtohem me mënyrën si po e shtron ti çështjen, por sa i përket aspektit ligjor, në bazë të Ligjit për Mjedisin dhe Ligjit për Mbeturina, secili qytetar nuk ka të drejtë me qitë mbeturina në vende të paautorizuara. Me ligj është e rregullume. Problemi është te implementimi i legjislacionit, këtu jemi tu çalu. Shumë mirë e përmende: ne kemi inspektoratin dhe kemi policinë që kanë mandat ligjor me i gjobit ata që hudhin mbeturina në vende të paautorizuara, por më duket që ma përpara duhet me gjobit policinë dhe inspektorin që i kemi, sesa qytetarët, për shkak se unë nuk jam i kënaqur as me inspektorin e mjedisit, as me policinë në raport me numrin e gjobave që duhet me i shqiptu. Përndryshe, ju kisha lutë krejtve si këshilltarë komunalë, që jeni edhe administratorë të fshatrave, p.sh. në Lubisht janë 204 shtëpi, veç 83 janë të regjistruara në Ekohigjienë, që i bie veç 40%. Ose p.sh. në Viti janë 1344 shtëpi, 685 kontenierë, që i bie rreth 50%. Pa e rregullu këtë raport mes numrit të shtëpive dhe numrit të kontenierëve, na

e kemi problem me siguru ambient të pastër dhe të sigurt, në atë objektiv për të cilin jemi nisë. Nuk është që tash është keq, por objektivin e kemi me e bë ma mirë. E nëse kishit mujtë me na ndihmu ju si përfaqësues të qytetarëve, pikë së pari që jeni, por edhe përfaqësues të fshatrave prej nga jeni, me rritë numrin e atyre që regjistrohen për me marrë kontenier, atëherë na kishit ndihmu shumë. Në Verban, për shembull, veç javën e kaluar janë regjistru 70 klientë të rinj në Ekohigjienë. Nuk po them që është veç meritë e jemja, kanë punu qytetarët, ka punu Nuhia me banorët dhe kemi arritë efekt. Nëse kishit mujtë me na ndihmu këtu, na si ekzekutiv ju kishim ditë për nder.

z.Ekrem Abazi: Edhe një kërkesë më shumë për juve që Viti për çdo ditë te ura këtu është bërë pengesë shumë e madhe me dalë nga ana e lumit te kalldermi. Kur të kalojsh me kerr aty me pak harxhime bëhet një punë e madhe, aty është veç mos-puna e juaj, se aty ish kry moti.

z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit: Pasi që nuk kemi të tjerë për diskutim, faleminderit nga të gjithë për kontributin e dhënë në këtë seancë. Mirupafshim në seancën e radhës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:30 min

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi

Pika 2



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

| | | | |
|---------------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|
| Data e dorëzimit të: 12-05-2026 | | | |
| Nr. i dorëzimit të: 01 | Nr. i dorëzimit të: 052 | Nr. i dorëzimit të: 102 | Nr. i dorëzimit të: 502 |



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

| | |
|---------------------------------------|---|
| DATE/A | 12.05.2026 |
| PËR (ZA) TO | z. Sokol Haliti - Kryetar i Komunës së Vitisë z. Bekim Azizi - Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë |
| CC: | Anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa Anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë |
| PËRMES(PREKO)THROUC NGA (OD) FROM | Drejt përdrejtë Fatlum Demiri Kryesues <i>Fatlum Demiri</i> Arian Alidema <i>Arian Alidema</i> Astrit Shabiu <i>Astrit Shabiu</i> Yllka Qamili <i>Yllka Qamili</i> Ardita Hajdari <i>Ardita Hajdari</i> Majlinda Shabani <i>Majlinda Shabani</i> Albulena Selmani <i>Albulena Selmani</i> Anëtarët e komisionit për ndryshim plotësim të statutit të komunës së Vitisë... |
| TEMA (SUBJEKAT) SUBJECT | Raport nga komisioni për përgatitjen e draftdokumentit për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011. |

Bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal të Vitisë, Nr. 01-110/05-156, të datës 02.02.2026, për miratimin e iniciativës së Kryetarit të Komunës së Vitisë për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, si dhe në Vendimin e Kuvendit Komunal të Vitisë, Nr. 01-110/05-155, të datës 02.02.2026, për themelimin e Komisionit për përgatitjen e ndryshim-plotësimit të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011,

Komisioni, përmes kësaj shkrese, njofton Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit Komunal se draftdokumenti për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë është finalizuar në tërësi, ka kaluar edhe fazën e konsultimeve publike dhe i njëjti mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën e radhës të Kuvendit Komunal të Vitisë.

Bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni: Draftdokumentin për ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë, me nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

DRAFTDOKUMENTI

Për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011

Maj 2026

Draftdokumenti

Për ndryshim-plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011

Neni 1

Neni 6, paragrafi 6.1 të statutit bazë, shkronja b dhe d ndryshohet dhe duhet të jetë me këtë përmbajtje:

b – 5 Maji Dita e Dëshmorve fest zyrtare e Komunes së Vitisë, ditë në të cilën shënohet dhe përkujtohet nga qytetarët e Komunës së Vitisë, por punohet në organet Komunale.

d- 5 Shkurti, dita e shkollës së parë shqipe në Kosovë (Në Pozharan dhe Stubëllë të Epërme). Festë publike në të cilën festohet nga qytetarët e komunës së Vitisë, por punohet në organet Komunale.

Neni 2

Neni 6, paragrafi 6.1 të statutit bazë l shtohet edhe shkronja f me këtë përmbajtje:

f- 25 Shkurt 1999 është dita e themelimit të "Brigades 173 Gursel e Bajram Sylejmani", ditë e cila shënohet nga qytetarët e Komunës së Vitisë, por punohet në organet Komunale.

Neni 3

Neni 10, paragrafi 10.2 të statutit bazë, shkronja f, ndryshohet dhe duhet të jetë me këtë përmbajtje:
f – Ka cilësinë e punëdhënësit, punëson kategoritë e zyrtarëve publik dhe të emëruarit politik në përputhje me Ligjin për Vetqeverisje Lokale

Neni 4

Neni 13, paragrafi 13.3 të statutit bazë, riformulohet si në vijim:

13.3 Kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillave lokalë nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.

Neni 5

Neni 28, paragrafët 28.2 dhe 28.3 të statutit bazë, riformulohen si në vijim:

28.2 Mbledhja inauguroese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e çertifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 28, paragrafi 28.3 të statutit bazë riformulohet si në vijim:

28.3 Nëse kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafit 28.2 të këtij neni, mbledhja inauguroese thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur ta thërrasë mbledhjen inauguroese të Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Neni 30, të statutit bazë, te paragrafi 30.3 ndryshohet dhe i shtohet shkronja d:

d – seanca urgjente.

Neni 7

Neni 31, të statutit bazë, paragrafi 31.1 riformulohet dhe duhet të ketë këtë përmbajtje:

31.1 Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal thirret për çështje me rëndësi për qytetarët e Komunës së Vitisë.

Neni 8

Neni 31, të statutit bazë, paragrafi 31.2 riformulohet dhe duhet të ketë këtë përmbajtje:
31.2 Seancën e jashtëzakonshme e thërret kryesuesi i Kuvendit të Komunës pas kërkesës me shkrim nga kryetari i Komunës apo 1/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 9

Neni 32, të statutit bazë ndryshohet dhe i shtohet neni 32.a:
32.a pika 1 Seanca urgjente thirret në raste të fatkeqësive natyrore (Vis Maioris) dhe rrethanave të tjera urgjente në komunë; kryesuesi i Kuvendit dhe kryetari i komunës kanë të drejtë të thërrasin mbledhje urgjente.
32.a pika 2 Procedurat për thirrjen e mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastet e thirrjeve të mbledhjeve të tjera.

Neni 10

Neni 46 i statutit bazë, paragrafi 46.1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
46.1 Kuvendi i Komunës së Vitisë, për çështje të caktuara nga fusha e përgjegjësive dhe kompetencave të tij dhe sipas propozimit të kryetarit të komunës, themelon komitete konsultative. Anëtarët e komiteteve konsultative përbëhen nga qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, të cilët duhet të jenë njohës të fushave përkatëse. Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të jenë anëtarë të komiteteve konsultative. Mandati i anëtarëve të komiteteve konsultative është katër (4) vjeçar, nga themelimi i komitetit.

Neni 11

Neni 47, paragrafi 47.2, shkronjat e dhe h të statutit bazë ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:
e) Komiteti për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
h) Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Neni 12

Neni 50, paragrafi 50.1, shkronjat h dhe s ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:
h – Vendos për formimin dhe strukturimin e administratës komunale në përputhje me statutin në fuqi dhe rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
s – I propozon Kuvendit të Komunës miratimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 13

Neni 50, paragrafi 50.1, ndryshohet dhe i shtohet shkronja v) me këtë përmbajtje:
v – Themelon Komitetin për Auditim, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 14

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazë, nënparagrafët 2, 4, 9 ndryshohen dhe i njëjti ka këtë përmbajtje:

2.a Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe

b Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazë, nënparagrafi 4 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:

4.a Drejtoria për Shërbime Publike dhe

b Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazë, nënparagrafi 9 riformulohet dhe ka këtë përmbajtje:

9 Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Neni 15

Neni 56, paragrafi 56.4 të statutit bazë riformulohet dhe duhet të ketë këtë përmbajtje:
56.4 Organizimi i drejtorive komunale dhe strukturimi i brendshëm i tyre rregullohet në bazë të rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Vitisë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës, e cila rregullore përcakton kushtet dhe standardet në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 16

Neni 58 të statutit bazë fshihet.

Neni 17

Neni 62, paragrafi 62.1 të statutit bazë, togfjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim", riformulohet: "Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa".

Neni 18

Neni 64, paragrafi 64.1 të statutit bazë, togfjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim" riformulohet: "Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa".

Neni 19

Neni 65, paragrafi 65.1 të statutit bazë: togfjalëshi "Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149", i paraparë në të gjitha nenet e statutit bazë, ndryshohet dhe bëhet: "Ligji për Zyrtarët Publikë", në fuqi.

Neni 20

Neni 66, paragrafi 66.1, shkronja f të statutit bazë ndryshohet dhe i njëjti ka këtë përmbajtje:
f Kategoritë e zyrtarëve publikë sipas nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafët 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit për Zyrtarët Publikë në fuqi.

Neni 21

Neni 68, paragrafi 68.1 të statutit bazë ndryshohet dhe i njëjti ka këtë përmbajtje:
68.1 Me qëllim të planifikimit, administrimit dhe punësimit të zyrtarëve publikë, në përputhje me nenin 14 të Ligjit për Zyrtarët Publikë në fuqi, Komuna e Vitisë themelon Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

Neni 22

Neni 69, paragrafi 69.1 dhe në nenet tjera të statutit bazë ku ceket: "Njësia e personelit dhe Udhëheqësi i personelit", ndryshohet me këtë përmbajtje: "Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Udhëheqësi i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore".

Neni 23

Neni 73, paragrafët 73.1 dhe 73.2 të statutit bazë ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:
73.1 Në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësisive në komunë, Zyra e Kryetarit të Komunës organizohet në këto njësi dhe sektorë:

- 1 Kabineti i kryetarit
- 2 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- 3 Njësia për Prokurim
- 4 Njësia për Auditim të Brendshëm

- 5 Sektori Ligjor dhe Përfaqësimi (Avokati Komunal)
- 6 Sektori për Punë i Kuvendit Komunal
- 7 Sektori për Menaxhimin e Kontratave, Zhvillimin e Projekteve dhe Infrastrukturë
- 8 Sektori për Komunitete, Kthim dhe Riatdhesim
- 9 Sektori për Raportim, Informim dhe Bashkëpunim
- 10 Sektori për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Integrim Evropian
- 11 Certifikuesi i Buxhetit

73.2 Fushëveprimi, detyrat dhe përgjegjësitë e njësive apo sektorëve të cekura më lart caktohen me legjislacionin në fuqi si dhe me rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

73.3 Njësitë dhe sektorët e cekura më lart për punën e tyre i përgjigjen drejtpërdrejt kryetarit të komunës.

Neni 24

Nenet 74 dhe 75 të statutit bazë fshihen.

Neni 25

Pas miratimit për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë, pushojnë së vlejuri dhe shfuqizohen dispozitat e ndryshuara dhe të plotësuara të Statutit Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.

Neni 26

Ndryshimet dhe plotësimet në statut hyjnë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr.08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), nenin 5, paragrafi 1, si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, paragrafi 1, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare, në web faqe të Komunës së Vitisë.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal Vitina

STATUTI

I

KOMUNËS SË VITISË

01-013/491
21.04.2011

Në bazë të dispozitave të nenit 12.par.2 shkronja .a.të ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe mbështetur në nenin 22.par.2.të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.02-013/5165, të datës 18.11.2008, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbeldhjen e mbajtur me 20.04.2011 miratoi këtë :

STATUT

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

QËLLIMI

1.1. **STATUTI**- është akt më i lartë normativo-juridik dhe nënligjor, që miratohet nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, në përputhje me ligjet pozitive të Republikës së Kosovës.

1.2. Me këtë akt normativ rregullohen, organizimi, funksionimi, kompetencat, përgjegjësitë dhe struktura e organeve të Komunës së Vitisë .

1.3. Ky Statut ka shtrirje dhe jurisdiksion të plotë hapsinor dhe fuqi juridike në të gjithë territorin e Komunës së Vitisë të përcaktuar me ligj.

1.4. Komuna e Vitisë është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, në Republikën e Kosovës, në të cilin organizohet dhe ushtrohet pushteti i dalur nga zgjedhjet e lira dhe demokratike me legjitimitet dhe legalitet të plotë dhe në mbështetje të ligjeve pozitive, ku të gjithë qytetarët e Kumunës së Vitisë pa kurrfar diskriminimi gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet Komunale të të gjitha niveleve .

- 1.5.** Komuna e Vitisë me këtë Statut në kuadër të ushtrimit të kompetencave, përgjegjësive dhe autorizimeve të saj, dhe duke u mbështetur në ligjet pozitive në fuqi rregullon:
- 1.5.1.** Organizimin dhe kompetencat e organeve të zgjedhura të Komunës së Vitisë.
- 1.5.2.** Stemen, Vulën, Emblemen, dhe Flamurin Komunal (simbolet e Komunës);
- 1.5.3.** Posedimin dhe menagjimin e pronës së lujtshme dhe të palujtshme Komunale
- 1.5.4.** Përdorimin e gjuhëve në përputhje me ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve dhe me rregulloren e Kuvendit Komunal të Vitisë.
- 1.5.5.** Mënyra e organizimit dhe të pjesmarrjes së drejtpërdrejt të qytetarëve, shoqatave e grupeve të interesit dhe në përgjithësi të shoqërisë civile në aktivitetet vendimmarrëse për çështjet me interes publik për komunën.
- 1.5.6.** Tubimet publike periodike me qytetarët.
- 1.5.7.** Marrdhënjet ndërKomunale dhe ndërkombtare të Komunës së Vitisë në mbështje me ligjet dhe politikat e digasterit përkatës ministror.
- 1.5.8.** Bashkpunimi me ndërmarrjet publike dhe private, dhe nxitjes së këtij bashkpunimi në interes të zhvillimit ekonomik të Komunës.
- 1.5.9.** Vendosjen e bashkëpunimit dhe krijimin e hapësirës së nevojshme dhe lehtësirave të mundshme për investimet e huaja në komunë në suaza të ligjeve pozitive dhe hapsirave ligjore në këto fusha.
- 1.5.10.** Planifikimi me qëllim të ruajtjes së ambientit
- 1.5.11.** Kultivimin e vlerave kulturore dhe historike të qytetarëve të Komunës së Vitisë.
- 1.5.12.** Mënyrën e shfrytëzimit të resurseve natyrore të Komunës së Vitisë.
- 1.5.13.** Nxitjen e Zhvillimit ekonomik
- 1.5.14.** Çështjet e tjera me rëndësi dhe me interes për komunën.
- 1.6.** Komuna ushtron mbrenda kufijve të saj të gjitha përgjegjësitë që nuk janë të rezervuara shprehimisht, me ligjet pozitive në fuqi për organet e Qeverisjes Qendrore.

Neni 2

- 2.1.** Komuna e Vitisë, nxitë dhe krijon kushte për zhvillimin ekonomik dhe të gjithmbarshëm shoqëror për qytetarët e saj duke u mbështetur në të drejtat dhe liritë universale të njeriut, dhe duke u frymëzuar nga vlerat e Kartës Europiane për

4

Vetqeverisjen Lokale (Ksh. Evr.-15 tetor 1985).

Neni 3

3.1. Territori dhe kufijt administrativ të Komunës së Vitisë janë përcaktuar dhe precizuar me ligjin për kufijt administrativ të Komunave, (Nr. 03/L-041, neni 6. Shtojca 1) dhe Ligjit për Katastër (Nr 2003/25).

3.2. Mosmarrëveshjet e Komunës së Vitisë lidhur me Komunitat fqinje të sajë lidhur me kufijt administrativ të Komunës, do të zgjidhën nga Qeveria e Republikës së Kosovës, duke respektuar dhe vullnetin e qytetarëve të vendbanimeve, të cilat preken me kontestin e kufijve administrativ të komunave, kurse vendimin përfundimtarë për këtë qështje e nxjerrë Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Neni 4

Selia e Komunës së Vitisë gjendet në qytetin e Vitisë në rrugën 28 Nëntori, në Viti

Neni 5

SIMBOLET E KOMUNËS SË VITISË

5.1. Komuna e Vitisë si njësi e vetqeverisjes lokale në Rep. Kos. ka simbolet e saja dalluese dhe zyrtare si: Stemen, Vulen, Emblemën, dhe Flamurin komunal.

5.2. Stema e komunës së Vitisë përcaktohet me vendim të veçantë të kuvendit të Komunës së Vitisë.

5.3. Komuna e Vitisë ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokolit - vulat zyrtare të Komunës:

a- Vula e rrumbullakët e Komunës së Vitisë përmban:

- në rrethin e parë identifikimin shtetëror-Republika e Kosovës
- në rrethin e dytë identifikimin komunal-Komuna e Vitisë
- në rrethin e tretë identifikimi i organit-Drejtoria, njësia,
- në mes emblema e Komunës së Vitisë

b- Vula e protokolit e Komunës së Vitisë ka formën e katërkëndëshit këndrejt me tekst:

- Lartë-Republika e Kosovës
- Komuna e Vitisë
- Nr.--, data.

5.4. Simbolet e Komunës së Vitisë nga par.5.1. të këtij neni miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës së Vitisë me votën e 2/3 e Kuorumit të nevojshëm të kualifikuar të

antarëve të Kuvendit të Komunës.

5.5. Vulat e Komunës së Vitisë të përshkruara si në par.3. të nenit 5., tekstin e kanë të shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe.

5.6. Numrin, dimensionet, mbajtjen dhe autorizimin e përdorimit të vulave të Komunës përcaktohet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.

5.7. Emblema dhe Flamuri Komunal i Komunës së Vitisë përcaktohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës së Vitisë, mënyra e miratimit të tyre është analogjiksht si në nenin.5.par.4 të këtij Statuti.

5.8. Simbolet e Komunës së Vitisë të përshkruara me dispozitat e këtij neni miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës,pas konsultimit publik gjithpërfshirës dhe në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

5.9. Simbolet e Komunës së Vitisë nga par. 1. të këtij neni mund të përdoren ekskluzivisht nga organet komunale të Komunës së Vitisë.

Neni 6 FESTAT E KOMUNËS SË VITISË

6.1. Komuna e Vitisë ka festat e saj zyrtare dhe publike si:

- a- **14 Qershor**, Dita e Çlirimit të Vitisë, si festë zyrtare e Komunës së Vitisë dhe e qytetarve të saj në të cilën fest nuk punohet në organet Komunale
- b- **5.Maji** Dita e Dëshmorve fest zyrtare e Komunës së Vitisë, ditë në të cilën festohet nga qytetarët e Komunës së Vitisë dhe nuk punohet në organet e Komunës së Vitisë.
- c- **26 Marsi** Flakadani I Karadakut fest publike në të cilën festohet nga qytetarët e Komunës së Vitisë por punohet në organet Komunale .
- d- **5 -Shkurti**, dita e shkollës së parë shqipe ne Kosovë, festë publike në të cilën festohet nga qytetarët e komunës së Vitisë, por punohet në organet Komunale.
- e- **2 Korriku** ,fest publike në komunën e Vitisë që shënohet me manifestime kulturore nga qytetarët e komunës së Vitise, por punohet në organet Komunale .

Neni 7

7.1. Pjestarëve të Kumunitetit pakicë iu garantohet e drejta e komunikimit të tyre në të gjitha organet Komunale dhe me të gjithë shërbyesit civil, me zyrtarët e zgjedhur dhe ata të emruarit nga zyrtarët e zgjedhur, në gjuhën e tyre.

7.2. Në mbledhje të Kuvendit të Komunës, të këshillit të drejtorëve, të Komiteteve të Kuvendit dhe në të gjitha tubimet publike, diskutimet mund të mbahen në të dy gjuhët: shqipe dhe serbe.

7.3. Të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga organet e administratës komunale, lëshohen në gjuhën e palës, kurse gjuhë e palës konsiderohet gjuha në të cilën pala iu ka drejtuar organit të administratës Komunale apo organit tjetër komunal.

7.4. Aktet e përgjithshme nënligjore si dhe aktet e tjera, publikohen në gjuhët e kumuniteteve në përputhje me dispozitat e ligjit për përdorimin e gjuhëve në Kosovë.

7.5. Qështjen e përdorimit të gjuhëve në hollësi, Komuna e Vitisë e rregullon me rregulloren e veçantë në përputhje me ligjin .

Neni 8

8.1. Kuvendi i komunës së Vitisë me propozim të Kryetarit të Komunës, të organizatave qeveritare dhe jo qeveritare, të grupeve të interesit, të shoqërisë civile dhe subjekteve politike ndanë: Mirënjohje, dhurata, shpërblime, dekorata, faliminderime dhe tituj.

8.2. Kushtet për dhënie të mirnjohjeve, dhuratave, shpërblimeve, dekoratave, faliminderimeve, dhe titujve, përcaktohen me vendim të veçantë dhe të arsyetuar të Kuvendit të Komunës, dhe të propozuesit.

8.3. Vendimet nga par.8.2 të këtij neni miratohen nga Kuvendi i Komunës me shumicën e thjeshtë të korumit të nevojshëm të antarëve të Kuvendit.

Neni 9

9.1. Në të gjitha organet dhe shërbimet publike të cilat Komuna iu ofron qytetarëve të saj, sigurohet përfaqësimi proporcional i pjestarëve të Komunitetit pakicë dhe përfaqësimi adekuat i strukturës gjinore.

9.2. Komuna e Vitisë kujdes të veçantë duke u mbështetur në parimin e humanizmit dhe solidaritetit iu kushton: personave me nevoja të veçanta, personat me aftësi të kufizuara dhe të gjitha kategorive të hendikepeve, e posaçërisht fëmijëve të pa mbrojtur dhe të pa përkujdesje.

Neni 10

STATUSI JURIDIKO - LIGJOR I KUMUNËS

10.1. Kumuna në cilësinë e subjektit të së drejtës e ka statusin e personit juridik.

10.2. Kumuna në cilësinë e subjektit të së drejtës, dhe të statusit të personit juridik, gëzon këto të drejta dhe obligime:

- a- Të drejtën të padisë dhe të paditet ;
- b- Të posedoj dhe menagjoj pasuri të lujtshme dhe të palujtshme ;
- c- Të jetë titullare e të drejtave pronore;
- d- Të jetë bashkëpronare (condominium) e ndonjë kompanie e që është në interes të Komunës, në raport me qytetarët ;
- e- Të lidhë kontrata dhe punë tjera juridike në interes të Komunës;
- f- Ka cilësinë e punëdhënsit, punëson shërbyes civil dhe të emruar politik;
- g- Të gëzoj të drejtat e autorsisë dhe të mbojtjes së e tyre (simbolet e Komunës);
- h- Të drejten të shesin dhe të japin me qira pasurinë e lujtshme dhe të palujtshme, në interes të Komunës, përveq shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të veçant .
- i- Të drejtën që të japin në shfrytëzim pronën e palujtshme të Komunës .
- j- Të drejtën që të këmbëjnë pronën e palujtshme komunale, me pronat e subjekteve tjerë të së drejtës (AKP-në)- neni 9.par.4 .L.Nr.03 /L-226, dhe neni 10.par.2.3 të të njëjtit ligj, në interes publik të komunës;
- k- Të mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së tyre të lujtshme dhe të palujtshme që e kanë në pronë, posedim dhe shfrytëzim .
- l- Të drejta dhe obligimet të përcaktuara në ligje të përgjithshme dhe të veqanta dhe në këtë Statut ;

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSIT E KOMUNËS

Neni 11

11.1. Komuna në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësive të veta, në pajtim me LVQL dhe ligjet tjera të përgjithshme dhe të veqanta ushtron kompetenca të mvetësishme (vetjake)dhe të deleguara .

KOMPETENCAT E MVETËSISHME

11.2. Kompetencat e mvetësishme (vetjake) përfshinë të gjitha autorizimet dhe kompetencat e plota dhe ekskluzive të Komunës sa i përket interesit lokal,në përputhje me standardet e përcaktuara me legjislacionin pozitiv, në fushat dhe veprimtaritë si në vijim (neni 17 LVQL):

11.2.1.zhvillimi lokal ekonomik;

11.2.2. planifikimin urban dhe Rural;

11.2.3. shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;

11.2.4. zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve per kontrollimin e ndërtimeve;

11.2.5. mbrojtjen e mjedisit në teritorin e Komunës

11.2.6. ofrimin dhe mirmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale si:

a- furnizimin me ujë, kanalizim dhe drenazhim;

b- trajtimin e ujrave të zeza;

c- menagjimin e mbeturinave;

d- rrugët lokale dhe transportin lokal (mbrenda komunal);

e- hartimin dhe zbatimin e planeve për ngrohje (nxemjet) lokale;

f- veprimet emergjente duke përfshirë shërbimet e zjarrfikëse dhe të emergjences;

g-ofrimin e arsimit publik, parashkollor, fillor,dhe të mesëm duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e instucioneve edukative, pranimin e personelit arsimor, pagesen e pagave dhe trajnimin e instruktorëve të administratës së arsimit;

i- Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;

j- ofrimin e kujdesjes shëndetësore në sistemin porsor shëndetësor në institucionet publike shëndetësore;

k- ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe shërbimet tjera të mirqenjes sociale, përkujdesjen ndaj të cenushmëve, strehimin familjar përkujdesjen femënor, për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave për përkujdesje, procedurat e punësimit të nëpunësve civil në këto qendra, pagesën e pagave dhe trajnimin e profesionistëve të mirqenjes sociale;

l- banimin publik;

m- shëndetësinë publike;

n- Licencimin e shërbimeve publike, lëshimin e lejeve për ofrimin e shërbimeve publike, duke përfshirë: argëtimin, aktivitetet kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportin lokal publik dhe taksit.

o- Emrimin-Riemrimin e rrugëve, rrugicave, shesheve dhe vendeve të tjera publike.

p- ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe të hapsirave të hapura **Sakrale publike (varrezave)**.

q- Kujdesin dhe promovimin e turizmit lokal;

r- Aktivitetet dhe veprimtarit kulturore, sportet dhe veprimtarit tjera të rinisë, licencimin e qendrave Rinore .

rr- forcimin, e ekonomisë, trajtimin e barabart të pronave, dhe

s- të gjitha qështjet tjera që nuk janë të përjashtuara shprehimisht me ligje nga kompetencat Komunale, e që nuk i janë deleguar autoritetëve tjera, .

Neni 12

KOMPETENCAT E DELEGUARA

12.1. Komuna në kuadër të kompetencave të deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës ushtron dhe zbaton përgjegjësit e deleguara në pajtim me ligjet e zbatueshme, dhe akteve tjera nënligjore të autoriteteve qendrore.

12.2. Përgjegjësit, autorizimet dhe kompetencat e deleguara nga autoritetet qendrore në përgjegjësi dhe zbatim të komunave janë:

a- Shënimet kadastrale (ZKK)

b- Regjistrimin civil

- c- Regjistrimin e votuesve
- d- Regjistrimin e biznesëve dhe licensimin e tyre
- e- Shërbimet sociale dhe distribuimin e pagesave të ndihmës (të asistencës) sociale (me përjashtim të pensioneve)
- f- mbrojtja e pyjeve që ndodhen në teritorin e Komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoritetet qendrore (M.B.P.ZH.R, AKP, APK), duke përfshirë dhënjën e Licencave për prerjen e masës drunore, në bazë të rregullave të miratuar nga qeveria e Kosovës.

12.3. Autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës mund të delegojnë kompetenca, autorizime, dhe përgjegjësi shtesë Komunës, në pajtim me ligjet në fuqi, por materializimi në jetë i këtyre përgjegjësisve nga Komuna duhet të mbështetet, me burime të nevojshme financiare nga autoritetet qendrore si deleguese të kompetencave.

12.4. Ministria përkatëse e autorizuar për mbikëqyrjen e kompetencave të deleguara në Komunë, monitoron nëse vendimet që i ndërmer Komuna janë në përputhje me ligjet pozitive në përgjithësi dhe me LVQL në veqanti .

Neni 13

Mardhëniet me fshatrat - shtrirja administrative në Vendbanime

13.1. Për të siguruar ofrimin e shërbimeve cilësore, të lehta dhe për të siguruar përmbushjen e nevojave të të gjithë qytetarëve të Komunës në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, Komuna respektivisht Kryetari i Komunës me vendim të veçant, mund të bartë dhe të decentralizoj shërbime të caktuara nga Kompetenca e organeve të administratës në këto vendbanime, fshatra dhe lagje urbane.

13.2. Shërbimet e decentralizuara administrative të administratës komunale nga par.1. i këtij neni, mund të kryhen duke themeluar zyra për numër të caktuar fshatrash dhe vendbanimesh.

13.3. Gjatë themelimit (zgjedhëjes) së këshillave të fshatrave dhe të këshillit të qytetit të Vitisë dhe emërimit të kryetarve të këtyre këshillave ,duhet respektuar përfaqsimin proporcional të subjekteve politike, në përbërjen e këtyre këshillave dhe në kryesimin e tyre

13.4. Kryetari i këshillit të qytetit të Vitisë dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave mbajnë kontakt të drejtëpërdrejtë me Kryetarin e Komunës, për prezantimin e interesave, nevojave dhe kërkesave të qytetarëve të Vitisë dhe të fshatrave të Komunës.

13.5. Procedurat për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe të qytetit të Vitisë, do të rregullohen me rregullore të veqantë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Neni 14

Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkombëtar i Komunës

14.1. Komuna ka të drejtë brenda kompetencave të saj të bashkëpunoj dhe të lidh marrëveshje bashkpunimi me cilën do Komunë të Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të interesave reciproke dhe projekte zhvillimore të përbashkëta.

14.2. Me qëllim të promovimit të interesave të përbashkëta, Komuna mund të aderohet, dhe të marrë pjesë në asocione që funksionojnë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin në fuqi në Kosovë.

14.3. Komuna gëzon të drejtën e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe partneritetit me organet e shtetëve të tjera të vetëqeverisjes lokale në të gjitha fushat e kompetencave të mvetsishme të Komunës, përvec kompetencave të padelegueshme të Kuvendit Komunal.

14.4. Komuna në koordinim dhe në bashkëpunim me asoacionet e Komunave të Republikës së Kosovës, mund të bashkëpunojë me asoacionet ndërkombëtare të autoriteteve lokale, në pajtim me parimet e Kartes Evropiane për vetëqeverisje lokale dhe në pajtim me ligjin.

KAPITULLI III

Neni 15

PJESMARRJA E DREJTPËRDRJET E QYTETARVE NË VENDIMMARRJE PËR QËSHTJET ME INTERES PUBLIK

15.1. Qytetarët në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe të akteve tjera nënligjore të Komunës mund të inicojnë dhe kërkojnë, shqyrtim, transparencë, dhe të informohen për qështjet me interes publik për qytetarët, lagjet urbane, fshatrat dhe venbanimet e Komunës së Vitisë.

15.2. Transparenca dhe informimi për qështjet me interes publik nga par.1 i këtij neni bëhet përmes:

a- Mënyrave të të konsultuarit

b- Pjesmarrjes së drejtpërdrejt me aranzhimin e takimeve zyrtare me përfaqesit e organeve të Komunës.

c- Përmes shkresave të shkruara.

15.3. Me qëllim të informimit dhe të përmbushjes së Kërkesave të qytetarve për qështjet

me interes publik, Komuna organizon :

a- Fushata informative

b- Anketa ,lidhur me zbatimin e politikave Komunale

c- Prezantime publike të propozimeve lidhur me politika duke prezantuar projekt-rregullore apo projekt-vendime të përgjithshme

d-Kontakte me grupet përkatëse të interesit,

e- takime publike me qytetar

f- Komitete këshilldhënëse

g- Forma të tjera të konsultimit të ndërsjellt .

15.4. Rezultatet e konsultimeve apo të pjesmarrjes së qytetarëve në format e bashkpunimit si në par. 3 të këtij neni, do të merren parasysh dhe të publikohen para se të merret vendimi përfundimtar për qështjet e caktuara me interes publik.

15.5. Për organizimin e tubimeve publike, anketave apo grumbullimit të ideve, propozimeve dhe sugjerimeve nga qytetarët dhe formën e procedimit të tyre vendosin organet Komunale në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tyre ligjore. -Të gjitha qështjet nga neni.15 i këtij statuti rregullohen në hollësi me rregullorën për përbërjen dhe kompetencat e Komitetëve të Kuvendit Komunal.

15.6. Për qdo tubim publik mbahet procesverbali i cili përmban rrjedhën e tubimit publik dhe të gjitha informatat e dhëna nga përfaqesit e organeve të Komunës, propozimet e parashtruara si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e dhëna.

15.7. Procesverbalin nga par.6. i këtij neni në afat prej 30-ditësh, pas mbajtjes së tubimit publik e shqyrton komiteti për politik dhe financa. Komiteti për politik dhe financa analizon dhe shqyrton çdo propozim të parashtuar në tubimin publik, dhe i bën rekomandimet e nevojshme të cilat ia propozon Kuvendit të Komunës në seancën e radhës punuese

Neni 16

16.1. Komuna organizon takime publike me qytetarët së paku dy herë në vit njëri takim në gjashtëmujorin e par[të vitit dhe tjetri në gjashtëmujorin e dytë të vitit në vazhdim,

16.2. Në takimet publike me qytetarët, përfaqesit e organeve Komunale i informojnë qytetarët për qështjet që i përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe të politikës Komunale si: infrastruktura dhe kualiteti i jetës së qytetarëve,gjendja sociale e shtresave shoqërore,investimet propercionale dhe shpërndarja investive e buxhetit komunal, dhe qështjet tjera me interes për qytetarët.

16.3.Takimet publike janë të hapura, në to mundë të marrin pjesë të gjithë të interesuarit.

16.4. Pjesëmarrësit në takimet publike mund të marrin iniciativa, të japin mendime për qështjet të caktuara në kuadër të fushës së kompetencave të organeve Komunale

16.5. Vendi, koha dhe data e mbajtjes së tubimëve publike shpallet dhe publikohet në tabelën e shpalljeve në ndërtesën e Komunës dhe në vendet frekuentuese në qytetet, lagjet urbane dhe në fshatra, në ueb-faqen e Komunës si dhe në mediumet elektronike, lokale, së paku 4-ditë para mbajtjes së tubimit publik. Shpalljen publike e bënë zyra për marrëdhënie me publikun e cila kujdeset për organizimin e tubimëve publike.

16.6. Takimet publike i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i autorizuar i tij.

16.7. Kryetari i Komunës është i autorizuar të caktojë rendin e ditës dhe procedurën dhe udhëheqjen e diskutimëve. Në rast nevojë ka të drejtë të ndërpres diskutimet për qështjet që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësit e Komunës, dhe për pyetjet e përsëritura.

16.8. Nëse në tubim publik shtohet ndonjë pyetje për të cilën nuk mund të ipet përgjegjje menjëherë, parashtuesi i pyetjes ka të drejtë të kërkojë përgjegjje me shkrim mbrenda 30-ditëve pas mbajtjes së tubimit publik. Përgjigjja me shkrim duhet dhënë në afatin prej 15-ditësh pas marrjes së kërkeses së qytetarit.

Neni 17

E DREJTA E PETICIONIT TË QYTETARËVE TË KOMUNËS

17.1. Qdo subjekt i së drejtës që ka interes në Komunë apo kërkesë nga Komuna, ka të drejtën e paraqitjes së peticionit në Kuvendin e Komunës nën kushtet dhe mënyren e përcaktuar me dispozitat e këtij Statuti, dhe në kuader të përgjegjësisive dhe kompetencave të Komunës.

17.2. Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit të peticionit nga komiteti për politik dhe financa dhe në bazë të rekomandimeve nga ky komitet, obligohet që qështjen e peticionit ta shqyrtojë në seancën e rregullt plenare të Kuvendit të Komunës.

17.3. Iniciativa e subjekteve të së drejtës fillon me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit, duke specifikuar dhe identifikuar me propozim të veçantë qështjen e caktuar që kërkohet me peticion nga Kuvendi i Komunës.

17.4. Peticioni i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes zyrës përkatëse të drejtorisë së administratës.

17.5. Procedimi i peticionit dhe përcaktimi i numrit të nënshkrimeve nga qytetarët madhor me zotësi juridike dhe të veprimtari, dhe validiteti shqyrtues i peticionit rregullohet me rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, në përputhje me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe me Statutin e Komunës.

Neni 18

INICIATIVAT E QYTETARËVE TË KOMUNËS

18.1. Qytetarët e Komunës në formë të organizuar, mund të marrin iniciativa, për të propozuar apo ndryshuar aktet e përgjithshme nënligjore (rregulloret, vendimet) të Komunës, në fushën e kompetencave dhe të përgjegjësive të Komunës.

18.2. Propozuesit dhe bartësit e iniciativës qytetare ia drejtojnë propozimin për ndryshim apo projekt-propozimin e tyre të aktit nënligjor të propozuar për miratim kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

18.3. Propozimet nga iniciativat qytetare, për miratimin e akteve, ndryshimin e tyre dhe shfuqizimin e akteve në fuqi, duhet të nënshkruhen së paku nga 15% të votuesve të regjistruar të trupit elektorale të Komunës për tu proceduar dhe shyrtuar nga Kuvendi i Komunës.

18.4. Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtoj propozimin nga iniciativa qytetare (propozimin valid) mbrenda afatit kohor prej 60-ditësh nga dita e pranimit të tijë. Iniciativa i drejtohet kryesuesit të Kuvendit të Komunës në mënyrë si në nenin 17.par.4. të këtij Statuti.

Neni 19

REFERENDUMI

19.1. Referendumi paraqet formën direkte dhe më demokratike të deklarimit personal të vulnetit të qytetarëve të komunës, për qështje shumë të rëndësishme vendim-marrëse në kuadër të të drejtave, autorizimeve dhe përgjegjësive ligjore të komunës.

19.2. Qytetarët e komunës me të drejtë vote mund të kërkojnë që rregulloret e caktuara, të miratuara nga kuvendi komunal si dhe aktet e tjera të përgjithshme nënligjore të miratuara nga i njeiti organ, t'i nënshtrohen referendumit, me qëllim të verifikimit të pranushmërisë apo shfuqizimit të tyre.

19.3. Kërkesa e arsyetuar duhet t'i dorzohet kryesuesit të kuvendit të komunës në afatin prej 30 ditësh nga data e miratimit të rregullores apo aktit tjetër të përgjithshëm të Kuvendit të komunës.

19.4. Kërkesa me propozimin për mbajtjen e referendumit nga arsyet si në par.2. të këtij neni duhet të nënshkruhet nga së paku 10% të votuesve të regjistruar. Përqindja e votuesve të regjistruar duhet të konfirmohet nga KKZ.

19.5. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës pas pranimit të kërkesës, si në par.3. të këtij neni, në

afatin sa më të shkurt por jo më vonë se 7 ditë, do ta shtroj qështjen e kërkesës, në Komitetin për politik dhe financa, dhe kërkon rekomandimet e këtij trupi të Kuvendit lidhur me procedimin dhe shqyrtimin e qështjes së propozuar në Kuvendin e Komunës.

19.6. Në të gjitha rastet Kuvendi i Komunës pa vonesë, por jo më gjatë se në afatin prej 30 ditësh, duhet ta shqyrtoj Kërkesen qytetare, në pajtim me ligjin në fuqi dhe dispozitat e këtij Statuti.

Neni 20

LARGIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS ME INCIATIVË TË QYTETARVE TË KOMUNËS

20.1. Qytetarët e Komunës me të drejtë vote mund të ndërmarrin iniciativë për largimin nga detyra të Kryetarit të Komunës.

20.2. Iniciativa me kërkesën e arsyetuar duhet të nënshkruhet nga 20%, e votuesve të regjistruar në regjistrat e votuesve, dhe e njejta i dorzohet Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

20.3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, kërkesën e arsyetuar me aneksin e nënshkrimeve të verifikuara ia paraqet komisionit përkatës për administrimin e votimin në procedim të mëtejshëm.

20.4. Nëse shumica e votuesve të regjistruar të komunës, votojnë për largimin e kryetarit, atëherë pas qertifikimit të rezultateve të votimeve, Kryetarit të komunës i ndërpritet statusi i Kryetarit të Komunës.

20.5. Zgjedhjet për kryetarin e ri të komunës duhet të shpallen dhe të mbahen në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi zgjedhjet.

Neni 21

INFORMIMI I QYTETARVE DHE QASJA E LIRË NË DOKUMENTE ZYRTARE KOMUNALE ME KARAKTER PUBLIK

21.1. Organet e Komunës, komitetet e përhershme dhe komitetet e tjera, si dhe komisionet e Kuvendit të Komunës dhe institucionet e tjera publike të themeluara nga komuna, i informojnë qytetarët e komunës për veprimtaritë e veta dhe për vendimet e tyre, të cilat veprimtari dhe vendime janë me rëndësi të drejtpërdrejtë për jetën dhe punën e qytetarve.

21.2. Qytetarët e komunës informohen për: rregulloret, vendimet dhe aktet e tjera të përgjithshme që i miraton Kuvendi i Komunës. Ata gjithashtu informohen për vendimet, urdhresat dhe aktet tjera që i nxjerr kryetari i komunës.

21.3. Qytetarët informohen për kushtet dhe mënyrën e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të tyre, gjatë zbatimit të akteve nga par.2. i këtij neni, ata gjithashtu mund të informohen në mënyrë të drejtpërdrejt apo përmes anëtarve të Kuvendit Komunal edhe për planet, projektet dhe programet zhvillimore të komunës, të cilat realizohen dhe konkretizohen në interes të qytetarve të komunës.

21.4. Informimi i qytetarve bëhet në mënyrë të rregullt dhe pa kompenzim përmes: shpalljeve në tabelen e shpalljeve të Komunës; botimit dhe shpërndarjes së boletinit informative, të zyrës kompetente për marrëdhënie me publikun, faqës së internetit, tribunave publike dhe mjeteve lokale dhe nacionale të informimit.

Neni 22

22.1. Në komunë sigurohet dhe garantohet e drejta e qytetarve në qasje të lirë në dokumentet zyrtare me karakter publik. Kryetari i komunës dhe administrata Komunale sigurojnë kushtet dhe caktojnë zyrtarët kompetent për realizimin e kërkesave të qytetarëve në qasjen në dokumentet me karakter publik .

22.2. E drejta në qasje të lirë në dokumentet zyrtare me karakter publik, mund të kufizohet vetëm në mbështetje të dispozitave të ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare .

22.3. Qasjen në dokumentet zyrtare e siguron dhe krijon kushte për realizimin e kërkesave të tilla kryetari i Komunës.

22.4. Qasja në dokumentet zyrtare realizohet me kërkesën e subjektit të së drejtës apo të autorizuarit të tij në përputhje me dispozitat e LPA, dhe të Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare.

22.5. Të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët konsiderojnë se nga organet e zgjedhura të komunës apo nga administrata Komunale iu janë cenuar apo shkelur të drejtat e tyre, mund të paraqesin ankesa, parashtresa dhe kërkesë-sqarime, në formë të shkruar apo në procesverbal para personit të autorizuar të drejtorisë së administratës për komisionin për ankesa dhe parashtresa të qytetarve.

22.6. Kryetari i Komunës emron një Komision për shqyrtimin e ankesave dhe të parashtresave të qytetarve në pajtim me Udhëzimin Administrativ të zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës Nr. 05/2006 për organizimin dhe funksionimin e zyrave për pranimin e ankesave dhe të kërkesave të qytetarve.

22.7. Kryetari i Komunës është i detyruar që në afat sa më të shkurtër që mundet, por jo më vonë se në afat prej 60 ditësh nga data e pranimit të ankesës apo parashtesës, paraqitësit ti jep përgjegjje të shkruar dhe të arsyetuar.

KAPITULLI IV

Neni 23

ORGANET E ZGJEDURA TË KOMUNËS SË VITISË

23.1. Organet më të larta të komunës të zgjedhura me votë të drejtpërdrejt të qytetarve të komunës janë:

- a. KUVENDI i KOMUNËS dhe
- b. KRYETARI i KOMUNËS

Neni 24

A- KUVENDI i KOMUNËS

24.1. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimëmarrës dhe i pushtetit në Komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt me votën e lirë të qytetarve të komunës në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet Lokale.

24.2. Kuvendi si organ më i lartë i pushtetit në komunë funksionet dhe përgjegjësitë e veta i ushtron në interesin e komunës dhe për Komunën, duke u mbështetur në dispozitat e ligjeve pozitive, akteve nënligjore të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Statutin e Komunës dhe në rregulloren e punës së Kuvendit dhe të Komiteteve të Kuvendit të Komunës.

24.3. Të gjithë qytetarët e komunës së Vitisë mund të kandidohen për antarë të kuvendit të Komunës me kusht, që ata/ato t'i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.

24.4. Kuvendin e Komunës së Vitisë e përbëjnë 27 antarë të kuvendit, mandati i të cilëve zgjat 4 vite.

24.5. Mandati i qdo antari të kuvendit të Komunës verifikohet nga Komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës para nënshkrimit të mandatit nga secili antar.

24.6. Të gjithë antarët e Kuvendit të Komunës së Vitisë duhet ta nënshkruajn betimin solemn.

24.7. Teksti i betimit solemn është si në vijim:

➤ Beto hem solemnisht se do t'i kryej me nder, me besnikri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si antar i kuvendit të Komunës së Vitisë në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

24.8. Antarët e kuvendit të komunës së Vitisë të cilët nuk e nënshkruajn betimin ose mandatin në pajtim me par.6 dhe 7 të këtij neni brenda një muaji pas qertifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës .

Neni 25

25.1. Procedurat për formimin e komisionit për verifikimin e mandateve për antarët e Kuvendit të Komunës, rregullohen në hollësi me rregullorën e punës së Kuvendit të Komunës

Neni 26

PUSHIMI (SHUARJA) E MANDATIT TË ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

26.1. Antarit të kuvendit të Komunës së Vitisë i pushon mandati të jetë antarë i Kuvendit të Komunës në këto raste:

- a- Me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b- Nëse ai/ajo ndrron vendbanimin ku është zgjedhur;
- c- Nëse antari ia paraqet kyretarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- d- Nëse antari ka qenë i denuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për mbajtjen e burgut për gjashtë (6) ose më shumë muaj;

e- Nësë antari i Kuvendit të Komunës nuk merr pjesë tre muaj rresht në mbledhjet e kuvendit të Komunes pa arsye;

f- Nësë ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm e s'kualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.

26.2. Antari i Kuvendit të Komunës së Vitisë në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 27

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

27.1. Të gjithë antarët e Kuvendit të Komunës së Vitisë kanë të drejta dhe detyrime të barabarta, gjatë ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve në mandatin e verifikuar të antarit të kuvendit të Komunës, në përphje me Ligjet pozitive, me këtë Statut dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit.

27.2. Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së Komunës, nuk mund të jenë antar të kuvendit të Komunës ku ata punojnë.

27.3. Antari i Kuvendit të Komunës mund të dorëzoj vërejte me shkrim gjatë seancave plenare të kuvendit, vërejtjet e antarëve të Kuvendit i bashkangjiten procesverbalit.

27.4. Antari i Kuvendit mund t'i drejtohet secilit Komision të Kuvendit apo Komitetit të tij për qështjet për të cilat debatohet, por i njëjti nuk mund të votoi për qështjen e shtruar të komisionit apo Komitetit, në të cilin nuk është anëtar.

27.5. Antari i Kuvendit të Komunës mund të kërkoj nga Kryetari i Komunës informacione që janë të nevojshme për punën e tij.

27.6. Antarët e Kuvendit të komunës mund të mungojnë nga vendi i punës për periudha kohore që janë të domosdoshme për kryerjen e punëve të Kuvendit të Komunës.

27.7. Antarët e Kuvendit të Komunës janë të obliguar të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës të thirrura në mënyren e duhur, gjithashtu ata obligohen që të marrin pjesë edhe në seancat punuese të komisioneve dhe komiteteve ku ata janë antarë, mungesat nga seancat e Kuvendit të komunës, të komiteteve dhe Komisioneve të tij, antari i Kuvendit duhet t'i justifikoj tek kryesuesi i Kuvendit.

27.8. Kërkesat e antarit të Kuvendit nga par. 5. dhe mospërbushjet e tyre, antari i kuvendit të njejtat qështje për mosbashkpunim mund ti ngris në Kuvendin e Komunës.

27.9. Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe në mbështetje të udhëzimeve të nxjerrura nga Qeveria e Republikës së Kosovës, antarëve të Kuvendit të Komunës për punën e tyre në Kuvendin e Komunës dhe në Komitetet e përhershme të tij - ju cakton kompenzimin në vlerë monetare.

27.10. Të drejtat dhe detyrimet e antarëve të Kuvendit të përcaktuara me dispozitat e nenit 26 të këtij statute, rregullohen dhe precizohen në hollësi me rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 28

MBLEDHJA INAGURUESE- KONSTITUIVE E KUVENDIT TË KOMUNËS

28.1. Kuvendi i Komunës së Vitisë e mbanë seancën e parë konstituive brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e qartifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

28.2. Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryesuesi i përbërjes paraprake të Kuvendit të Komunës në afatin si nga par.1. i këtij neni.

28.3. Nëse Kryesuesi nuk e thërret mbledhjen sipas detyres zyrtare si në par.2.të këtij neni, mbledhja konstituive mund të thirret nga antari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit Komunal mbrenda afatit prej 15 ditësh, nga data kur kryesuesi nga par.2. i këtij neni është dashur të thërras mbledhjen inauguruese.

28.4. Nëse antari më i vjetër i Kuvendit të Komunës nuk e thërret mbledhjen si në par.3 të këtij neni, mbledhja konstituive e Kuvendit të Komunës, mund të caktohet me iniciativë të shumicës së thjeshtë të përbërjes së antarëve të Kuvendit të komunës.

28.5. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës të cilat mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit Komunal, kryesohen nga antari më i moshuar i Kuvendit të Komunës, i ndihmuar nga antari më i ri për nga moshën i Kuvendit të Komunës.

Neni 29

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

29.1. Kuvendi i Komunës së Vitisë e zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga përbërja e antarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

29.2. Antarët e Kuvendit të Komunës janë të barabart për tu zgjedhur dhe për të zgjedh Kryesuesin e Kuvendit.

29.3. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjidhet për një mandat të njejt sikurse mandati i antarve të Kuvendit të Komunës.

29.4. Votimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës bëhet ekskluzivisht me vota të fshehta.

29.5. Kandidati për kryesues të Kuvendit të Komunës për tu zgjedhur në votimin e parë, duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të antarve të Kuvendit me kuorum të thjeshtë punues.

29.6. Në rastet kur në votimin e parë asnjëri prej kandidatve nuk e fiton shumicën e kërkuar nga par.5. i këtij neni, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë.

29.7. Kandidati për kryesues të Kuvendit të Komunës i cili në votimin e dytë merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të antarve të Kuvendit të Komunës, me kuorum të thjeshtë punues, zgjidhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Neni 30

MBLEDHJET E KUVENDIT TË KOMUNËS

30.1. Kuvendi i Komunës, ushtrimin e përgjegjësiave, kompetencave dhe të funksioneve të tij, i kryen përmes seancave plenare të Kuvendit të Komunës, seancave të trupave të Kuvendit (komiteleve dhe komisioneve) në përputhje me dispozitat e Ligjit për Vetqeverisje Lokale (Nr.03/L-040), Statutit të Komunës dhe rregullores së punës të Kuvendit të Komunës dhe të Komiteleve të tij.

30.2. Thirrjen e seancave të Kuvendit, miratimin e rendit të ditës, zgjedhjen dhe kompetencat e organeve të Kuvendit të Komunës, procesverbalin e punës së Kuvendit dhe qështjet e tjera lidhur me funksionimin e rregullt dhe ligjor të Kuvendit, më saktë i definon Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë

30.3. Kuvendi i Komunës gjatë ushtrimit të punëve të tij në kuadër të kompetencave të Kuvendit mban:

- a- Seanca të rregullta të punës;
- b- Seanca të jashtzakonshme dhe
- c- Séance solemne.

30.4. Seancat e rregullta të punës Kuvendi i Komunës i thërret për të shqyrtuar propozimet e vendimeve, akteve, iniciativave, dhe qështjeve të tjera nga kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës.

30.5. Antarët e Kuvendit të Komunës për seancat e rregullta të punës, duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, 7 ditë pune para mbajtjes së seanceës së rregullt të punës të Kuvendit të Komunës, dhe të njoftohen me rendin e ditës dhe materialet të cilat shqyrtohen në seancën e punës.

30.6. Njoftimi, rendi i ditës dhe materialet përcjellse për punën e Kuvendit të Komunës rrespektivisht për antarët e Kuvendit, duhen të bëhen në përputhje edhe duke rrespektuar ligjin mbi gjuhët, I njejt i njoftim duhet të shpallet dhe publikohet.

30.7. Njoftimet nga par.3.4, i këti neni i dërgohen edhe ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Neni 31

31.1. Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës thirret për qeshtjet me rëndësi të jashtëzakonshme për sigurinë e qytetarëve të komunës, dhe në raste të rrethanave të jashtëzakonshme të shkaktuara nga fuqia madhore(Vis Maioris).

31.2. Seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës e thërret Kryesuesi i Kuvendit , me kërkesën Kryetarit të Komunës dhe me kërkesën e më së paku një të tretës së numrit të përgjithshëm të antarve të Kuvendit.

31.3. Ftesa për seancë të jashtëzakonshme bashkë më propozimin e rendit të ditës u dërgohet antarve të Kuvendit të Komunës së paku 3 ditë punë para mbajtjes së seancës.

31.4. Para mbajtjes dhe fillimit të punës së seancës, antarët e kuvendit votojnë për arsyen e mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme, pa zhvilluar debat, dhe me shumicën e thjeshtë të votave të antarve të Kuvendit miratohet rendi i ditës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Neni 32

32.1. Seanca solemne e Kuvendit të Komunës ftohet dhe mbahet, për shënimin dhe përkujtimin e ngjarjeve, datave, personaliteteve të rëndësishme historike dhe për dëgjimin e fjalimeve të zyrtarëve të lart reprezentativ të shtetit të Kosovës dhe zyrtarve të tjerë të shteteve dhe organizatave ndërkombtare.

32.2. Në shenje rrespekti dhe nderimi, seanca solemne mund të mbahet edhe për përfaqësues eminent të fushës së shkencës, artit dhe kulturës.

32.3. Ftesa për seanca lolemne bashkë me propozimin e Rendit të ditës u dërgohet antarve të Kuvendit të Komunës së paku 3 ditë para mbajtjes së seances solemne

Neni 33

33.1. Mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për opinjon, gjithashtu edhe seancat e Komiteteve dhe komisioneve janë të hapura për publikun;

33.2. Me statut dhe Rregullore të punës së kuvendit dhe me rregullore për organizimin dhe funksionimin e komiteteve dhe komisioneve të Kuvendit përcaktohen rregullat sipas të cilave Kuvendi vendos për seanca të hapura dhe të mbyllura punuese.

Neni 34

34.1. Kuvendi Komunës së Vitisë mban së paku 10 seanca të punës në vit, pesë(5) prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit vijues, dhe pesë(5) të tjerat në gjysmën e dytë të vitit kalendarik.

Neni 35

FUNKSIONET DHE KOMPETENCAT E KUVENDIT TË KOMUNËS

35.1. Kuvendi i Komunës së Vitisë funksionet dhe kompetencat e tija i ushtron në bazë të LVQL, Statutit të komunës dhe akteve të tjera nënligjore që miratohen nga Kuvendi.

35.2. Përgjegjësit dhe kompetencat ekskluzive të Kuvendit të Komunës të cilat Kuvendi i Komunës nuk i delegon për vendimmarrje në organet e tjera janë:

- a- Miratimin e statutit, rregullores së punës dhe rregulloreve të tjera komunale dhe ndryshimin apo shfuqizimin e tyre;
- b- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- c- Miratimin e qështjeve të tjera financiare të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit apo rregullorës së punës.
- d- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- e- Themelimin e komiteteve, komisioneve dhe të keshilleve të kërkuara sipas LVQL;
- f- Zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
- g- Përcaktimin e nivelit të tarifave, taksave dhe gjobave;

- h- Krijimin dhe përcaktimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit .
- i- Emrimin dhe riemrimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- j- Arritjen e marrveshjeve ndërkomunale dhe mbrenda komunale;
- k- Marrjen e vendimeve për tu bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, dhe bashkpunimit ndërkufitar.
- l- Marrjen e vendimeve për dhënjen në shfrytëzimin dhe këmbimin e pronës së palujtshme komunale.
- m- Marrjen e vendimeve për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për komunën dhe shpronsimin. (Ligji mbi shpronsimin);
- n- Dhe përgjegjsive të tjera qe caktohen me ligje të përgjithshme dhe të vecanta.

35.3. Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'i delegoi kompetencat e tij Komitetit të Kuvendit të Komunës apo Kryetarit të Komunës.

35.4. Gjatë rrethanave të jashtzakonshme dhe gjendjeve të jashtzakonshme, Kuvendi i Komunës mund të delegoi kompetencat e tij vendimmarrse tek Kryetari i Komunës apo tek komiteti për politik dhe financa

35.5. Kuvendi i Komunës në qdo kohë mund të revokoi (tërheq) vendimin për delegimin e Kompetencave, Komitetit të Kuvendit apo Kryetarit të Komunës.

Neni 36

AKTET E KUVENDIT TË KOMUNËS

36.1. Kuvendi i Komunës së Vitisë mund të miratoi akte të përgjithshme dhe akte të veqanta me fuqi juridike nënligjore në kuadër të fushës së kompetencave dhe të përgjegjësive të tij.

36.2. Aktet juridike të Kuvendit të Komunës së Vitisë me fuqi juridike obligative në të gjithë territorin e Komunës së Vitisë janë:

- a- Statuti i Komunës së Vitisë ;
- b- Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës ;
- c- Rregulloret tjera Komunale;
- d- Qdo akt tjetër juridik i përgjithshëm apo i veqant i miratuar nga Kuvendi i Komunës i mbështetur në ligjet pozitive në statutin e Komunës dhe në aktet tjera të përgjithshme të Kuvendit të Komunës.

Neni 37

KUORUMI DHE VOTIMI NË KUVENDIN KOMUNAL

37.1. Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të trupave të tij, është së paku gjysma e numrit të antarve të Kuvendit të Komunës- Kuorumi i thjeshtë (50 + 1) të anëtarëve të kuvendit të komunës.

37.2. Përgjashtimisht nga dispozita e par.1. të këtij neni për rastet kur nevojitet miratimi i statutit të Komunës dhe i ndryshim-plotsimeve të tij ku nevojitet kuorumi i kualifikuar (2/3) për votim dhe miratim të aktit.

37.3. Kryeuesi i Kuvendit të Komunës duhet të verifikoi ekzistimin apo mosekzistimin e kuorumit të thjeshtë apo të kualifikuar para çdo propozimi për të cilin votohet për miratim.

Neni 38

38.1. Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të Kuvendit, secili antar, përfshir edhe Kryesuesin e ka nga një votë.

38.2. Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryesuesit e Komiteteve të përhershme dhe të Komiteteve tjera, kanë nga një votë shtesë, nëse votimi është i barabart për ose kundër një propozimi ,për miratimin e një vendimi apo rekomandimi.

38.3 Vendimet e Kuvendit të Komunës miratohen me votën e shumicës së antarve të Kuvendit Komunal që janë të pranishëm dhe që votojnë.

38.4 Apstenimet e antarve të Kuvendit të Komunës me rastin e votimit, regjistrohen dhe llogariten në themelimin e kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.

38.5. Në të gjitha rastet kur ekziston kuorumi i thjeshtë dhe valid, për miratimin e vendimeve në kuvend, numrohen votat e antarve të Kuvendit që votojnë për ose kundër miratimit, votat e tjera konstatohen në procesverbalin e punës së Kuvendit.

38.6. Menyra e caktimit të rendit të ditës dhe mbajtjes së procesverbalit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, rregullohet me rregulloren e punës së Kuvendit dhe rregulloren e Komiteteve të Kuvendit të Komunës.

38.7. Votimi në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij është publik, por Kuvendi mund të vendos me shumicë të thjeshtë të antarve të Kuvendit që votimi të bëhet me votim të fshehtë për qeshtje të caktuara.

Neni 39

SHPËRNDARJA E KUVENDIT TË KOMUNËS

39.1. Në rastet kur Kuvendi i Komunës së Vitisë, nuk i përmbush detyrimet, kompetencat dhe përgjegjësit ligjore dhe statutore, dhe nëse bëhet jo-funksional, dhe me këtë rrezikohen të drejtat themelore të qytetarve nga mosfunksionimi i Kuvendit të Komunës, atëhere Kuvendi i Komunës mund të shpërndahet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

39.2. Kuvendi i Komunës është jo funksional nëse:

- a- Nuk e zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës në afatin prej 30 ditësh pas themelimit të tij.
- b- Nuk e miraton Statutin e Komunës në afatin prej 60 ditësh pas themelimit të tij të pare si organ;
- c- Nuk e miraton buxhetin e komunës në afatin e parapar ligjor dhe
- d- Nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

39.3. Ministria përgjegjëse për administrimin e pushtetit lokal, njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e Kuvendit të Komunës së Vitisë, kurse Qeveria bie vendimin për shpërndarjen e Kuvendit të Komunës.

39.4. Pas shpërndarjes së Kuvendit të Komunës, shpallen zgjedhjet e reja për Kuvendin e Komunës në pajtim me Ligjin për zgjedhjet.

Neni 40

KOMITETET E KUVENDIT TË KOMUNËS

40.1. Kuvendi i Komunës, në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisive ligjore, dhe në funksion të përgatitjes dhe përmbushjes efektive të detyrave të tij- formon trupa punuese të Kuvendit.

40.2. Trupat punuese të Kuvendit janë mekanizma të rëndësishëm, të cilët ndihmojnë organet e komunës, e në vecanti Kuvendin e Komunës, në analizimin dhe orjentimin e përgjithshëm të komunës, në aspektin e hartimit, korigjimit dhe të zbatimit të politikave, për të gjitha qështjet financiare- buxhetore dhe politikat e zhvillimit të Komunës, si dhe politikat

dhe aktivitetet për sigurimin dhe jetsimin e të drejtave dhe interesave të Komuniteteve pakicë në komunë.

40.3. Me qëllim të realizimit të funksioneve ligjore dhe Statutore dhe detyrave dhe synimeve nga par.2. I këtij neni, Kuvendi i Komunës së Vitisë formon:

- a- Komitete të Përhershme dhe
- b- Komitete të tjera.

Neni 41

41.1. Komitetet e përhershme dhe obligative, në kuadër të strukturës organizative dhe funksionale të Kuvendit të Komunës së Vitisë janë:

- a- Komiteti për politikë dhe Financa;
- b- Komiteti për Komunitete.

41.2. Komitetet nga par.1. i këtij neni, paraqesin struktura të përcaktuara me Ligj, dhe Kuvendi i Komunës së Vitisë, me akte nënligjore nuk mund të ndryshoj statusin juridiko-ligjor të tyre.

41.3. Me rastin e formimit të Komiteteve, Kuvendi i Komunës, angazhohet dhe siguron përfaqsimin adekuat të një barazpeshje gjinore dhe të Komuniteteve etnike në të gjitha komitetet.

41.4. Përbërjet e antarve të Komiteteve të përhershme dhe e Komiteteve tjera të Kuvendit të Komunës, duhet të pasqyrojnë në mënyrën sa më të përafërt proporcionin e vendeve që i mbajnë subjektet politike, dhe antarë tjerë në Kuvendin e Komunës.

Neni 42

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

42.1. Komiteti për politikë dhe financa, është trupë punuese dhe funksionale e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

42.2. Antarët e Komiteteve për politikë dhe financa emrohen vetëm nga antarët e Kuvendit të Komunës, përbërja e të cilit rrespektton përfaqsimin proporcional të subjekteve politike në Kuvendin e Komunës.

42.3. Komitetin për Politikë dhe Financa e kryeson dhe udhëheq me seancat e tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

42.4. Përfundimet e qështjeve të shqyrtuara nga Komiteti për politik dhe financa miratohen në formë të REKOMANDIMEVE, për Kuvendin e Komunës.

42.5. Për zhvillimin e seancave të Komitetit për politikë dhe financa përpilohet procesverbali zyrtar, në të cilin përfshihen: qështjet e shqyrtuara, diskutimet dhe Rekomandimet përfundimtare të Komitetit për politikë dhe financa për Kuvendin e Komunës.

Neni 43

43.1. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave zyrtare dhe qytetare, propozimet për referendume, peticione dhe iniciativa të qytetarve Shqyrton dhe rekomandon për dokumentet e planifikimit strategjik, kornizen vjetore buxhetore, prokurimet dhe shqyrtimet e prokurimeve, planet vjetore dhe konstatimet periodike të auditorit të brendshëm të komunës, ndryshimet e planeve buxhetore gjatë vitit fiskal si dhe shqyrton të gjitha aktet e përgjithshme dhe të vecanta nënligjore dhe nxjerr rekomandimet e nevojshme për Kuvendin e Komunës.

43.2. Puna, përbërja, kompetencat dhe funksionimi i komitetit për politikë , dhe financa, rreguohen në hollësi me rregulloren e veçant për organizimin dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës dhe me rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës.

Neni 44

KOMITETI PËR KOMUNITETE

44.1. Komiteti për Komunitete themelohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me dispozitat e ligjit për vetqeverisjen Lokale (neni 53.) dhe në përbërjen e tij, përvec antarve të Kuvendit të Komunës, përfshihen edhe përfaqësues të Komuniteteve të cilët nuk përfaqsohen në Kuvendin e Komunës, por janë banorë rezident të Komunës së Vitisë.

44.2. Komiteti për Komunitete, përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga antarët e Kuvendit, kurse antarët tjerë janë përfaqësues tjerë nga Komunitetet.

44.3. Qdo komunitet që jeton në Komunën e Vitisë, përfaqsohet nga së paku me një antar në Komitet për komunitete.

44.4. Në të gjitha rastet, përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë përbejnë shumicën e antarve të Komitetit për komunitete.

Neni 45

45.1. Komiteti për Komunitete në kuadër të të drejtave dhe përgjegjësive të tij, është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave të cilët i ndërmarrin organet komunale, dhe

vlersimin e të njejtave politika me konstatimin se a janë në përputhje dhe në mbeshtetje me ligjet pozitive, dhe vecanërisht me të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

45.2. Komiteti për Komunitete ka për detyrë dhe përgjegjësi, që në kuadër të Komunës së Vitisë dhe të organeve të sajë të sigurojë se:

- a- Asnjë organ komunal që ushtron autorizime dhe përgjegjësi publike, nuk guxon të bëjë asnjë formë diskriminimi mbi baza të përkatësisë etnike, gjuhës ose lidhjes me komunitetin;
- b- Të gjithë qytetarët e Komunës së vitisë, gëzojnë të drejta të barabarta në fushat e të drejtave civile, politike, ekonomike dhe shoqërore në përgjithësi, pa kurfar diskriminimi gjuhësor, etnik apo Statusi shoqëror- me mundësi të barabarta në shfrytëzimin e shërbimeve komunale, në të gjitha strukturat e organizimit të shërbimeve publike.

45.3. Kryesuesi i Komitetit për komunitete për të gjitha konstatimet dhe faktet, rreth realizimit apo mosrealizimit të detyrave dhe përgjegjësi të organeve të Komunës sipas dispozitave të neneve 44 dhe 45 të këtij Statuti, informon Kryetarin e Komunës dhe Kuvendin komunal të Komunës së Vitisë.

Neni 46

KOMITETET KONSULTATIVE TË KUVENDIT

46.1. Kuvendi i Komunës së Vitisë për qështjet e caktuara nga fusha e përgjegjësi dhe kompetencave të tij dhe sipas propozimit të Kryetarit të Komunës së Vitisë, themelon Komitete konsultative nga radha e antarëve të Komiteteve të përhershme dhe nga grupi i qytetarve (grupet e interesit, shoqëria civile etj.) me qëllim të krijimit të hapsirave për konsulta të gjëra publike para propozimit të vendimeve dhe planeve zhvillimore në fusha të caktuara. Mandati i Komiteteve Konsultative zgjat sa edhe mandati i Kuvendit të Komunës.

46.2. Kuvendi i Komunës mund të themeloj edhe komitete konsultative "AD HOC" për shqyrtimin e qështjeve të caktuara specifike për përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës. Mandati i Komiteteve të tilla pushon pas përfundimit të qështjeve të shqyrtuara.

46.3. Organizimi, përbërja dhe kompetencat e Komiteteve konsultative precizohen me Rregullore të veqant të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 47

KOMITETET E TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS

47.1. Kuvendi i komunës së Vitisë, në interes të sigurimit të informacioneve dhe të përcjelljes së gjendjes në fushat specifike të veprimtarive të organeve të administratës Komunale, dhe monitorimet të zbatueshmërisë së akteve të miratuara të Kuvendit, nga Ekzekutivi I Komunës së Vitisë, themelon Komitete të përkohsme dhe të përhershme, për përcjelljen e fushave të caktuara të veprimit të organeve Komunale në interesin publik të qytetarve të Komunës.

47.2. Me qëllim të realizimit të funksioneve dhe përgjegjsive nga par.1. i këtij neni, Kuvendi i Komunës së Vitisë themelon këto Komitete:

- a- Komitetin për Arsim, Kulturë dhe Rini;
- b- Komiteti për planifikim, rregullimin e hapsirës dhe mbrojtjes së Mjedisit;
- c- Komiteti për shëndetsi dhe qështje sociale;
- d- Komiteti për auditim të brendshëm dhe prokurim;
- e- Komitetin për mundësi të barabarta dhe barazi gjinore;
- f- Komitetin për pronën komunale;
- g- Komitetin për shërbime publike;
- h- Komitetin për zhvillimin e Rural.
- i- Komitetin për ndërmjetsim
- j- Si dhe Komitetet të tjera kur Kuvendi i Komunës dhe Kryetari I Komunës e vleron të domosdoshme themelimin e tyre

47.3. Numri dhe antarët e Komiteteve zgjidhen me shumicën e thjeshtë të antarve të Kuvendit me propozim të grupeve të subjekteve politike të përfaqsuara në Kuvendin e Komunës

47.4. Mënyra i zgjedhjes, numri i antarve të Komiteteve raportimet e Komiteteve, rregullohen me rregullore të veqant të Kuvendit të Komunës.

KAPITULLI V

Neni 48

B-EKZEKUTIVI I KOMUNËS SË VITISË

KRYETARI I KOMUNËS

- 48.1. Kryetari i Komunës është organi më i lartë i pushtetit Ekzekutiv në Komunën e Vitisë.
- 48.2. Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët e Komunës së Vitisë me të drejt vote ,në pajtim me ligjin për vetqeverisje Lokale në fuqi.
- 48.3. Kryetari i Komunës zgjidhet për një periudhë kohore dhe mandat 4 vjeçar.

Neni 49

BETIMI I KRYETARIT TË

KOMUNËS

- 49.1. Me rastin e zgjedhjes, kryetari i Komunës së Vitisë jep betimin solemn para Kuvendit të Komunës së Vitisë..
- 49.2. Përmbajtja e tekstit të betimit është si ne vijim:
- "Beto hem që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushroj Kompetencat e mia si kryetar i Komunës së Vitisë, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me Ligjin,në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për te gjithë"*
- 49.3. Kryetari i Komunës nëse nuk e jep betimin solemn brenda një (1) muaji (30) nga qertifikimi i rezultateve të zgjedhjeve- me fajin e tij, e humb mandatin dhe statusin e Kryetarit të Komunës.

Neni 50

KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJSIT E KRYETARIT TË KOMUNËS

- 50.1. Kryetari i Komunës së Vitisë, në mbështetje të dispozitave të LVQL, dhe me dispozitat e këtij statuti është përgjegjës, kompetent dhe zbaton përgjegjësit si në vijim:

- a- Përfaqson Komunën dhe vepron në emër të saj
- b- Udhëheq Ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj;
- c- Mbikqyrë dhe udhëheq administrimin financiar të Komunës;
- d- Ushtron të gjitha kompetencat të cilat nuk i jepen në mënyrë Eksplicite kuvendit të Komunës, apo Komiteteve të tij
- e- Ekzekuton aktet Kuvendit të Komunës;
- f- Organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
- g- Emron dhe shkarkon nënkryetarin e komunës;
- h- Vendos për formimin dhe strukturimin e drejtorive të administratës Komunale
- i- Emron dhe shkarkon këshilltarët e tij (ndihmësit), të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave
- j- Shpallë, regruton dhe largon udhëheqësin personelit në pajtim me dispozitat e LVQL dhe të ligjit pozitiv për shërbimin civil .
- k- Emron dhe shkarkon drejtorët e drejtorive të administratës komunale;
- l- Propozon rregullore dhe akte të tjera nënligjore, të përgjithshme dhe të vecanta për miratim në Kuvendin e Komunës;
- m- I propozon kuvendit të Komunës, themelimin e Komiteteve konsultative në mbështetje të dispozitve të këtij statuti (neni 46 par.1 të Statutit);
- n- Propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese;
- o- Propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës, dhe rishikimin e tij dhe ekzekuton buxhetin e miratuar;
- p- Në cilësinë e autoritetit kryesor kontraktues në Komunë, menagjon, mbikqyr dhe ndërmerr masa me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike komunale dhe burimeve publike në përputhje me ligjin për menaxhimin e financave publike, dhe ligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.
- q- Kërkon që Kuvendi i Komunës ta shqyrtoj një akt, para apo pas hyrjen në fuqi të tij, kur konsideron se akti cenon ligjet në zbatim dhe interesin e komuniteteve;
- r- Konsulton Kryesuesin e Komitetit për komunitete për qështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë;

- s- Mbikqyrë, Monitoron dhe zgjedhë përgjegjsin për koordinimin e zyrave dhe njësive administrative, në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës.
- t- Aktivitete të tjera, të bashkërenditjes së punëve për rendin e ditës të Kuvendit, me Kryesuesin e Kuvendit, si dhe
- u- Aktivitete të tjera që përcaktohen me ligje të vecanta dhe me këtë Statut.

Neni 51

AKTET JURIDIKE TË KRYETARIT TË KOMUNËS

- 51.1. Kryetari i Komunës në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive nga neni 58 i LVQL, dhe neni 50 të këtij statuti nxjerr VENDIME dhe URDHËRESA.
- 51.2. Aktet e Kryetarit të Komunës janë përfundimtare (të formës së prerë) dhe të ekzekutueshme nga momenti i nënshkrimit dhe i protokolimit zyrtar të tyre.
- 51.3. Atakimi juridik ndaj akteve të kryetarit të Komunës mund të bëhet vetëm në rrugë dhe procedurë gjyqsore.

Neni 52

NËNKRYETARI I KOMUNËS

- 52.1. Në Komunën e Vitisë, Kryetari i Komunës e ka një nënkryetar.
- 52.2. Nënkyetari i Komunës emrohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës, dhe mandati i nënkryetarit mund të zgjas sa edhe mandati i Kryetarit të Komunës.
- 52.3. Nënkyetari i Komunës, vepron në kuadrin e fushës së kompetencave dhe të përgjegjësive të Kryetarit të Komunës, (nga neni 50 par.1. i këtij Statuti), dhe i ndihmon Kryetarit të Komunës në ushtrimin e kompetencave të pushtetit ekzekutiv të Komunës.
- 52.4. Në rastet kur Kryetari Komunës, në funksion të ushtrimit të të drejtave dhe përgjegjësive, publike për komunën, mungon nga kabineti i tij, atëherë nënkryetari i Komunës me autorizimin verbal apo formal të Kryetarit të Komunës ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e kryetarit të komunës (përveq përgjegjësive për ristrukturimin e organeve të administratës komunale, dhe të zgjidhjeve dhe të emrimeve të cilat janë kompetencë ekskluzive e Kryetarit).

52.5. Nënkyetari i Komunës në fushën e kompetencave të kryetarit të Komunës, propozon politika zhvillimore, akte të përgjithshme dhe të vecanta, të gjitha përmes Kryetarit të Komunës.

52.6. Në mungesë të Kryetarit të Komunës, Nënkyetari udhëheq dhe kryeson Kolegjin e Këshillit të drejtorve të drejtorive të administratës Komunale, dhe zgjidh konfliktin për kompetencë në mes të drejtorive të organeve të administratës komunale.

52.7. I propozon Kryetarit të Komunës me justifikim përmbajtësor marrjen e masave ndaj drejtorëve të drejtorive të administratës komunale dhe nëpunësve civil, për mospërbushjen e detyrave të punës, si dhe

52.8. Kryen punë dhe detyra tjera me autorizim të kryetarit të Komunës.

Neni 53

53.1. Kur pozita e nënkyetarit mbetet vakante (e lirë), Kryetari i Komunës e Emron Nënkyetarin e ri jo më vonë se 30 ditë, nga dita e mbetjes së postit të lirë për nënkyetarin e komunës.

Neni 54

PËRFUNDIMI I MANDATIT TË

KRYETARIT TË KOMUNËS

54.1. Kryetari të Komunës i zgjedhur me mandat 4 vjeçar, I përfundon mandati dhe statusi juridik i kryetarit të Komunës, në rastet si në vijim:

- a- Kur ta kryej mandatin e tij;
- b- Nëse vdes;
- c- Nëse jep dorheqje të pa revokueshme
- d- Nëse ndërron vendbanimin dhe kalon në një komunë tjetër me vendbanim;
- e- Nëse nuk paraqitet në punë pa ndërprerë më shumë se një muaj pa arsye;
- f- Nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë Statut (neni 20 par.4. i Statutit);
- g- Nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me LVQL (neni 64);
- h- Në rast se kur me vendim përfundimtar të gjyqit, Kryetari të Komunës i merret zotësia për të vepruar (**Capatitas Agendi**), dhe në rast se Kryetari i Komunës me aktgjykim të formës së prerë dhe përfundimtar (të ekzekutueshëm) është denuar me denim burgu për 6 muaj ose më tepër.

54.2. Në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Komunës, atëherë mbahen zgjedhjet e jashtzakonshme për kryetarin Komunës.

KAPITULLI VI

Neni 55

ADMINISTRATA KOMUNALE

55.1. Administrata komunale në Komunën e Vitisë, organizohet në Drejtori. Secila drejtori udhëhiqet nga Drejtori i Drejtorisë.

55.2. Drejtorët e Drejtorive të administratës, komunale emrohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës me vendim të veçant.

55.3. Të gjitha drejtorit e administratës komunale dhe të gjithë Drejtorët e Drejtorive të administratës komunale, gëzojnë statusin e barabart juridiko-ligjor, në raporte pune me kryetarin e Komunës dhe në ekzekutimin dhe ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave të deleguara nga Kryetari i Komunës.

Neni 56

56.1. Administrata Komunale në komunën e Vitisë organizohet në këto drejtori:

1. Drejtorja e Administratës;
2. Drejtorja për Financa, ekonomi dhe zhvillim;
3. Drejtorja e Inspeksionit;
4. Drejtorja për shërbime publike dhe emergjencë;
5. Drejtorja për shëndetsi dhe mirëqenje sociale;
6. Drejtorja për Arsim;
7. Drejtorja për, Kadastër Pronë dhe Gjeodezi;
8. Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të mjedisit;
9. Drejtorja për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
10. Drejtorja për Rini, Kulturë dhe Sport.

56.2. Kompetencat, përgjegjësit dhe autorizimet në drejtoritë e administratës Komunale, janë kompetenca të deleguara të kryetarit të Komunës, si organ më i lart i pushtetit ekzekutiv në komunën e Vitisë.

56.3. Drejtorët e drejtorive të administratës komunale, e drejtojnë dhe udhëheqin drejtorin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të Komunës, të ligjeve pozitive dhe rregulloreve komunale, në fuqi dhe në pajtim me dispozitat e këtij Statuti. (neni

56.4. Organizimi i drejtorive komunale të administratës dhe strukturimi i brendshëm i tyre, rregullohet në bazë të vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale të Komunës së Vitisë, të cilin e nxjerrë Kryetari i Komunës së Vitisë.

Neni 57

KËSHILLI I DREJTORVE TË DREJTORIVE TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

57.1. Këshillin e Drejtorive të drejtorive të administratës komunale e përbejnë, të gjithë drejtorët e emruar nga Kryetari i Komunës.

57.2. Mbledhjet e Këshillit të drejtorve i udhëheq dhe i kryeson Kryetari i Komunës (në mungesë të tij- Nënkryetari i Komunës- neni 52 i par.6 i Statutit).

57.3. Të gjithë antarët e këshillit të drejtorve (Drejtorët) në mbledhjet e Këshillit, i raportojnë në hollësi Kryetarit të Komunës. Ata në mbledhjet e Këshillit:

- a- I raportojnë Kryetarit të Komunës për të gjitha qeshjtjet në kompetencë dhe përgjegjësi të Drejtorisë;
- b- Ndihmojnë Kryetarin e Komunës, Kryesusin e Kuvendit të Komunës dhe Komitetet e kuvendit, duke ia ofruar atyre të gjitha informatat për vendimmarrje të drejtë;
- c- Zbatojnë të gjitha aktet e përgjithshme të Kuvendit të Komunës dhe Ligjet pozitive;
- d- Përgatisin dhe prezantojnë në Këshill raportet periodike të punëve në drejtoritë e tyre.
- e- përmbushjen dhe ekzekutimin e të gjitha vendimeve dhe urdhëresave të Kryetarit të Komunës
- f- raportimet për gjendjen buxhetore të të gjitha njësive buxhetore
- g- përgjigjen për të gjitha ankesat e qytetarve lidhur me sferën e përgjegjësisë të tyre
- h- prezentimin e përgaditjeve për punën në kuvendin e Komunës në sferën përgjegjësisë të tyre

- si dhe qështje tjera të cilat kanë të bëjnë me zbatimin e politikave zhvillimore për Komunën e Vitisë
- 57.4 Drejtorët e drejtorive të administratës Komunale mbajnë të gjitha format e përgjegjësis në fushën e kompetencave të deleguara nga Kryetari i Komunës (nga përgjegjësia morale deri te ajo penale)
- 57.5 Për kohën e konvokimit të mbledhjeve të Këshillit të drejtorve të administratës Komunale vendos Kryetari i Komunës.

Neni 58

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITË DHE KTHIM

- 58.1 Zyra Komunale për komunitet dhe kthim, formohet me qëllim të promovimit dhe të përmirimit të të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre , duke siguruar qasje të barabartë në shërbimet publike dhe krijimin e kushteve për kthim dhe riintegrim të qëndrueshëm të komuniteteve.
- 58.2 Zyra nga par.1 i këtij neni , bashkëpunon rregullisht me të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të komuniteteve , këthimit riadhesimit dhe riintegrimit
- 58.3 Kryetari i Komunës pas rekomandimit të komitetit për politikë dhe financë dhe komitetit për komunitet, me vendim të veçantë përcakton numrin e zyrtarëve dhe udhëheqsin e zyrës komunale për komunitet dhe këthim.
- 58.4 Zyra komunale për komunitet dhe kthim është pjesë integrale e administratës komunale , dhe udhëheqsi i zyrës merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të drejtorve të Administratës Komunale.
- 58.5 Udhëheqsi i zyrës rregullisht i raporton kryetarit të komunës për punën e zyrës dhe i paraqet raport vjetor kryetarit të komunës dhe kuvendit komunal, dhe raporton në çdo takim pune të komitetit për komunitet.
- 58.6 Udhëheqsi i zyrës propozon kryetarit të komunës një buxhet vjetor për funksionimin e zyrës për komunitet dhe kthim .
- 58.7. Personeli i zyrës për komunitet dhe kthim gëzon statusin e nëpunësit civil.
- 58.8 .Organizimi, detyrat dhe përgjegjësit e zyrës për komunitet dhe kthim rregullohen me aktin si në nenin 56.par 4 të këtij statuti.

KAPITULLI VII

NENI 59

ADMINISTRIMI FINANCIAR I KOMUNËS

FINANCAT KOMUNALE BUXHETI I KOMUNËS

59.1 Në funksion të përmbushjes së përgjegjësive ,kompetencave dhe autorizimeve ligjore Komuna e Vitisë ,në përputhje me politikat ekonomike ,dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërin fiskale të saj, Komuna ka të drejt të ketë burime të mjaftueshme financiare ,me të cilat mund të disponoj lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave komunale , në përputhje me ligjet e zbatueshme të Republikës së Kosovës .

59.2. Në funksion të përmbushjes së detyrave nga par.1.i këtij neni ,Komuna e Vitisë ka buxhetin e saj ,i cili do të jetë i balancuar i përgaditur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kriteret objektive.

59.3. Buxheti i Komunës duhet të përmbaj planin për aktivitete ekonomike brenda vitit fiskal ,dhe duhet të përfshij të gjitha parashikimet e të hyrave dhe shpenzimeve Brenda vitit buxhetor .Buxheti duhet të përfshijë tërësinë integrale të kategorive buxhetore ,si mallëra dhe shërbime ,paga dhe mëditje dhe investimet kapitale dhe kategoritë tjera buxhetore.

Neni 60

60.1 Burimet financiare të Komunës së Vitisë përbëhen nga :

- | | |
|--------|--|
| a- | Të hyrat vetanake ,(neni 8.ligjit për financat e pushtetit |
| lokal) | |
| b- | Grantet operative(neni 23.L.nr.03-L/049) |
| c- | Grantet për kompetencat e shtuara –neni 27 FPL |
| d- | Transferet për kompetencat e deleguara –neni 38 LFPL |
| e- | Grantet e jashtzakonshme – neni 29.L |
| f- | Të hyrat nga huamarrjet e Komunës neni 30.LFPL |
| g- | Të hyrat nga vetkontributi i qytetarve të Komunës |

Neni 61

TË HYRAT VETANAKE TË KOMUNËS

61.1 Të gjitha të hyrat e mbledhura në bazë të ligjit për financat e pushtetit lokal të kualifikuara si të hyra vetanake të Komunës janë :

- a- Tatimi në pronën e paluejtshme
- b- Taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarive afariste
- c- Taksa për lejen për shërbime profesionale
- d- Taksat për automjete motorike
- e- Taksat administrative komunale
- f- Taksat për lejet e ndërtimit dhe rrënimin e ndërtimeve dhe strukturave tjera
- h- Taksat tjera komunale .
- i- Taksat për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare .
- j- Tarifat për zhvillimin dhe ruajtjen infrastructures .
- k- Gjobat në trafik
- l- Të hyrat nga qiramarrëja – nga prona komunale
- m- Gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale .
- n- Bashkëpagesat për arsim dhe shëndetsi .

61.2 Mënyra e përfitimit dhe e zotimit të mjeteve nga neni 60.par.1 nga shkronja b deri te shkronja f. zbatohet në mënyr direkte dispozitat e LFPLNr.03L-049, kurse të hyrat nga vetkontributi i qytetarit i përcaktuar në nenin 60.par1.shkronja g të këtij statuti rregullohen me marrveshje bashkpunimi në mes të Komunës dhe qytetarve të vendbanimeve komunale.

Neni 62

ADMINISTRIMI FINANCIAR I KOMUNËS

62.1. Të gjitha qështjet që lidhen me administrimin financiar të Komunës së Vitis ,udhëhiqen dhe janë përgjegjësi e Kryetarit të komunës ,të cilat përgjegjësi kryetari mundë ti bartë me autorizim te nënkryetari i komunës dhe te drejtori i drejtorisë për financa ,ekonomi dhe zhvillim.

62.2 Përjashtim nga dispozita e par 1. Të këtij neni paraqet qështja e kompetencave të rezervuara për kuvendin e Komunës .

Neni 63

63.1 Drejtorët e drejtorive të administrates obligohen që ta njoftojnë kryetarin e komunës për qdo veprim që është në kundërshtim me procedurat buxhetore, rregulloret fiskale , rregullat e prokurimit dhe me dispozitat e këtij statuti.

63.2 Drejtorët e drejtorive të administrates komunale, mbajnë të gjitha format e përgjegjësis për menaxhimin e drejt dhe të saktësisë së informacioneve financiare brenda drejtorive të tyre ,për autorizimet e deleguara të kryetarit të komunës.

Neni 64

64.1 Drejtori i drejtoris për financa ,ekonomi dhe zhvillim duhet në qdo kohë ti afroj informacione kryetarit të komunës për gjendjen financiare buxhetore ,për të gjitha kategorit dhe njësit buxhetore të Komunës .

64.2 Informacionet nga par.1 I këtij neni iu ipen edhe drejtorve të drejtorive Komunale të administrates, Kuvendit të komunës dhe komiteteve të tijë.

KAPITULLI VIII

Neni 65

SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

65.1 Shërbimi civil Komunal në Komunën e Vitisë përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti Komunal ,pagat e të cilëve paguhen nga buxheti I Republikës së Kosovës ,dhe sipas Ligjit në fuqi për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës (Nr 03/L-149) kanë statusin e nëpunësve civil dhe janë pjesë e shërbimit civil të Kosovës .

65.2 Shërbimi civil Komunal; ,regrutimi.përzgjedhja ,avancimi në kategori funksionale dhe gradat e punës të nëpunësve civil bëhen në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin për shërbimin civil në fuqi, duke u mbështetur në aftësit profesionale mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe të procedurave të hapura dhe konkurruese të parimit dhe avansimit të nëpunësve civil .

Neni 66

66.1 Nuk konsiderohen nëpunës civil të shërbimit civil Komunal personat fizik që ushtrojnë autorizime publike si;

a. Kryetari i Komunës ,nënkryetari dhe drejtorët e drejtorive të administrates Komunale

- b. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ,anëtarër e zgjedhur të kuvendit të Komunës ,drejtorët e institucioneve dh endërmarrjeve nën autoritetin e Komunës
- c. Stafi mësimor I sistemit arsimor në të gjitha nivelet 1.2.3. si dhe stafi mjeksor i sistemit shëndetsor i nivelit primar në Komunën e vitisë.
- d. Të emruarit politik dhe të gjithë ata që emrohen në pozita nga të emruarit politik
- e . Zyrtarët e zgjedhur dhe zyrtarët e emruar nga zyrtarët e zgjedhur ,në pozita caktuara (funksionarët publik), .
- f. Personat e punësuar nga institucionet e administrates komunale përgjegjës për kryerjen e punve mbështetëse dhe të mirmbajtjes dhe personat fizik të cilët mbajnë pozita drejtuese në parti politike dhe janë aktiv politikisht (neni 4.par 4, lidhur neni 17.par3.LSHC.
- g. Personat fizik të cilët ushtrojnë punë dhe detyra të cilve me ligje të përgjithëshme apo të veqanta dhe me akte nënligjore shprehimishtë u pamundsohet të qenurit shërbyes civil.

Neni 67

67.1 Për kategorit e punonjësve publik të përshkruar në nenin 66 par 1,nga shkronja a deri te shkronja g vlejn dispozitat e Ligjit të punës dhe të ligjeve të veqanta të fushave përkatse dhe dispozitat e këtij Statuti ,për krijimin apo shuarjen e të drejtave nga mardhënja e punës

Neni 68

68.1 Me qëllim të planifikimit ,administrimit dhe mbikqyrjes së strukturave të shërbimit civil Komunal të administrates komunale dhe përmbushjes së detyrimeve dhe kërkesave nga neni 7 të LSHC. Të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 10.par.2.shkronja f të këtij statuti – konstituohet-Njësia për menagjimin dhe zhvillimin e personelit dhe të burimeve njerzore të shërbimit civil komunal –NJËSIA E PERSONELIT.

Neni 69

69.1 Njësia e personelit e shërbimit civil komunal ,ka udhëheqësin e personelit

69.2 Udhëheqësi i personelit me procedura të hapura dhe konkurruese ,zgjidhet dhe largohet nga detyra nga kryetari i Komunës në mbështetje të ligjit për vetqeverisje lokale dhe të LSHC, të Kosovës

69.3 Udhëheqësi i personelit regrutohet nga kandidatët shërbyes civil të karrierës me përvojë mbi 3 vjeqare dhe kualifikim profesional superior në fushat përkatëse të drejtësis dhe me konkurs publik.

69.4 Nëse posti i udhëheqsit të personelit për arsye të ndryshme mbetet vakant (i zbrazët), kryetari i komunës emron një anëtar tjetër nga shërbimi civil komunal –shërbyes civil të karrierës me profesion dhe përvojë si në nenin 69.par 3 të këtij statuti në cilsinë e të emruarit të përkoshëm ,por jo më gjat se 60 ditë ,deri sa të shpallet dhe regrutohet udhëheqësi i personelit .

69.5. Zgjedhjet për kuvendin e komunës dhe kryetarin e komunës dhe ndryshimet në këto organe komunale ,nuk mund të përbëjnë shkas për rishqyrtimin e emrimeve dhe avansimeve ,të shërbyesve civil të karrierës dhe jo karrierës të shërbimit civil Komunal .

Neni 70

AUTORIZIMET PËRGJEGJËSIT DHE KOMPETENCAT E NJËSIS SË PERSONELIT- UDHËHEQËSIT TË PERSONELIT

- 70.1. Njësia e personelit në kuadër të autorizimeve ,përgjegjësi dhe kompetencave ,ligjore,të ligjit për SH,C,Ligjit për pagat e nëpunësve civil,LVQL dhe të L,P,A,(në tekstin e mëtejshëm udhëheqësi i personelit) ushtron këto autorizime dhe kompetenca,
- 70.2 Në bashkpunim dhe konsultim permanent me kryetarin e Komunës dhe sipas kërkesave të arsyetuara të drejtorve të drejtorive të administrates komunale harton dhe publikon konkurset për plotsimin e vendeve të lira të punës për shërbyesit civil.
- 70.3 Cakton komisionin intervistues (testues) për punsimin e kandidatëve në vendet e punës në shërbimin civil të administrates Komunale .
- 70.4 Bënë emërimin formal të shërbyesve civil në organin e punësimit dhe përpilon formën dhe përmbajtjen e kontratës për punë në mes të shërbyesit civil dhe organit të punësimit dhe bën nënshkrimin e kontratës së punës në emer të organit të punësimit.
- 70.5 Inicon Ex-OFFICIO apo sipas kërkesës së drejtorit të drejtoris përkatëse procedurën disiplinore, në rast të shkeljeve të detyrave të punës dhe shkeljet tjera të kodit të mirsjelljes nga nënpunësit civil ,të përcaktuara me ligje të përgjithëshme apo të veqanta,apo me aktin e brendshëm të oragit të punësimit
- 70.6 Kujdeset për të drejtat e nëpunësve civil,në mbështetje të ligjëve në fuqi,që rregullojnë të drejtat nga marrëdhënjet e punës (trajnimet, ankesat, kushtet e punës).
- 70.7 Përpilon kujdeset dhe kompletton dosjet personale të nëpunësve civil,të shërbimit civil Komunal.
- 70.8 Në kuadër të kompetencave funksionale,udhëheqësi i personelit përcjell në vazhdimsi ligjet pozitive,që rregullojnë të drejtat,,obligimet dhe statusin juridiko-ligjor të nëpunësve

civil,dhe në këtë funksion e informon Kryetarin i Komunës dhe të gjitha drejtorit e administrates Komunale.

Neni 71

71.1 Udhëheqësi i personelit përpilon akte juridike administrative,të përgjithshme individuale apo të veqanta, por të gjitha të drejtat,detyrat dhe përgjegjsit e nëpunëve civil që rrjedhin nga marrëdhënjet e punës, (të gjitha format e vendimeve për nëpunësit civil)

71.2 Përpilon dhe lëshon vërtetime zyrtare,dhe referenca dhe shkresa tjera zyrtare për nëpunësit civil,sipas rregullave procedurale të L.P.A.

71.3Harton ,inicon,propozim-rregullore për kompetencat e bartura-të deleguara në Komuna, nga niveli qendror i qeverisjes, që kanë të bëjë me të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës për nëpunësit civil, dhe specifikat e përshkrimet të punëve për shërbuesit civil.

71.4 Kryen edhe punë të tjera për drejtorit Komunale sipas autorizimeve të Kryetarit të Komunës

Neni 72

72.1 Udhëheqësi i personelit për autorizimet,përgjegjësit dhe kompetencat e tij,i përgjigjet Kryetarit të Komunës,,të cilit i raporton në raporte periodike,mujore,tre mujore dhe vjetore për punën e tij.

72.2 Të gjitha aktet juridike dhe veprimet juridike që ndërmerren nga udhëheqësi i personelit me qëllim të organizimit, mbikqyrjes dhe avansimit të shërbimeve të nëpunëve civil,të shërbimit civil Komunal nënshkruhen nga udhëheqësi i personelit të shërbimit civil Komunal dhe vulosen me vulën e njësis së personelit të shërbimit civil Komunal.

72.3 Forma,mbishkrimi,dimensionet,dhe autorizimet e përdorimit të vulës së njësis së personelit të shërbimit civil Komunal të Komunës së Vitisë,përcaktohen me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës.

KAPITULLI IX

Neni 73

NJËSIT, SEKTORËT DHE ZYRAT ADMINISTRATIVE TË KRYETARI TË KOMUËS

73.1 Me qëllim të sigurimit të efikasitetit dhe të ushtrimit funksional të kompetencave dhe të përgjegjësive në Komunë në fusha të caktuara specifike, dhe me qëllim të menagjimit të drejtë të resurësve materiale dhe humane, të promovimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të Komunës si dhe në funksion të transparencës dhe jo-diskriminimit, në funksion të menagjimit dhe kontrollimit të shpenzimeve të parasë publike, Kryetari i Komunës në mbështetje të dispozitave të nenit 58 shkronja b, c, f dhe g, të LVQL, dhe dispozitave të nenit 50, par. 1 shkronja b, c, d, g, k, dhe p, të statutit të Komunës :

73.2 Formon njësit, sektorët dhe zyrat për ushtrimin ,menagjimin dhe kontrollin e politikave ekonomike dhe shoqërore dhe sigurimin e efikasitetit të tyre në interes të qytetarëve të Komunës.

Neni 74

74.1 Njësit, sektorët dhe zyrat si njësi organizative dhe specifike sektoriale nën menagjim, mbikëqyrje dhe monitorim të Kryetarit të Komunës janë:

- a-Njësia e personelit të shërbimit civil Komunal
- b-Njësia e auditimit të brendshëm
- c-Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore
- d-Zyra ligjore
- e-Zyra e prokurimit
- f-Zyra e përfaqësuesit të autorizuar të Komunës
- g-Zyra për marrëdhënie me publikun
- h-Zyra për mërgimëtar, dhe kordinim me Kryetar të këshillave të fshatrave dhe të këshillit të qytetit të Vitisë
- i-Zyra për integritet europiane
- j-Zyra Komonale për komunitete dhe kthim
- k- Zyra e këshillit komunal për siguri në bashksi.

74.2 Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 50 par.1 shkronja s të këtij statuti, themelon sektorin për demokratizim në kuadrin e përgjegjësive të të cilit do të jenë kordinimi, menagjimi dhe përgjegjësitë për zyrat dhe njësit nga par.1 shkronja c, g, h i dhe k, të këtij neni.

74.3 Kryetari i Komunës me vendim të veçantë mund të themelojë, njësit, sektor dhe zyra, dhe të ndryshojë strukturën dhe egzistimin e zyrave nga neni 74.par.1 varësishtë nga shkalla e nevojave dhe funksionalitetit të njësive ,sektorve dhe zyrave ..

Neni 75

75.1 Të gjitha njësitë organizative, sektorët njësit dhe zyrat për punën e tyre mbajnë të gjitha format e përgjegjësisë dhe i përgjigjen Krytarit të Komunës dhe organeve të tjera ekzekutive të autorizuara nga Kryetari i Komunës.

75.2 Format organizative nga neni 74.par.1 hartojnë planet e punës dhe objektivat të cilat i miraton, Kryetari i Komunës të njejtat raportojnë me raporte mujore,tre mujore dhe vjetore Kryetarit të Komunës , apo përgjegjësit të autorizuar nga ai.

75.3 Format e organizimit, numri i,njësive , sektorve dhe zyrave dhe kompetencat e tyre caktohen me vendim të Kryetarit të Komunës, kurse përshkrimet e të drejtave përgjegjësisë dhe kompetencave të tyre ligjore rregullohen me aktin si nga neni 56 par.4. të këtij statute.

KAPITULLI X

Neni.76

NDËRMARRJET PUBLIKE KOMUNALE

76.1 Ndërmarrjet publike lokale janë të gjitha ato ndërmarrje të cilat ofrojnë shërbime publike mbrenda Komunës së Vitisë, dhe ku Komuna e Vitisë është aksionare në ndërmarrjet e tilla,

76.2 Të gjitha ndërmarrjet publike organizohen si shoqëri aksionare,në mbështetje të ligjit në fuqi,mbi shoqëritë tregtare (neni.4.par.1.ligjit për ndërmarrjet publike .

76.3 Kur Komuna e Vitisë është aksionare në një ndërmarrje publike lokale, të drejtat e saj si aksionare do të ushtrojë, nga një Komision Komunal i aksionarve.

76.4 Komisionin Komunal të aksionarëve e përbëjnë tre anëtar të zgjedhur, një antarë zgjidhet (emrohet) nga Kryetari i Komunës dhe dy të tjerë nga Kuvendi i Komunës

Neni 77

77.1 Komisioni nga neni 76 par 4 i këtij statuti, ka të drejtë të veprojë në emer të Komunës dhe në interes të saj , dhe në interes të zhvillimit të N.P lokale. Komisioni për qështjet e

shqyrtuara vendos me shumicë votash.

77.2 Komisioni Komunal i aksionarve përgaditë dhe nxjerr një politikë të pronsisë (definim pronësie) e cila i paraqet objektivat e përgjithshme të Komunës në lidhje me pronsinë e N.P lokale

77.3 Komisioni Komunal i aksionarve nga neni 76.par.3.zgjedh bordin e drejtorve të N.P Komunale i cili duhet ratifikuar nga Kuvendi Komunal, me shumic të thjeshtë të votive të anëtarve të Kuvendit.

77.4 Komisioni Komunal i aksionarëve në interes të zhvillimit ritjes, sukseseve apo mossuksesëve të N.P lokale i raporton me raporte periodike Kuvendit të Komunës,për vendimet e tij lidhur me N.P.L

Neni 78

78.1 Kuvendi i Komunës,me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike,të mirëmbajtjes së tyre nga fusha e kompetencave si në nenin 17 shkronja f.të LVQL,lidhur në nenin 10.par.2.shkronja c dhe d të këtij statuti mund të themelojnë ndërmarrje publike lokale,me mjete vetanake dhe me mjete nga aksionet e N.P lokale,ku Komuna është aksionare.

Neni 79

79.1 Ndërmarrjet publike Komunale nga neni 76.78.të këtij statuti, të cilat ofrojnë shërbime publike Komunale,propozimet e tyre buxhetore duhet të miratohen nga Kuvendi i Komunës.

79.2 Propozimet buxhetore, duke përfshirë edhe strukturën dhe nivelin e tarifës për shërbimet e ofruara duhet të dorëzohen për miratim para 15.nëntorit të vitit,për vitin e ardhshëm fiskal ,për miratim në Kuvendin e Komunës së Vitisë .

KAPITULLI XI

Neni 80

KONFLIKTI I INTERESIT

80.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit të Komunës, dhe anëtarët e komitetëve të Kuvendit, nuk mund të marrin pjesë në vendimmarrje dhe në miratimi të vendimeve, në të gjitha qështjet në të cilat ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij apo saj ka interes personal material apo financiar nga vendimi i tillë.

80.2 Qdo anëtar i Kuvendit apo i komitetit të tij,apo qdo anëtar tjetër i Kuvendit që ka njohuri për anëtarin tjetër,të Kuvendit që ka të bëjë me konflikt interesi, është i obliguar që të prezantojë informacionet,në forma verbale apo formale dhe të njejtat ti deponoi në procesverbal apo në formë shkresave në drejtorinë për administratë.

80.3 Pas mbledhjes së parë konstituive të Kuvendit të Komunës të gjithë anëtarët e Kuvendit duhet ti regjistrojnë në deklaratat e tyre të veqanta dhe të plota konfliktet e interesave të tyre ekonomike dhe financiare dhe interesat tjera,në raport me Komunën dhe organet e saj,dhe të njejtat deklarata të protokuluara mbahen dhe procedohen në drejtorinë e administrates si në par.2. të këtij statute.

Neni 81

81.1 Kryetari i Komunës dhe nënkryetari i Komunës, pas zgjedhjes respektivisht emërimit të nënkryetarit ,ndërpresin qdo lloj kontrate apo punë juridike tjetër me Komunën apo ndërmarrjen publike nën autoritetin e Komunës për shkak të papërputshmërisë së interesave dhe detyrave të të qenurit Kryetar respektivisht nënkryetar i Komunës .Paraqitja e konfliktit të interesit bëhet në formën dhe organin si në nenin 80.par.2.të këtij Statuti.

81.2 Kryetari i Komunës si dhe nënkryetari i Komunës përjashtohen nga procedurat e vendimmarrjes dhe procedurat tjera administrative në të gjitha qështjet në të cilat ai apo ajo apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tyre ka interes personal material apo financiar nga vendimi si ne par.1.të nenit 80.të këtij statuti.

81.3 Kryetari i Komunës dhe nënkryetari i Komunës,pas zgjedhjes respektivisht emërimit,duhet të paraqesin konfliktet e interesit në dhe rreth raporteve të tyre ekonomike dhe financiare nga punët juridike-civile dhe punët dhe veprimet e tjera me Komunën dhe organet e saja.

81.4 Kryetari i Komunës dhe nënkryetari i Komunës duhet vullnetarisht ti paraqesin konfliktet e interesit ne raport me Komunën dhe organet e saja dhe të paraqesin qdo ndryshim të gjendjes së tyre financiare,posa të paraqitet ndryshimi (neni 59.par.4.LVQL)

Neni 82

82.1-Drejtorët e drejtorive të administratës Komunale përjashtohen nga vendim-marrja në procedurat administrative, veprimet e tjera juridike apo nga punët juridiko-civile dhe raportet tjera të këtyre natyrave, në mes të Komunës dhe qytetarve, nëse ai apo ajo apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tijë apo të sajë ka ndonjë interes personal ekonomik apo financiar nga raportet e tilla

82.2 Drejtorët e drejtorive duhet të paraqesin me shkrim qdo konflikt të interesave menjëherë para se ato të shfaqen, Kryetarit të Komunës, i cili vendos menjëher për delegim kompetence në drejtorinë tjetër apo zyrtarin e autorizuar nga ai për vendimmarrje.

Neni 83

83.1 Nënpunësi civil i drejtorisë përkatëse të administratës Komunale përjashtohet nga vendim-marrja dhe procedurat administrative, lidhur me qështjet në kompetencë dhe përgjegjësi të tijë, në të gjitha qështjet në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tijë, ka interes personal, ekonomik apo financiar apo interes tjetër nga qështja e tillë.

83.2 Vendimin për përjashtimin e nënpunësit civil dhe nga shkaqet e përgjithshme si në par.1. të këtij neni, e merr drejtori i drejtorisë përkatëse të administratës Komunale, i cili mban evidencën zyrtare për konfliktet e interesit të nëpunësve civil në drejtorinë e tij.

Neni 84

84.1 Për të gjitha format e konfliktit të interesave, për njësit, sektorët dhe zyrat nga neni 74. par.1. vendos Kryetari i Komunës apo zyrtari i autorizuar nga Kryetari i Komunës.

Neni 85

85.1 Të gjitha vendimet në procesin e vendim-marrjes nga personat e autorizuar si në dispozitat e nenëve: 81, 82, dhe 83, të këtij statuti, pas konstatimit dhe vërtetimit të tyre se janë nxjerr me dashje apo nga pakujdesia e rënd me qëllim përfitimi personal, materjal apo

fushën e kompetencave të deleguara ,i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjëshmëris.

91.2. Aktet nga par.1 i këtij neni Komuna ia dërgon ministries përkatëse në afatin prej 7 ditësh nga data e nxjerrjes së tyre.

91.3 Ministria përkatëse është e obliguar që të jap mendimin për ligjëshmërin e akteve komunale brenda 15 ditësh nga pranimi i tyre.

Neni 92

SHQYRTIMI I PËRSHTATSHMËRIS SË AKTEVE KOMUNALE

92.1 Ministria përgjegjëse për kompetencat e deleguara të saj bën mbikqyrjen e realizimit të kompetencave të deleguara, ministria në afatin brenda 30 ditësh, nga data e pranimi të aktit të miratuar nga organet komunale,e bën shqyrtimin e përshtatshmëris së aktit.

92.2 Nëse akti i organit komunal, tejkalon kompetencat e deleguara apo nuk i përmbush ato ,atëher ministria përkatëse mund të modifikoj aktin ta ndryshoj apo ta pezulloj ekzekutimin e aktit komunal. Ministria përkatëse për vendimet e saja lidhur me aktin e organeve komunale informon komunën brenda afatit prej 5 ditësh nga marrja e vendimit.

Neni 93

KËRKESA PËR KONSULTIM PARAPRAK

93.1 Nëse organet e komunës së Vitisë gjatë përgaditjes së një akti për miratim nuk janë të sigurt apo nuk posedojn informacione të plota në fushën të cilën pretendojnë ta rregullojnë me aktin e përgaditur ,atëher këto organe kërkojnë konsultim paraprak ligjor ,nga ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale .

93.2 Kërkesa për konsultim paraprak me propozim –aktin i dërgohet autoritetit nga par.1 i këtij neni.

93.3 Autoriteti nga par.1 i këtij neni është i obliguar që në afatin brenda 30 ditësh të përgjigjet me shkrim organeve komunale të komunës së Vitisë.

KAPITULLI XIII

Neni 94

PROCEDURA PËR MDRYSHIMIN DHE PLOTSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS

97.1 Pas miratimit të propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotsimin e statutit të Komunës së Vitisë ,pushojn të vlejn dhe shfuqizohen dispozitat e ndryshuara dhe të plotsuara të statutit Nr.02-013/5165 të dates 18.11.2008.

Neni 98

Dispozitat e ndryshuara dhe të plotsuara të statutit nga neni 97 i këtij statuti ,nuk do të kenë efektë juridik retroaktiv ,nëse do të jenë në dëm të palve (subjekteve të së drejtës).

Neni 99

Që nga data e miratimit të ndryshim-plotsimeve të këtij statuti dhe jo më gjatë se 120 ditë ,do të bëhet harmonizimi i të gjitha rregulloreve dhe akteve tjera të përgjithëshme nënligjore në fuqi të komunës së Vitisë me dispozitat e këtij statuti.

Neni 100

Në raste të kolizionit në mes të dispozitave të LVQL , ligjeve të veqanta dhe të këtij statuti ,do të zbatohen dispozitat e LVQL, dhe ligjeve të veqanta.

Neni 101

Në raste të kolizionit në mes të dispozitave të këtij statuti dhe rregulloreve ,si dhe akteve tjera të përgjithëshme nënligjore të Komunës së Vitisë ,do të zbatohen dispozitat e këtij Statuti.

Neni 102

Interpretimin autentik të dispozitave të këtij statuti e bën Kuvendi i Komunës së Vitisë

Neni 103

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe nënshkrimit të tij nga kryesuesi Kuvendit të Komunës së Vitisë

KRYETARI KOMUNËS SË VITISË
NEXHMEDIN ARIFI

Pika 3



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika b të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) dhe neni 8 pika 1 dhe 1.2, neni 19 paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 21 neni 22 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011 dhe dhe Njoftimit publik me 02-060/01-585, të datës 05.06.2025, i Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim të pronës komunale të Kryetari i Komunës me datën 13.05.2026, bëjnë këtë :

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

| | | | |
|------------|--------|---|-----|
| 13-05-2026 | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| 07 | 055/05 | | 506 |

PROPOZIM VENDIM

Përfundimtar për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim përfundimtar, propozohet të jepet në shfrytëzim prona e palujtshme e komunale në parcelën kadastrale me nr. nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zabel, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 130577 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatgjatë me kohëzgjatje prej 20 viteve, ofertusit "Daka GRUP" SH.P.K. përfaqësuar nga Ibrahim (Mustafë) Ostroglava.

Neni 2.

Afati kohor për dhënjën në shfrytëzim afatgjat të pronës së palujtshme Komunale të cekur në piken 1 të këtij propozim vendimi është në kohëzgjatje prej 20 viteve.

Neni 3.

Qellimi i dhënjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe funksionalizmi dhe përfitimi ekonomik i komunës (respektivisht vendosjen e paneleve solare) nga prona komunale.

Neni 4.

Autorizohet Kryetari i Komunës së Vitisë që të në afatin kohorë pas hyrjes në fuqi të këtij propozim vendimi të nënshkruhet kontrata me fituesin.

Neni 5.

